

THE GLOBAL INITIATIVE  
AGAINST TRANSNATIONAL  
ORGANIZED CRIME





**ZONAT PROBLEMATIKE  
TË KRIMIT TË ORGANIZUAR NË  
VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR**

*Identifikimi dhe analizimi i pikave të dobëta  
në zona të caktuara në një kontekst rajonal*



Maj 2019



# ZONAT PROBLEMATIKE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

---

Identifikimi dhe analizimi i pikave të dobëta në zona të caktuara në një kontekst rajonal

Maj 2019



Fotografia në kopertinë: Një oficer i policisë kroate të kufirit inspekton hekurudhën pranë kufirit Kroaci – Serbi.  
(Reuters/Antonio Bronic).

© 2019 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në asnjë formë apo me asnjë mjet pa leje me shkrim nga Iniciativa Globale. Ju lutemi për çdo kërkesë drejtohuni tek:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime

WMO Building, 2nd Floor

7bis, Avenue de la Paix

CH-1211 Geneva 1

Switzerland


[www.GloballInitiative.net](http://www.GloballInitiative.net)



# Përmbajtja

---

|   |    |
|---|----|
| Hyrje.....  | 1  |
| Metodologjia: gjeografia dhe ekonomia politike e krimit.....              | 1  |
| Situata e përgjithshme: Ballkani ka akoma punë për të bërë.....           | 3  |
| Korridoret e trafikimit në Ballkan.....                                   | 6  |
| Profilet of zonave problematike të krimit të organizuar.....              | 7  |
| Nyje kufitare: korridore për veprimtari kriminale të shumëllojshme.....   | 9  |
| Beteja për portet e Malit të Zi: Tivari, Budva dhe Kotori.....            | 13 |
| Një rrëfenjë e dy klaneve.....  | 13 |
| Hapu Tivar!.....  | 15 |
| Vjedhje makinash në Sarajevë.....   | 16 |
| Kryqëzimet e rrugëve kryesore dhe kryeqytetet.....                        | 17 |
| Trekëndëshi i krizave: Serbia e jugut, Kosova dhe Maqedonia e Veriut..... | 23 |
| Profili i një zone problematike: veriu i Kosovës.....                     | 26 |
| Zonë gri shumë fitimprurëse.....  | 26 |
| Kush e kontrollon veriun e Kosovës?.....                                  | 28 |
| Pazaret e dhunës.....   | 29 |
| Grupet kriminale.....   | 29 |
| Vrasës me pagesë.....   | 30 |
| Kompani private të mbrojtjes fizike dhe sigurisë.....                     | 30 |
| Rrugaçët.....   | 30 |
| Protestues politikë.....  | 31 |
| Huliganë futbolli.....  | 31 |
| Grupet parashtarake.....  | 32 |
| Ekosistemi i krimit.....  | 32 |
| Krimi ballkanik jashtë rajonit.....                                       | 37 |
| Zonat problematike të krimit në të ardhmen.....                           | 38 |
| Përfundime.....   | 40 |
| Shënime.....  | 42 |



# Mirënjohje dhe falënderime

---

Ky raport është hartuar nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore, si pjesë e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (Global Initiative Against Transnational Organized Crime's [GI] Civil Society Observatory to Counter Organized Crime in South Eastern Europe).

Observatori është një platformë që mbledh së bashku dhe fuqizon organizata të shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi. Observatori kërkon t'i krijojë mundësi shoqërisë civile që të identifikojë, analizojë dhe të krijojë një tabllë të prirjeve dhe tendencave kriminale, si dhe ndikimin e tyre mbi trafiket e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe respektimin e ligjit, dhe i mbështet këto organizata në punën e tyre për monitorimin e zhvillimeve dhe tendencave të krimin të organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Observatori u krijua në vitin 2018, pas takimit të Londrës mbi vendet e Ballkanit perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ky raport bazohet mbi të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura nga organizata të shoqërisë civile nga vendet e Ballkanit perëndimor, me ndihmën dhe kontributin e një grupi prej 20 gazetarësh dhe ekspertësh. I falënderojmë për ndihmesën e vyer përgjatë këtij procesi, si dhe për angazhimin e hapur dhe konstruktiv gjatë punës studimore.

Të dhënat nga rrjetet lokale u koordinuan nga Fatjona Mejdini, dhe më pas u analizuan dhe u përmbledhën nga kreu i sektorit të studimeve të GI, Walter Kemp, me ndihmën e Kristina Amerhauser dhe Johanna Borstner. Përfundimet dhe konkluzionet u hartuan me kontributin e Ugljesa Zvekic, Fabian Zhillës, Odd Malme dhe Mark Shaw.

Ky raport u hartua me mbështetjen financiare të Fondit për Konfliktet, Stabilitetin, dhe Sigurinë të Mbretërisë së Bashkuar (United Kingdom's Conflict, Stability and Security Fund). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, dhe nuk pasqyron domosdoshëmsisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



# Hyrje

Që nga fundi i vitit 2018, protestuesit po mbushin rrugët e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë për të shpalosur zhgënjimin dhe zemëratën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Shumë gazetarë në rajon janë bërë objekt sulmesh, pasi kanë investiguar korrupsionin e niveleve të larta, si Olivera Lakiç, që e qëlluan në këmbë në maj 2018, pasi bëri publike pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e zyrtarëve të lartë malazezë në kontrabandën e cigareve. Persona që mendohet se kanë lidhje me krimin e organizuar janë arrestuar dhe janë marrë në pyetje në lidhje me vrasjen e politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanović. Vrasjet e stilit mafioz po bëhen gjithmonë e më të zakonshme në këtë rajon, edhe si pasojë e mosmarrëveshjeve shumëvjeçare midis grupeve të rrezikshme kriminale nga Mali i Zi dhe Serbia. Kriminelë kanë qëlluar mbi forcat e rendit në Sarajevë, ndërsa policia po mundohej të arrestonte disa vjedhës makinash. Në raste të tjera të lidhura me krimin e organizuar, oficerë të policisë së rendit dhe policisë kufitare janë dënuar për korrupsion, marrje ryshfetesh, madje edhe grabitje, apo bashkëpunim në planifikim dhe kryerje krimesh. Incidente të tilla, që janë përshkruar gjerësisht në këtë raport, janë tentakulat e një oktapodi shumë të rrezikshëm që jeton fare pak poshtë sipërfaqes.

Ky raport nuk përqendrohet mbi studimin dhe analizimin e tregjeve të aktivitete të paligjshme, lëvizjen e parave dhe pasurive të krimit, apo mbi grupe të veçanta kriminale. Raporti merret me *vende dhe zona* të pasura me aktivitet kriminal: zona problematike (hotspots) ku ushtrohen aktivitete të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor. Raporti studion karakteristikat e këtyre zonave problematike, dhe më pas bën një analizë të detajuar të disa pikave të caktuara të kalimit të kufirit, nyjeve kryesore të qarkullimit, apo krahinave në vështirësi ekonomike apo sociale. Çfarë i bën këto zona kaq problematike dhe të rrezikuara? Pse janë kaq joshëse për kriminelët? Pasi merret me analizimin e këtyre çështjeve, raporti studion edhe lidhjen midis këtyre vendndodhjeve, për të identifikuar lidhjet e mundshme të strukturave kriminale që të kuptojmë diçka më shumë mbi gjeografinë e krimit në rajon.


Për t'i vendosur në kontekst këto zona problematike të krimit të organizuar, raporti paraqet një tablo të përgjithshme të situatës aktuale në vendet e Ballkanit perëndimor, si dhe jep disa informacione të përgjithshme mbi trafiqet e paligjshme. Më pas, studimi analizon zona problematike pranë kufirit, si dhe korridoret lidhëse midis zonave të ndara mbi linja etnike.

Një çështje tjetër me rëndësi për temën e këtij raporti është ndërthurja dhe përqendrimi i elementëve të krimit të organizuar në disa pika në vendet e Ballkanit perëndimor; sidomos në qytete të mëdha (veçanërisht në kryeqytete), qytete bregdetare, dhe zona ku kryqëzohen arterie kryesore të transportit. Raporti paraqet harta që tregojnë vendndodhjen e zonave problematike si dhe arteriet kryesore të transportit. Nëpërmjet këtyre vlerësimeve, raporti studion në thellësi zona të vështira dhe të rrezikuara si Sarajeva, tre porte përgjatë bregdetit malazez, veriun e Kosovës, si dhe një trekëndësh gjeografik në kufirin e Maqedonisë së Veriut me Serbinë jugore dhe Kosovën.

Duhet përmendur që në fillim se një nga përfundimet kryesore të këtij raporti është se trafiqet e paligjshme kalojnë nëpër një numër të vogël portesh, qytetesh dhe pikash kufitare në vendet e Ballkanit perëndimor, dhe kjo mundësohet nga një ekonomi politike e krimit që tolerohet, dhe është bërë pjesë përbërëse e mentalitetit të popullatës në shumicën e vendeve të rajonit. Për këtë qëllim, raporti analizon ekosistemin e krimit, që krijon një ambjent ku lulëzojnë aktivitetet e paligjshme. Ky raport paraqet edhe disa vlerësime dhe parashikime se cilat zona mund të jenë problematike në lidhje me shtrirjen e krimit të organizuar në të ardhmen.

## Metodologjia: gjeografia dhe ekonomia politike e krimit

Ky raport është hartuar nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore, si pjesë e Inicativës Globale (GI) – një rrjet që mundohet të identifikojë modele dhe tendenca zhvillimi të krimit të



organizuar në rajon, për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit kundër këtij fenomeni, për të ulur nivelin e cënueshmërisë së shoqërisë dhe për të stimuluar marrjen e masave për korrigjimin e situatës. Ky është një raport i shoqërisë civile, që përqendrohet mbi ndikimin në shoqëri të grupeve anti-shoqërore dhe faktorëve që e bëjnë të mundur këtë influencë. Në përputhje me frymën e Procesit të Berlinit (një proces ndërqeveritar që nisi në vitin 2014 për të nxitur bashkëpunimin me vendet e Ballkanit perëndimor), ky raport dhe puna e observatorit duhet të konsiderohen si një kontribut i shoqërisë civile, nga vendet e prekura nga krimi, për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal për të luftuar krimin e organizuar.

Raporti përqendrohet mbi gjashtë vende të Ballkanit perëndimor që janë kandidatë për hyrje në Bashkimin Evropian (BE), që nganjëherë përmenden edhe me shkurtimin WB6 - Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kosova,<sup>1</sup> Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, dhe Serbia.

Ky studim jep kontributin e tij në kuadër të përpjekjeve të Iniciativës Globale për të krijuar një hartë, apo tablo të krimit të organizuar në nivel global (siç është botimi i GI-së *Atlasi Botëror i Trafiqeve të Paligjshme*<sup>2</sup>), në nivel rajonal dhe lokal. Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti kombinon studimet dhe vlerësimet e detajuara në nivel lokal me një fushëpamje më të gjerë në nivel rajonal. Ndërkohë që një pjesë e mirë e të dhënave të paraqitura në këtë raport nuk janë informacione të reja, ne mendojmë se përfaqësimi i këtij raporti është inovativ. Studimi zhvillohet në nivel lokal, në terren, ndërkohë që të dhënat vlerësohen në një kontekst rajonal. Po kështu, raporti identifikon dhe bën një përshkrim të ekosistemit të botës së krimit, duke shtuar dhe plotësuar të dhëna dhe informacione të mbledhura më parë nga puna e GI-së, për të analizuar lidhjet midis elitave politike, ekonomike dhe kriminale në Ballkan.<sup>3</sup>

Ky raport bazohet mbi informacione të mbledhura nga një rrjet prej 20 ekspertësh me njohje të mirë të situatës në zonat problematike të përmendura në këtë raport. Ata zhvilluan rreth 350 intervista me policë, prokurorë, gjykatës, politikanë të zonës, zyrtarë publikë në nivele të ndryshme të administratës, gazetarë, banorë të zonave problematike, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Pjesa më e madhe e informacionit u mbledh gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018, por ky raport përdor edhe të dhëna dhe materiale të mbledhura më herët nga GI në vendet e Ballkanit perëndimor.

Raporti u pasurua më tej, duke marrë në shqyrtim materiale të publikuara, të dhëna nga çështje gjyqësore, informacione mbi konfiskime dhe bllokime mallrash apo pasurish nga policia apo doganat, dokumente qeveritare, statistika zyrtare, artikuj apo kronika të mediave, raporte nga OJQ të ndryshme, si dhe raporte të hartuara nga institucione akademike dhe studimore. Ky informacion u analizua dhe u përpunua për të krijuar një ide mbi prirjet dhe tendencat e zhvillimit në botën e krimit. Varianti i parë i raportit u diskutua dhe u rishikua në mars 2019 nga një rrjet prej 20 gazetarësh investigativë, organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë rajonalë nga të gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor. Më pas, mendimet dhe opinionet e tyre u përfshinë në versionin e ripunuar.

Vendosja në hartë e pikave të nxehta në raport me korridoret kryesore të transportit, rajonet e prapambetura nga ana ekonomike, krahinat e banuara nga pakicat etnike, si dhe në raport me kufijtë kombëtarë apo kufijtë e brendshëm zonalë (për shembull në Bosnjë Hercegovinë, apo Kosovë), na ndihmuan që t'i japim përgjigje pyetjes përse disa pika të caktuara janë bërë zona problematike të krimit të organizuar.

Gjatë hartimit të këtij raporti, GI kërkoi informacion zyrtar nga autoritetet shtetërore, forcat e ruajtjes së rendit, dhe ministritë e brendshme të shteteve ballkanike. Ia vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e institucioneve zyrtare nuk ishte shumë entuziaste në dhënien e informacionit.

Lista e zonave problematike të evidentuara në këtë raport nuk është ezauruese, por është treguese e zhvillimeve dhe aktiviteteve në rajon.

Është gjithashtu e rëndësishme që të shpjegojmë se ky raport nuk është një analizë e rreziqeve dhe kërcënimeve që vijnë nga krimi i organizuar, dhe nuk paraqet prova të aktiviteteve kriminale. Ky raport bën një analizë në nivel lokal të zonave në vështirësi, dhe më pas i vendos këto rezultate në një kontekst rajonal. Ky raport është i natyrës së përgjithshme: është më shumë studim cilësor se sa sasior, dhe kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së informacionit zyrtar. Por sidoqoftë, raporti paraqet një tablo të situatës, dhe i krijon mundësi aktivistëve dhe shoqatave lokale që të krijojnë një ide më të qartë të asaj që ndodh përreth tyre.



Raporti tregon se ku zhvillohen aktivitetet e paligjshme dhe përsë. Ne shpresojmë që ky raport do të ndihmojë në reduktimin, zbutjen apo eliminimin e cënueshmërisë të zonave të caktuara, dhe të mundësojë marrjen e masave për luftimin dhe parandalimin e pasojave që vijnë nga krimi i organizuar, që është bërë pengesë e zhvillimit rajonal; veçanërisht në lidhje me aspiratat e gjashtë vendeve të Ballkanit perëndimor për të hyrë në BE.

## Situata e përgjithshme: Ballkani ka akoma punë për të bërë

Gjatë këtyre viteve të fundit ishte krijuar njëfarë ideje naive se “Ballkani mbaroi punë, u rregullua.” Mendohej se gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor do të ishin më të stabilizuara, do të arrinin të zgjidhnin problemet e tyre të brendshme, do të përmirësonin bashkëpunimin rajonal, do të tërhiqnin investime të huaja, dhe do të afroreshin akoma më shumë me Bashkimin Evropian, dhe NATO-n.

Por Ballkani ka akoma shumë punë për të bërë. Kriza e refugjatëve në vitin 2015 e ktheu “korridorin Ballkanik” edhe njëherë në qendër të vëmendjes. Nga konflikti në Lindjen e Mesme po largohen nga ai rajon armët dhe luftëtarët e huaj, që kanë marrë rrugën drejt Ballkanit. Bisedimet e nisura me ndërmjetësimin e BE-së, për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës kanë dështuar.

Situata në Bosnjë Hercegovinë është delikate, pasi vendi vazhdon akoma të jetë thellësisht i ndarë mbi baza etnike. Situata politike në Shqipëri është përkeqësuar që kur Partia Demokratike u largua nga parlamenti, duke protestuar për korrupsion dhe ndikim të krimit të organizuar në rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2017. Në Beograd, protestat që kanë zgjatur me javë të tëra, bëjnë thirrje për liri më të madhe për mediat, dhe reforma të sistemit zgjedhor.

Mijëra protestues kanë mbushur rrugët e Malit të Zi për të kërkuar dorëheqjen e presidentit Milo Djukanoviç, dhe Partisë Demokratike të Socialistëve që ka shumë vite në pushtet, në lidhje me akuzat për korrupsion dhe bashkëpunim me krimin e organizuar.


Një nga të paktat zhvillime pozitive është shënuar në Shkup, ku pas një përpjekjeje të dështuar nga ana e opozitës për të marrë me forcë parlamentin, një qeveri e re arriti të konsolidojë pushtetin, të zbatojë reforma, dhe të zgjidhë një mosmarrëveshje 25 vjeçare me Greqinë fqinje për emrin e vendit. Kjo i hap rrugën procesit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE.

Procesi i zgjerimit të BE-së – që ishte një shtysat kryesore për miratimin e reformave në vendet e rajonit – është ngadalësuar që nga viti 2018, që kur disa vende të BE-së, si Franca dhe Holanda, vunë si kusht zbatimin e më shumë reformave, përpara se të hapen bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, dhe Shqipërinë.

Megjithëse BE vazhdon të jetë investitori kryesor në vendet e rajonit, shtete të tjera si Kina dhe disa vende të Gjirit Persik (veçanërisht Arabia Saudite, dhe Emiratet e Bashkuara Arabe) po tregohen aktive në fushën ekonomike, ndërsa edhe Rusia po ushtron ndikim me kosto të ulët politike.<sup>4</sup>

Nga ana tjetër, Rusia, ashtu si dhe Turqia, po shërbejnë edhe si shembull i një qeverisjeje autoritare me dorë të fortë brenda një sistemi në dukje demokratik, dhe ky model është shumë tërheqës për politikanët me prirje autoritare në vendet e Ballkanit perëndimor. Po kështu, Turqia dhe Rusia shfrytëzojnë haptazi ngjashmëritë kulturore dhe lidhjet historike me këto vende për t’iu kundërvënë marrëdhënieve të ngushta të këtyre shteteve me BE-në.<sup>5</sup>

Turqia është një partner i rëndësishëm ekonomik i vendeve të Ballkanit perëndimor, veçanërisht në sektorin e tregtisë, në sistemin bankar, dhe në fushën e investimeve të huaja direkte.<sup>6</sup> Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Kina është bërë një nga investorët kryesorë në Serbi – kompani kineze kanë blerë një minierë bakri, një kombinat metalurgjik dhe një termocentral, si dhe linja hekurudhore të shpejtësisë së lartë, autostrada dhe porte. Mali i Zi ka marrë një kredi 500 milionë dollarëshe nga Banka Eksport-Import e Kinës (Exim). Këto fonde do të përdoren për t’i paguar rreth një miliardë dollarë një kompanie kineze për ndërtimin e një autostrade që do të lidhë Malin e Zi me Serbinë.<sup>7</sup>





Në mënyrë që t'i kundërvihen ndikimit politik të Ruisë dhe Turqisë, dhe për të kufizuar fluksin e lëvizjeve masive të njerëzve drejt vendeve të BE-së, përëndimi nganjëherë mbështet udhëheqës që premtojnë të përmirësojnë stabilitetin e vendit të tyre, dhe që asiprojnë për integrim në strukturat euro-atlantike. Për shembull, Mali i Zi u shpërblye në qershor 2017 me anëtarësimin në NATO. Prirjet e Shteteve të Bashkuara dhe BE-së për të minimizuar apo injoruar sjelljet dhe qëndrimet negative të disa politikanëve, ndërkohë që mundohen të ruajnë nivelin e influencës së tyre mbi një vend, ka sjellë në krijimin e një lloj sistemi që mund të përshkruhet si “stabilokraci”: demokraci të dobëta, me udhëheqës me prirje autoritare, që qeverisin nëpërmjet rrjeteve dhe strukturave informale dhe klienteliste, por që pretendojnë se po japin kontributin e tyre për sigurimin e stabilitetit të një sistemi pro-përëndimor në rajon.<sup>8</sup>

“Si rezultat i përkeqësimit të ekonomisë dhe dobësimit të demokracisë, si dhe mungesës së besimit për të ardhmen e vendit të tyre, shumë të rinj po votojnë me këmbë – duke u larguar drejt përëndimit.”

Këto “stabilokraci” fuqizohen akoma më tej nga prirjet në disa vende të Evropës qendrore (por edhe më gjerë) drejt demokracive intolerante dhe populizmit. Kjo ka sjellë një turrje të hapësirave për shoqërinë civile, shtimit të kufizimeve ndaj lirisë së medias, si dhe dominimin e një diskursi politik toksik. Në vitin 2019, shumica e vendeve të rajonit u renditën më dobët në klasifikimin e Freedom House,<sup>9</sup> përveç Shqipërisë që mbeti në të njëjtin vend, dhe Maqedonisë së Veriut që u rendit pak më lart. Po kështu, edhe në renditjen e vitit 2018 të Transparency International, shumica e vendeve të rajonit shënuan përkeqësim, përveç Bosnjë Hercegovinës që nuk shënoi ndryshim, dhe Maqedonisë së Veriut që pati përmirësim.<sup>10</sup> Si rezultat i përkeqësimit të ekonomisë dhe dobësimit të demokracisë, si dhe mungesës së besimit për të ardhmen e vendit të tyre, shumë të rinj po votojnë me këmbë – duke u larguar drejt përëndimit. Ia vlen të përmendim faktin se shumica e qyteteve dhe fshatrave që përmenden në këtë raport janë boshatisur gjithnjë e më shumë gjatë këtyre 15 viteve të fundit.

Megjithëse situata e përgjithshme ekonomike në gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor po përmirësohet, rajoni vazhdon të vuajë nga vështirësi dhe dobësi ekonomike. Ndonëse papunësia është në rënie - me një nivel mesatar prej 20.9%<sup>11</sup> për vitin 2018, në të gjashtë vendet e rajonit – kjo shifër është përsëri më shumë se tre herë më e lartë se mesatarja e vendeve të BE-së<sup>12</sup>, ndërkohë që një pjesë e popullsisë ka vite që vuan nga papunësia kronike.


Edhe papunësia në radhët e të rinjve vazhdon të jetë në nivele të larta.<sup>13</sup> Shifrat për vitin 2018 shkojnë nga 31.7% në Malin e Zi, deri në 57.7% në Kosovë.<sup>14</sup> Ky rajon ka nivele të larta emigracioni (veçanërisht nga brezi i ri), dhe po kaq të larta janë edhe të ardhurat nga emigrantët. Shumë nga aktivitetet ekonomike dhe tregtare në këtë rajon janë biznese të vogla që operojnë me para në dorë, ndërkohë që edhe ekonomia informale është shumë e përhapur.<sup>15</sup> Investimet e huaja direkte janë relativisht të pakta, si pasojë e paqëndrueshmërisë politike, largimit të kapitalit njerëzor, si dhe problemeve të natyrës ligjore dhe rregullatore. Paralelisht me këtë situatë edhe perceptimi i korrupsionit mbetet në nivele relativisht të larta.

Shkurtimisht, ashtu si thuhet edhe në një raport të Grupit të Këshillimit të Politikave për Ballkanin në Evropë, “të gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor formojnë një rajon tranzitor pa synime të qarta, dhe pa destinacion, një zonë ‘të ndërmjetme’ – diku ndërmjet demokracisë dhe autoritarizmit, ndërmjet ekonomisë së tregut dhe planifikimit nga qeveria, kapitalizmit të egër dhe të kaluarës socialiste.”<sup>16</sup> Në këtë ambjent, interesa të brendshme politike dhe ekonomike jo-transparente, që kombinohen edhe me ndërhyrje të faktorit të jashtëm, po krijojnë një situatë shumë dinamike dhe të paqëndrueshme.

Vlerë të veçantë për këtë raport ka fakti se ky rajon gjendet në mes të rrugës që lidh vendet e origjinës me vendet e destinacionit për drogat, emigrantët, dhe armët. Sa më i paqëndrueshëm të jetë rajoni, aq më tërheqës bëhet si korridor trafikimi. Ky raport identifikon pikat më problematike për aktivitetet e paligjshme në secilin vend, duke i vendosur në një kontekst rajonal.



Harta 1: Trafiqet e paligjshme në rajon



## Korridoret e trafikimit në Ballkan

Pozita gjeografike e vendeve të Ballkanit perëndimor i bën shumë joshëse për trafikantët e drogës, armëve, dhe njerëzve. Ky rajon është ngjitur me Bashkimin Evropian, dhe gjendet midis prodhuesit më të madh në botë të opiumit (Afganistanit) dhe tregjeve më të mëdha të heroinës (Evropës perëndimore). Ky rajon po kthehet gjithmonë e më shumë edhe në një pikë hyrje për kokainën, si dhe një vend ku pastrohen paratë që vijnë nga aktivitete kriminale.

Nëpër këtë rajon kalon edhe korridori i kalimit të paligjshëm të njerëzve nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut drejt Bashkimit Evropian, si emigrantë që largohen nga zonat e konfliktit, apo si viktima të trafikut njerëzor. Po kështu është edhe nyje kryesore për trafikimin e armëve.<sup>17</sup>

Nuk duhet të harrojmë faktin se të gjitha këto aktivitete kriminale nuk zhvillohen vetëm brenda për brenda gadishullit Ballkanik. Pjesa më e madhe e kërkesës për produktet që prodhohen apo transportohen nëpër rajon vjen nga jashtë Ballkanit – veçanërisht nga vende të Bashkimit Evropian. Kjo do të thotë se edhe zgjidhja e këtyre problemeve kërkon bashkëpunim me faktorë dhe organizma që gjenden jashtë këtij rajoni.

“Pjesa më e madhe e kërkesës për produktet që prodhohen apo transportohen nëpër rajon vjen nga jashtë Ballkanit – veçanërisht nga vende të Bashkimit Evropian.”

I ashtuquajturin Korridori Ballkanik përmendet më shumë në lidhje me trafikimin e **heroinës** nga Afganistani, nëpër Turqi, dhe gjashtë vendeve të Ballkanit perëndimor, drejt Bashkimit Evropian. Heroina kalon nga Turqia në drejtim të Bullgarisë apo Greqisë, dhe më pas lëviz nëpër Maqedoninë e Veriut, dhe Serbi. Heroina më tej drejtohet për në veri nëpër të ashtuquajturin Korridori i Evropës Qendrore: nëpër Hungari, Sllovakia, Austri dhe Zvicër. Heroina trafikohet edhe në Itali, duke kaluar nga Maqedonia e Veriut dhe Kosova, nëpërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Nga Serbia dhe Mali i Zi, drogat kalojnë edhe në Bosnjë Hercegovinë, për të vazhduar më pas rrugën për në Kroaci dhe Slloveninë fqinje.<sup>18</sup> Në vitin 2015, llogaritej se trafikantët e opiateve në Evropën juglindore fitonin rreth 1.7 miliardë dollarë në vit.<sup>19</sup> Heroina jo vetëm që trafikohet nëpër vendet e Ballkanit, por në këtë rajon ka edhe pika përpunimi.

Shqipëria dhe Mali i Zi janë pika të rëndësishme të hyrjes së **kokainës** që vjen nga Amerika latine drejt Evropës. Transporti bëhet kryesisht me kontenerë nëpër portet e Durrësit dhe Tivarit. Ngarkesat e drogës më pas shpërndahen nëpër Kosovë, Serbi dhe Bosnjë, nga ku trafikohen drejt Evropës qendrore. Gjithashtu, ka të dhëna se në këtë rajon bëhet edhe përpunimi i kokainës. Mbase më i rëndësishëm është fakti se grupe kriminale nga Ballkani janë të përfshirë në shpërndarjen e kokainës në Evropën perëndimore, veçanërisht në Austri, Greqi, Itali, Belgjikë dhe Hollandë, Spanjë, Suedi, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Shumica e krerëve të këtyre grupeve kriminale jetojnë në vendet e Ballkanit perëndimor, ku bëjnë edhe pastrimin e parave të pista – pasi edhe i kanë këto mundësi.

Ballkani është një rajon tranzit për të gjitha llojet e drogave, por është edhe furnizues i madh i **kanabisit**. Shqipëria ka qenë një prodhues kryesor i kanabisit në rajon, dhe grupe të krimit të organizuar jo vetëm që bëjnë transport kontrabandë të këtij produkti në vendet fqinje me BE-në, por bëjnë edhe shpërndarjen e drogës nëpër të gjithë rajonin. Megjithatë, duket se ka patur një rënie të madhe në kultivimin e kanabisit në Shqipëri, ndërsa janë shtuar ndjeshëm edhe kapjet e ngarkesave të drogës.<sup>20</sup>

Në vendet e Ballkanit perëndimor në përgjithësi, dhe veçanërisht në Shqipëri, kanabisi është droga që përdoret më gjerë, pasi mund të gjendet lehtë dhe lirë. Destinacioni kryesor për kanabisin shqiptar është Italia, dhe transporti bëhet kryesisht me skafe të shpejtë. Në të kaluarën janë përdorur edhe aeroplanë të vegjël. Sipas autoriteteve italiane, në vitin 2017 u kap një shifër rekord prej 90 tonë kanabis që vinte nga Shqipëria. Destinacione të tjera të rëndësishme për kanabisin shqiptar janë Greqia dhe Turqia, shpesh duke kaluar nga Maqedonia e Veriut. Trafikantët zakonisht



përdorin rrugët kryesore, pikat zyrtare të kalimit të kufirit, por ka raste kur kalojnë ilegalisht kufirin edhe nëpër zonat malore për të trafikuar drogën drejt jugut dhe lindjes.

Edhe Deti Jon përdoret për trafikimin e kanabisit drejt Greqisë, dhe më pas drejt Turqisë. Po kështu, sasi të mëdha kanabisi trafikohen drejt Malit të Zi dhe Kosovës nëpërmjet pikave zyrtare të kalimit të kufirit, por edhe me nga pika të paligjshme të kalimit të kufirit. Që atje kanabisi vazhdon rrugëtimin drejt Bosnjës dhe Serbisë, dhe më pas shkon drejt Kroacisë dhe Sllovenisë. Nga Serbia kanabisi shkon edhe drejt Hungarisë, Sllovakisë dhe Austrisë.

Kur trafikimi kryhet nëpërmjet Kosovës, zakonisht rruga kalon nëpër Maqedoninë e Veriut dhe Bullgari; ose nga Kosova drejt Serbisë dhe Bullgarisë. Kohët e fundit thuhet se sasia e kultivimit të kanabisit në Shqipëri ka rënë ndjeshëm, megjithëse vazhdon akoma në një shkallë më të vogël dhe më fshehurazi se më parë. Qeverisë i është bërë presion për të luftuar kultivimin e drogës, si pjesë e përpjekjeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Duhet përmendur fakti se kanabisi (që shkon drejt lindjes) nganjëherë përdoret për të paguar ngarkesat me heroinë (që shkon drejt perëndimit).

Edhe **drogat sintetike** janë një problem në rritje për Ballkanin. Droga të tilla, si ekstazi, amfetaminat, dhe metamfetaminat trafikohen nëpër rajon, më së shumti nga Holanda, nëpërmjet Kroacisë dhe Hungarisë, drejt Bosnjës dhe Serbisë, apo dhe nga Kosova drejt Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, Greqisë dhe Turqisë. Drogat sintetike po prodhohen gjithnjë e më shumë edhe në Ballkan, veçanërisht në Bosnjë dhe Serbi (që është edhe tregu kryesor për drogat sintetike në rajon).


Kontrabanda e **cigareve** është një tjetër aktivitet me rëndësi për grupet e krimit të organizuar në Ballkan. Pika kryesore është Mali i Zi, ku prodhohen dhe falsifikohen cigare të markave të njohura, që më pas kalojnë kontrabandë nga porti i Tivarit drejt vendeve të ndryshme të BE-së, por dhe drejt Lindjes së Mesme dhe Afrikës. Cigaret malazeze trafikohen edhe nëpër rajon. Cigare prodhohen në mënyrë të paligjshme edhe në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, dhe Serbi. Ato më pas kalojnë kontrabandë në Mal të Zi, nga ku trafikohen së bashku me cigaret malazeze drejt BE-së, e më tej. Së fundmi, Kosova është kthyer në një pikë të rëndësishme rajonale për shpërndarjen e cigareve.<sup>21</sup> Ngarkesat hyjnë kontrabandë nga Serbia, Maqedonia e Veriut, dhe Bullgaria, dhe më pas transportohen nëpërmjet kufirit poroz me Malin e Zi.

Ballkani është edhe burim për trafikun e **armëve të zjarrit**. Konfliktet e armatosura në vitet '90 në ish-Jugosllavi, trazirat e vitit '97 në Shqipëri, dhe përplasjet në Maqedoninë e Veriut në vitin 2001, kanë bërë që të ketë akoma miliona armë në këtë rajon.

Një pjesë e këtyre armëve trafikohen drejt vendeve të BE-së, zakonisht për t'u përdorur nga grupe të tjera kriminale, si grupet e motoçiklistëve në vendet nordike, apo nga grupe të mafias italiane. Armë nga Ballkani janë përdorur edhe nga terroristët islamikë.<sup>22</sup> Armët që trafikohen nga vendet e Ballkanit perëndimor zakonisht ndjekin të njëjtën rrugë si drogat. Grupe të krimit të organizuar nga Bosnjë Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe Serbia i trafikojnë armët drejt vendeve të Evropës qendrore si Kroacia, Hungaria, Sllovakia dhe Austria, dhe që aty më pas shpërndahen drejt Francës, Belgjikës, Hollandës, Danimarkës, Suedisë, dhe Norvegjisë. Armët me origjinë nga Shqipëria zakonisht kalojnë kontrabandë me skafë drejt Italisë, ku klienti kryesor është mafia siciliane. Armët mund të trafikohen më pas edhe nga Italia drejt vendeve të tjera të Evropës perëndimore. Armë dhe eksplozivë nga Ballkani përdoren edhe nga grupe kriminale në vetë këtë rajon. Përveç kësaj, kompanitë e policisë private shpesh kanë armë në zotërim, dhe në shumë raste janë të lidhura me organizata kriminale.

## Profilet of zonave problematike të krimit të organizuar

Ky raport është disi i pazakontë pasi përqendrohet mbi zona dhe pozicione gjeografike të caktuara, dhe jo tek njerëzit apo tregje të lidhura me veprimtaritë kriminale të grupeve të organizuara. Ideja është që të fokusohemi tek faktorët që i bëjnë këto vende të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të paligjshme të krimit të organizuar, të




analizojmë marrëdhëniet në terren dhe elementet e përfshira në këto procese, të identifikojmë vendndodhjen e tyre në hartë, dhe të krijojmë një ide më të qartë në lidhje me gjeografinë e krimit në rajon.

Vendndodhjet u përzgjedhën fillimisht në bazë të informacioneve dhe njohurive të anëtarëve të rrjetit të Iniciativës Globale - Observatorit të Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar in Evropën Juglindore. Ky informacion u mblodh dhe u analizua nëpërmjet vizitave në terren, intervistave, dhe kërkesave për informacion zyrtar. Pas analizimit të informacioneve, në përfundim të këtij procesi disa nga këto supozime fillestare u konfirmuan si të vërteta, ndërsa disa të tjera dolën se nuk qëndronin, si pasojë e ndryshimeve në tregje, apo zhvillimeve të reja në terren.

Informatat për një vend të caktuar ndonjëherë ndihmuan për të marrë informacione në lidhje me zona të tjera problematike – që fillimisht nuk ishin marrë në konsideratë. Meqë, me sa dimë ne, kjo është hera e parë që një studim po fokusohet në këtë drejtim, GI mirëpret sugjerime në lidhje me zona të tjera problematike, dhe ne do të vazhdojmë të fokusohemi në zona të ndryshme, si pjesë e punës të Observatorit për të luftuar krimin e organizuar në Evropën juglindore.

**Grafiku 1:** Çfarë e bën problematike një zonë?



Gjatë analizës të zonave problematike, dolën në pah disa karakteristika të veçanta. E para dhe më e evidente ishte vendndodhja (shiko Grafikon 1).

Duke qenë se Ballkani është një rajon *tranzit* për aktivitete të paligjshme, shumica e zonave problematike në lidhje me krimin e organizuar ishin vende ku mallrat hyjnë e dalin: porte, aeroporte, pika të kalimit të kufirit, apo zona kufitare. Po kështu, ka zona problematike edhe përgjatë autostradave kryesore, që shërbejnë si korridore transporti (veri-jug dhe lindje-perëndim), si dhe zona ku kryqëzohen rrugë të rëndësishme. Në disa raste të tjera, pikat problematike janë në zona të largëta: përgjatë kufijve me kontroll jo të fortë, apo – në rastin e laboratorëve për prodhimin e drogës – në mes të humbëtirës. Disa nga këto zona janë goditur rëndë nga konfliktet dhe luftërat e të kaluarës.

Faktori i dytë është gjendja e vështirë ekonomike. Shumë nga zonat problematike që përmenden në këtë raport kanë qenë krahina të varfra që në kohën e komunizmit, dhe gjendja është përkeqësuar akoma më tej me kalimin e viteve. Në këto zona vihet re një nivel i lartë papunësie (veçanërisht papunësi e lartë në mes të rinjve, dhe pamundësi për të gjetur punë për një kohë të gjatë), një përqindje të lartë të të rinjve në popullatë, emigracion, probleme me shëndetin mendor (si nivele të larta depresioni dhe vetëvrasje), si dhe rënie të numrit të banorëve.

Faktori i tretë është qeverisja e dobët, dhe kjo është e lidhur me dy faktorët e mësipërm. Disa nga vendet e identifikuar në këtë raport janë krahina që kontrollohen fort nga politikanë të zonës, që kanë lidhje të ngushta me partinë në pushtet dhe me grupe apo elementë kriminalë. Zona të tjera janë krahina që pretendohen nga shtete të ndryshme, dhe ku juridiksioni nuk është i përcaktuar qartë, dhe kjo nuk e lejon qeverinë qendrore që të ushtrojë kontroll të plotë. Disa zona të tjera janë krahina relativisht të largëta që janë lënë pas dore nga qeveria, apo që nuk janë zhvilluar sa duhet, dhe për pasojë bazohen mbi ekonominë informale për të mbijetuar.



Ato vende ku hasen të tre këto faktorë kanë probabilitet të lartë që të kthehen në zona të favorshme për krimin e organizuar.

la vlen të përmendet fakti se këto zona problematike zakonisht kanë një numër relativisht të madh emigrantësh në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një pjesë e popullsisë është larguar nga këto zona si pasojë e konflikteve, prapambetjes, qeverisjes së keqe, dhe krijimit të mundësive të reja për të lëvizur më lehtë jashtë shtetit. Kjo diasporë mund të jetë një burim i dobishëm të ardhurash, por mund të krijojë edhe lidhje me krimin e organizuar në vende të tjera. Përveç shqyrtimit dhe analizimit të zonave problematike individuale, duhet të kemi parasysh edhe kontekstin gjeografik dhe historik të rajonit. Rënia e sistemit komunist dhe shpërbërja e Jugosllavisë solli ndryshime dramatike në strukturën politike dhe ekonomike të rajonit. Lufta në Jugosllavi, në vitet 1990, sanksionet ekonomike, si dhe proceset e privatizimit dhe periudha e tranzicionit, krijuan mundësi të reja për grupet kriminale. Po kështu, krijimi i shtatë shteteve të reja në territorin e ish-Jugosllavisë krijoi një mori me kufij dhe ndarje të reja territoriale, tensione midis fqinjëve të rinj dhe brenda vetë këtyre shteteve, si dhe u krijuan struktura administrative që mund të shfrytëzoheshin për qëllime kriminale. Gjurmë të këtyre zhvillimeve mund të shihen edhe në ditët tona në disa prej zonave problematike, dhe këto faktorë i kanë dhënë formë ekosistemit të krimit që do të përshkruhet më vonë në këtë raport.


## Nyje kufitare: korridore për veprimtari kriminale të shumëllojshme

*Gjatë punës kërkimore për hartimin e këtij raporti, një numër pikash të kalimit të kufirit u identifikuan si zona problematike për ushtrim aktivitetesh të paligjshme. E veçanta e këtyre zonave është vendndodhja e tyre pranë nyjeve kufitare, dhe jo aq trafiku kontrabandë i ndonjë malli të veçantë. Shumica e grupeve që operojnë në këto krahina janë kriminelë që merren më disa aktivitete kriminale (poli-kriminelë) dhe që kontrollojnë një korridor të caktuar nëpër të cilin kalojnë në mënyrë të paligjshme një numër i madh njerëzish dhe sasi të mëdha mallrash (armë, drogë, cigare, makina, dhe mallra të konsumit të gjerë). Grupet kriminale mund të merren edhe me trafiqe të tjera që nuk u përmendën këtu më lart, por kjo është një listë tipike e trafiqeve të paligjshme në pikat kufitare, që përdoren për kalim kontrabande, dhe llojet kryesore të aktiviteteve kriminale ndërkuftare – shiko Hartën 2. Këtu më poshtë jepet një listë e nyjeve kufitare duke filluar nga veriu e poshtë.*

**Subotica** (në vitin 2017 popullsia ishte 140,000 banorë<sup>23</sup>) ndodhet në veri të Serbisë, ngjitur me kufirin me Hungarinë, përgjatë autostradës ndërkombëtare E75, që është edhe arteria kryesore e transportit veri-jug nga Sllovakia në Greqi. Ky është një korridor i përdorur dendur për trafikun e drogave dhe cigareve (gjë që dëshmohet edhe nga sasitë e mëdha të kanabisit të kapur nga policia, dhe konfiskimet e cigareve kontrabandë, shumica e të cilave mbajnë pulla fiskale të Maqedonisë së Veriut). Subotica ka qenë një pikë kalimi që përdorej shumë nga emigrantët, por që me ndërtimin e një muri nga ana hungareze e kufirit në vitin 2015, emigrantët janë mbledhur në anën serbe, në kampe dhe strehime të improvizuara. Kjo ka shkaktuar një krizë humanitare, por edhe një treg për kriminelët, për shfrytëzimin e emigrantëve të dëshpëruar, trafikimin e qenieve njerëzore, dhe aktivitete të tjera kriminale.

Qyteti **Vërshac (Vršac)** (me 50,000 banorë<sup>24</sup>) ndodhet në pjesën jugore të provincës së Vojvodinës, në veri të Serbisë pranë kufirit me Rumaninë. Pranë qytetit ndodhet pika e kalimit kufitar të Vatin / Stamora Moravița, që mendohet se është një pikë e rëndësishme për kontrabandën e cigareve dhe ripaketimin e tyre. Një burim policor, që e njeh mirë këtë pikë kalimi kufitar, thotë: "Sido që të jetë puna, nëse do që t'i nxjerrësh (cigaret) jashtë vendit, apo t'i futësh brenda në vend, duhet patjetër të ndalesh në Vërshac dhe të ripaketosh mallin."<sup>25</sup> Pranë Vërshac janë konfiskuar edhe sasi heroine. Kjo zonë problematike – përgjatë autostradës që lidh Beogradin me Timishoarën – mendohet se është përdorur edhe për kalimin e paligjshëm të emigrantëve.

Krahina në lindje të **Tuzlas** (Bosnjë Hercegovinë), reth **Bijeljinas** dhe **Zvornikut**, përmendet shpesh si korridor trafiku për emigrantë, bagëti, lëndë drusore, drogë, makina, veshje dhe para të falsifikuara. Po kështu njihet edhe si



Harta 2: Nyjet kufitare



pikë për kontrabandën e cigareve. Pika e kalimit kufitar **Raça/Graniçni** midis Bosnjë Hercegovinës dhe Serbisë (me një numër të madh makinash që hyjnë e dalin) konsiderohet si nyje shumë aktive për aktivitetet e paligjshme. Në vitin 2018, në këtë pikë kalimi kufitar u kapën 200 kuti me ekstazi. Punonjësit e doganës dhe policisë kufitare në këtë pikë kanë marrë nam si shumë të korruptuar, dhe janë implikuar në kontrabandë dhe marrje ryshfetesh.

Rajoni i **Trebinjes** në Hercegovinën lindore (që është pjesë e Republikës së Serbëve të Bosnjës - Republika Srpska) ka një kufi 70 kilometra të gjatë me Kroacinë (në perëndim) dhe 130 kilometra kufi me Malin e Zi. Kjo bën që kjo krahinë të jetë vendi ideal për kalimin e drogave nga Mali i Zi (duke përfshirë edhe kanabis që vjen nga Shqipëria, dhe kokainë nga portet malazeze) për në Bosnjë dhe Kroaci, dhe që aty nëpër vende të tjera të BE-së. Thuhet se janë krijuar lidhje të forta midis grupeve kriminale në rajonin e Trebinjes dhe Dubrovnikut (që është 32 kilometra larg). Ka patur njoftime se është trafikuar edhe heroinë nëpër këtë rajon nga Mali i Zi dhe Serbia.<sup>26</sup> Trebinje është gjithashtu një pikë me rëndësi për kontrabandën e cigareve nga Mali i Zi. Cigaret lëvizin edhe në drejtim të veriut duke furnizuar tregun e zi vendas (ku po rritet ndjeshëm çmimi i cigareve të shitura rregullisht). Që nga viti 2015, Trebinje është përdorur edhe si korridor nga trafikantët për kalimin e paligjshëm të emigrantëve përtëj kufirit.


Dy qytete në këtë rajon – **Trebinje** (30,000 banorë<sup>27</sup>) dhe **Bileça** (shiko më poshtë) – përmenden shpesh si zona problematike në lidhje me trafikimin. Mendohet se ka grupe kriminale që zhvillojnë aktivitetin e tyre në qytezat Gacko dhe Nevesinje. Kjo krahinë nuk është shumë e populluar, është goxha e prapambetur dhe në vështirësi ekonomike. Është terren malor dhe është e vështirë të patrullohet. Raportohet se kontrolli në pikat e kalimit kufitar mund të evitohet shumë lehtë, duke paguar ryshfete apo duke kaluar kufirin jeshil në mënyrë ilegale: thuhet se ka shumë pikë për kalimin e paligjshëm të kufirit pranë Trebinjes.<sup>28</sup> Gjatë dekadës së fundit, një numër i madh banorësh të kësaj krahine janë arrestuar pasi janë kapur duke trafikuar kanabis, kokainë dhe heroinë. Ajo që tërheq vëmendjen është se shumë persona janë arrestuar disa herë për përfshirje në këto aktivitete kriminale. Po kështu janë arrestuar edhe policë nga kjo krahinë për përfshirje në trafikim.

**Bileça** është një qytet me rreth 10,000 banorë,<sup>29</sup> që ndodhet pranë kufirit me Malin e Zi dhe pikës së kalimit kufitar midis **Deleusa** dhe **Vračanoviçit**. Kontrabanda e cigareve (veçanërisht drejt Kroacisë fqinje) raportohet se është diçka e zakonshme në këtë zonë, dhe se ka grupe që ka kohë që merren me këtë aktivitet. Trafiku thuhet se bëhet pa vështirësi, si rezultat i korruptimit të policëve dhe dhe zyrtarëve të kufirit. Materiale nga çështje gjyqësore që u studiuuan nga GI të çojnë në përfundimin se “reziku i zbulimit apo arrestimit për pjesëmarrje në rrjete kontrabande është mjaft i ulët, pasi pjesa më e madhe e policëve janë përfshirë edhe vetë në aktivitete kontrabande.” Së fundmi, kjo krahinë është përdorur gjerësisht për kalimin e paligjshëm të emigrantëve nga elementë kriminalë.

**Rozhaje** është një qytet i vogël në verilindje të Malit të Zi (me rreth 23,000 banorë<sup>30</sup>) pranë kufirit me Kosovën dhe Serbinë. Shumica e banorëve janë (myslimanë) boshnjakë. Shumë banorë janë larguar nga ky qytet drejt emigracionit. Rozhaje ndodhet pranë rrugëve që të çojnë në Pejë dhe Novi Pazar, dhe konsiderohet si zonë problematike për trafikimin e drogës. Në tetor 2014, kreu i grupit të Rozhajes, Safet Kalic, u arrestua në Austri. Ai u akuzua për pastrimin e parave të pista, për shumën 7.7 milionë euro, që mendoheshin se ishin fituar nga trafikimi i drogës. Disa nga pronat e tij u konfiskuan. Familja Kalic më pas doli e pafajshme dhe u kompensuan nga Mali i Zi, por në Gjermani është hapur një gjyq tjetër kundër tij, për pjesëmarrje në aktivitete të paligjshme.

Në veri-lindje të Rozhajes, në rrugën për në Novi Pazar, pika e kalimit kufitar **Spiljani / Draçenovac** njihet si zonë problematike për trafikimin e cigareve, drogave, ilaçeve, si dhe emigrantëve. Në disa raste aty janë kapur para të falsifikuara dhe dokumente identiteti false. Trafikimi kryhet edhe përgjatë kufirit jeshil midis Malit të Zi dhe Kosovës. Një dëshmitar okular nga fshati Balotice, pesë kilometra në lindje të Rozhajes, i tregoi reporterëve të GI se ka parë rregullisht trafikantë që kalojnë armë dhe drogë nga Kosova për në Mal të Zi. Ai përshkruan karvane me më shumë se 100 kuaj.<sup>31</sup> Kontrabanda nuk pengohet dhe bëhet më e lehtë nga terreni i thyer malor, dhe zyrtarë të korruptuar nga të dyja anët e kufirit.

Zona rreth pikës së kalimit kufitar në **Kulla / Kula**, midis Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe zona rreth fshatit **Çakor** mendohet se është një zonë problematike për trafikimin e cigareve dhe drogave.<sup>32</sup> Ky rajon ka një terren të thyer malor, ku është vështirë të hyhet dhe të patrullohet me makina. Thuhet se trafikantët përdorin gomerë dhe kuaj për të kaluar kufirin nga shtigje dhe monopate. Në prill 2018, policia e Kosovës bllokoi 1.3 milionë cigare në një





fshat pranë kufirit. Kjo sasi cigaresh ishte ngarkuar mbi gjashtë kuaj të pashoqëruar nga njerëz. Kontrolli i kufirit në këtë krahinë është bërë akoma më i vështirë si pasojë e ngadalësimit të procesit për arritjen e një marrëveshjeje për përcaktimin e kufirit midis dy vendeve.

**Idomeni / Gevgelija** është një pikë e rëndësishme për kalimin e kufirit midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, përgjatë autostradës E75 që lidh Greqinë, Shkupin dhe më tej në veri, deri sa arrin në Hungari dhe Sllovakia. Kjo pikë kalimi bëri bujë në vitin 2015, gjatë krizës së refugjatëve dhe emigrantëve, pasi pati përplasje midis policisë dhe grupeve të mëdha me njerëz në lëvizje, që vinin kryesisht nga Lindja e Mesme. Ajo është gjithashtu një pikë tranziti për trafikimin e drogës: veçanërisht heroinë që vjen nga jashtë rajonit; dhe kanabis (nga Shqipëria) që trafikohet drejt Greqisë dhe Turqisë. Në maj 2018, në këtë pikë të kalimit kufitar u kapën 130 kilogramë kanabis. Në dhjetor të po atij viti u bllokuan 515 kilogramë kanabis.

Pika e kalimit kufitar në **Jazhince / Gllboçicë** pranë Tetovës, në Maqedoninë e Veriut, konsiderohet një zonë problematike për trafikimin e mallrave të ndryshme kontrabandë. Mendohet se personeli dhe puna në këtë pikë të kalimit të kufirit kontrollohet nga zyrtarë partiakë lokalë. Kjo është një praktikë pune shumëvjeçare, sipas të cilës kontrolli i një pike të kalimit kufitar i kalohet në mënyrë të heshtur një aleati politik, në këmbim të mbështetjes për partinë në pushtet. Një ish-oficer police shpjegon: "Pas mesnatës, rreth orës 3 të mëngjesit, policëve dhe doganierëve u jepej shpesh urdhër nga shefat e tyre që të fiknin të gjitha kamerat, dhe të bënin sikur nuk shikonin gjë për nja gjysëm ore. Për këtë, natyrisht, që shpërbleheshin mirë. Kamioni që kalonte kufirin në atë orë i përkiste një grupi kriminal që i ndante fitimet me zyrtarë të lartë të partisë në pushtet në Shqipëri."<sup>33</sup> Jo shumë larg nga kjo pikë zyrtare e kalimit kufitar ka edhe një shteg kalimi të paligjshëm të kufirit, që përdoret nga grupet kriminale që trafikojnë mallra më kamionë, traktorë dhe kuaj.

**Shkodra**, në verilindje të Shqipërisë, është një zonë problematike për krimin e organizuar si pikë e rëndësishme për trafikimin e kanabisit, dhe afërsisht me Malin e Zi. Prefektura e kishte rreth 200,000 banorë<sup>34</sup> në janar 2019, dhe Shkodra është qyteti i katërt më i madh në Shqipëri. Shkodra njihet si vend ku zhvillohej kontrabanda që gjatë luftërave në Ballkan, gjatë vitete '90. Në ditët tona, grupet kriminale në qytet janë të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore, para me fajde me interesa të larta, vënia gjobash, si dhe trafikimin e drogave dhe emigrantëve. Ka të paktën katër klane të fuqishme kriminale në këtë qytet, dhe shumica e pjesëtarëve të këtyre grupeve kanë lidhje familjare me njëri-tjetrin.<sup>35</sup> Këto familje kriminale të stilit mafioz mendohet se kanë lidhje të forta me grupe kriminale në zona të tjera të vendit, si dhe në Kosovë, dhe Mal të Zi.<sup>36</sup> Ato mendohet se janë të lidhura me grupe të diasporës në Evropën perëndimore, si dhe me politikanë e parti politike. Nga fundi i vitit 2018, pesë persona u vranë dhe dy u rrëmbyen në Shkodër, duke shënuar edhe valën më të fundit të dhunës në këtë qytet.

Porti i **Durrësit** (një prefekturë me rreth 290,000 banorë, sipas të dhënave të nxjerra në janar 2019<sup>37</sup>) është porti më i madh në Shqipëri, dhe një zonë problematike për shumë lloje trafikimi. Është një pikë hyrëse për kalimin e kontenerëve që vijnë me anije nga Amerika latine. Ky port përdoret edhe nga kompanitë e trageteve që udhëtojnë rregullisht drejt Italisë. Drogat kalojnë për në Itali të fshehura në autobuzë, makina dhe kamionë, ndërsa ngarkesat e mëdha të drogës arrijnë me kontenerë. Tani së fundmi, një shofer kamioni u arrestua më 28 mars 2019 me dy kilogramë heroinë të pastër që i kishte fshehur në trup.<sup>38</sup> Disa burime thanë për GI se lëkura e papërpunuar po përdoret për të fshehur importin e narkotikëve, meqë era e fortë e lëkurës thuhet se maskon në mënyrë të efektshme erën e drogës. Në shkurt 2018, policia shqiptare konfiskoi një ngarkesë me 613 kilogramë kokainë që vinte nga Kolumbia në një kontener plot me banane. Përdorimi gjithnjë e më i shpeshtë i pajisjeve skanuese (duke përfshirë edhe Njësinë e kontrollit të portit që mbështetet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogën - UNODC) mund të krijojë mundësi për një kontroll më efikas të portit nga policia dhe dogana, por nga ana tjetër një punonjës dogane tha në një intervistë se zyrtarët e lartë nganjëherë i "dekurajojnë" vartësit e tyre nga kontrolli i makinave të caktuara.<sup>39</sup>

**Vlora**, në jug të Shqipërisë (prefektura ka rreth 190,000 banorë, sipas të dhënave të nxjerra në janar 2019<sup>40</sup>), është porti i dytë më i madh në vend. Afërsia me Italinë e ka bërë këtë zonë si pikë nisje për skafet e shpejta që përdoren për trafikim, veçanërisht për kanabis, që deri këto kohët e fundit kultivohej në sasi të mëdha në këtë krahinë. Që prej shumë vitesh kriminelë nga Vlora janë transferuar drejt Italisë dhe Spanjës, ku vazhdojnë të merren me



aktivitete të paligjshme. Së fundmi, ky qytet është tronditur nga një sërë vrasjesh (duke përfshirë edhe vrasjen e kreut të një grupi kriminal, Edision Harizaj në nëntor 2018), që duket se kanë ardhur si rezultat i luftës për kontrollin e tregjeve jashtë Shqipërisë, si dhe vrasje për hakmarrje midis grupeve kriminale. Mendohet se aktivitetet kriminale në Vlorë dhe rethina përfitojnë edhe nga bashkëpunimi midis kriminelëve dhe policisë, si dhe nga mbrojtja e disa politikanëve.<sup>41</sup>

**Saranda** është një qytet port shumë i bukur në bregdetin shqiptar, pranë kufirit me Greqinë dhe përballë ishullit të Korfuzit. Ky qytet, që ndodhet jo larg qytezës antike të Butrintit, është një destinacion turistik për mijëra pushues, por ka edhe një port me shumë lëvizje. Gjatë viteve të fundit, popullsia e Sarandës gati është dyfishuar (me rreth 55,000 banorë<sup>42</sup>). Ka patur një bum ndërtimesh në qytet, dhe porti është zgjeruar. Zona e Sarandës thuhet se është qendër trafikimi dhe veprimtarish të paligjshme. Trafikantët përdorin edhe mushka për të kaluar drogë (kryesisht kanabis) përtej kufirit në Greqi. Burime të ndryshme thonë për GI, se policia vendore dhe zyrtarët e policisë kufitare e dinë se cilët janë trafikantët kryesorë, por kanë marrë urdhëra nga shefat e tyre që të mos i ndalojnë.<sup>43</sup> Trafikantët mendohet se kalojnë drogë – kryesisht heroinë dhe kokainë – nga kufiri në Qafë Botë / Sagiada, ku mungojnë pajisjet skanuese. Ka zëra se pjesa më e madhe e këtyre drogave shkon drejt portit grek të Igumenicës, dhe më pas i drejtohet Italisë së jugut. Në janar 2019, një nga krerët e krimit në këtë krahinë, Klement Balili, iu dorëzua policisë. Balili kërkohet që prej tre vjetësh, pasi akuzohej për trafikimin e 700 kilogramëve kanabis për në Greqi.<sup>44</sup>

## Beteja për portet e Malit të Zi: Tivari, Budva dhe Kotori


### Një rrëfjë e dy klaneve

Një konflikt i përgjakshëm ka vite që vazhdon - që nga viti 2014 – në lidhje me kontrollin e trafikut të kokainës (përveç trafiqeve të tjera) nëpër portet e Malit të Zi. Sulme dhe hakmarrje të njëpasnjëshme midis grupeve Shkaljari (Shkaljari) dhe Kavaç (Kavaç) – që i kanë marrë emrat nga fshatra në bashkinë Kotor – kanë shënuar një cikël dhune me vrasje dhe vënie eksplozivi, bomba dhe atentate me snajper. Ky konflikt është përhapur më tej duke përfshirë edhe një numër grupesh kriminale nga Serbia dhe Mali i Zi, që janë reshtuar përkrah njërit apo tjetrit klan. Këto përplasje kanë sjellë një sërë pasojash dhe shkatërrimesh përgjatë bregdetit të bukur malazez, dhjetëra vrasje në Mal të Zi dhe Serbi (për shumicën e tyre nuk dihet se cilët janë vrasësit), si dhe përhapje të dhunës edhe jashtë vendit – siç ishte rasti i incidentit me të shtëna me armë në Vjenë, në dhjetor 2018.

Bregdeti malazez ka një sërë karakteristikash që e bëjnë atë një zonë problematike të përshtatshme për trafikim, si pozicioni gjeografik; infrastruktura e mirë; mbështetja politike, dhe një masë e tërë të rinjsh që nuk kanë shumë alternativa për punë.<sup>45</sup>

Më shumë se një dekadë më parë, pjesa më e madhe e trafikimit të drogës në rajon kontrollohej nga një klan i Kotorit, që kishte lidhje me furnizuesit e kokainës në Amerikën e Jugut dhe me mafian italiane. Droga mendohej se dërgohej me anije nga Argjentina, Uruguai, dhe Kolumbia (dhe nganjëherë edhe nga Brazili) drejt portve të Valencias, portit italian Gioia Tauro në Kalabri (që kontrollohej nga Ndrangheta), porte në Hollandë dhe Greqi, si dhe në portin malazez të Tivari. Që aty droga merrej në dorëzim nga anëtarë të tjerë të klanit të Kotorit, dhe shpërndahej nëpër Evropë. Klani i Kotorit kishte reputacion si grup i efektshëm dhe i besueshëm.

Por me kalimin e viteve klani kaloi nëpër një periudhë krize dhe mungesë udhëheqjeje. Dragan Dudiç ('Fric') – një 'biznesmen' dhe kriminel që kishte lidhje të forta me politikën, me biznesmenin Rodoljub Radulović, dhe Darko Shariç ('mbreti i kokainës' në Ballkan) – u vra ndërsa ishte ulur në një kafene në Kotor, në maj 2010. Në vitin 2014, Darko Shariç u dorëzua në polici, pasi i ishte fshehur autoriteteve që nga viti 2010. Vëllai i tij, Dusko, u arrestua nga autoritetet malazeze në vitin 2010, i akuzuar për trafik dhe kontrabandë.



Në vitin 2018, Darko Shariç u dënua me 15 vjet burg për trafikimin e 5.5 tonëve kokainë nga Amerika e Jugut në Evropë, në vitet 2008 dhe 2009.<sup>46</sup> Po kështu ai akuzohej për pastrimin e parave të pista, për rreth 22 milionë euro nga shitja e drogës. Nga studimet dhe puna kërkimore llogaritet se Shariç ka investuar rreth 2-3 miliardë euro në vendet e Ballkanit perëndimor, si pjesë e aktiviteteve për pastrimin e parave të pista, edhe nëpërmjet një banke që ishte pronë e vëllait të presidentit malazez.<sup>47</sup>

Në këtë situatë kur mungonte udhëheqja e klanit, filoi edhe lufta brenda vetë organizatës kriminale, kur një nga pjesëtarët e grupit, Goran Radoman, u fajësua për zhdukjen e 200 kilogramëve kokainë në Valencia. Në vitin 2014, kjo çoi në konflikte të brendshme, dhe ndarjen e grupit të fuqishëm të Kotorit në dy klane – Kavaç dhe Shkaljari. Që nga kjo pikë, ashtu siç thamë më lart, nisi një konflikt i përgjakshëm që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Niveli i lartë i dhunës mund të shpjegohet pjesërisht nga shuma e madhe e parave në lojë. Llogaritet se një kilogram kokainë mund të sjellë 75,000 – 80,000 euro në tregjet e Evropës perëndimore, nga të cilat grupi malazez merr për vete gjysmën e këtyre parave. Pjesa tjetër shkon për pagesën e blerjes në origjinë (rreth 2,000 euro për kilogram), transportin me anije dhe nëpër kufij (18,000 - 20,000 euro), si dhe magazinimin dhe shpërndarjen (rreth 13,000 euro). Duke llogaritur se një grup kriminal i organizuar në rajon trafikon mesatarisht nga 500 deri në 1,000 kilogramë kokainë në vit, atëherë i bie se fitimi mund të jetë shumë i madh. Një pjesë e këtyre parave mendohet të jetë pastruar duke u investuar në pasuri të paluajtshme, hotele, kazino, dhe restorante në Serbi, Kotor, Tivar dhe Budva, si dhe nëpërmjet bankave malazeze dhe të huaja.

Lufta e klaneve ka njollësuar edhe imazhin e qyteteve turistike si Kotori dhe Budva. Qyteti-kala i Kotorit (me 22,000 banorë<sup>48</sup>) është një zonë e mbrojtur nga UNESCO, dhe është qendra e një prej akademive detare më të mëdha, dhe më të vjetra në rajon, ndërsa Budva (me 20,000 banorë<sup>49</sup>) është një destinacion turistik që njihet për plazhet e saj, jetën e natës dhe festivale. Gjatë viteve të fundit, këto qytete janë bërë dëshmitare të shkëmbimeve të zjarrit, dhe shpërthimeve të eksplozivit në mes të ditës.

Më 20 shkurt 2015, Radoman u vra në një pritë në lagjen Beogradi i Ri, në kryeqytetin serb. Vrasësi, që nuk dihet akoma se kush ishte, e qëlloi të paktën me 25 plumba kalashnikov. Pak orë përpara këtij incidenti (në mes të ditës), makina e mikut të ngushtë të Radomanit, Milan Vujotić, u hodh në erë nga një bombë. Kjo shkaktoi një sërë incidentesh me sulme dhe goditje për hakmarrje në Kotor, Budva dhe Podgoricë. Klanet zakonisht i rekrutojnë pjesëtarët e tyre nga rrethi familjar dhe shoqëria, dhe për pasojë dëshira për hakmarrje është e ngulitur thellë tek këto klane.

Më 27 tetor 2015, Goran Xhuriçković (Đuričković), një pjesëtar i klanit Shkaljari, u qëllua nga një snajper nga muret e qytetit të vjetër të Budvës. Mendohet se ai që qëlloi me armë ishte Srdjan Popović, nga Bosnjë Hercegovina. Ai u arrestua në Graz, Austri, në gusht 2017. Një anëtar i klanit Shkaljari u vra nga një snajper në shtator 2016, ndërsa gjendej në burg. Mund të përmendim dhjetëra raste të tilla.

Kriminelët duket se janë gjithmonë një hap përpara policisë. Një teori është se Kotori monitorohet nga kamera sigurie që janë instaluar nga grupet kriminale, dhe jo nga policia. Me sa duket, kamerat janë instaluar pjesërisht për të monitoruar lëvizjet e policisë.<sup>50</sup> Po kështu, një zyrtar i lartë i policisë së Kotorit – që u arrestua në shtator 2016 – u akuzua se i jepte informacione bandës Kavaç.

Më pas dhuna e kaloi kufirin e Malit të Zi, dhe filluan incidentet në Serbi. Një pikë kthese duket se ishte vrasja e kreut të tifozeve të Partizanit të Beogradit, dhe trafikantit të dënua të drogës, Aleksandër Stanković (që nihej edhe si 'Sale Mutavi') në tetor 2016. Vrasja e tij mendohej se kishte të bënte me një mosmarrëveshje rreth një ngarkese me kokainë që nuk ishte paguar.

Pas këtij incidenti, ministri serb i policisë Nebojša Stefanović deklaroi luftë ndaj mafias vendase – megjithëse disa analistë kanë tërhequr vëmendjen se policia ka goditur disa grupe të caktuara më fort se disa të tjera.<sup>51</sup> Pjesa më e madhe e 52 vrasjeve që kanë ndodhur në Beograd që nga viti 2012 mendohet se lidhen me konfliktin midis grupeve Shkaljari dhe Kavaç, megjithëse situata komplikohet akoma më tej, si pasojë e lidhjeve të këtyre klaneve me grupe tradicionale kriminale, si banda e Luka Bojović dhe klani Mutavi. Edhe pas arrestimit të kreut të grupit Shkaljari, Joviča Vukotić, në Turqi në shtator 2018, dhe kreut të klanit Kavaç, Slobodan Kashçelan, në dhjetor 2018



në Pragë, dhuna vazhdon – gjë që vërtetohet nga atentati kundër Vladimir Roganoviç, në Vjenë në dhjetor 2018 (Lexo kapitullin mbi krimin ballkanik jashtë rajonit).

## Hapu Tivar!

Situata në portin e Tivarit (një qytet me 42,000 banorë<sup>52</sup>), më në jug se Kotori dhe Budva, duket të jetë më pak e dhunshme – megjithëse në këtë qytet ka patur pesë vrasje të stilit mafioz gjatë tre viteve të fundit. Kjo mbase ndodh ngaqë karteli i Tivarit konsiderohet si organizatë efikase, e disiplinuar, dhe me lidhje të shumta. Trafikimi i drogës nëpërmjet Tivarit duket se mundësohet nga kontaktet e kriminelëve serbë dhe malazezë me trafikantët në Karaibe dhe në Amerikën latine. Për shembull, në vitin 2014 policia konfiskoi 250 kilogramë kokainë të fshehur në një kontenier me banane nga Ekuadori (me destinacion Shqipërinë). Askush nuk u arrestua. Në qershor 2018, në Tivar u kapën 38 kilogramë kokainë nga Ekuadori.<sup>53</sup> Duhet të përmendim faktin se rreth 50 kontenierë me banane hyjnë në Tivar çdo javë, dhe më pas shpërndahen në Kosovë, Serbi, dhe Bosnjë Hercegovinë.<sup>54</sup> Mendohet se grupet që ushtrojnë aktivitetin në Tivar janë kriminelë nga Mali i Zi që punojnë me bashkëpunëtorët e tyre nga Serbia dhe Kroacia, dhe se këto grupe kryejnë aktivitete kriminale në nivel ndërkombëtar.


Tivari është një zonë problematike që njihet mirë për kontrabandën e cigareve. Cigaret thuhet se hyjnë nga jashtë në Tivar për rieksporim, dhe po kështu cigaret e prodhuara në Malin e Zi dalin jashtë po nga porti i Tivarit. Në vitin 2018, më shumë se 43 milionë cigare u konfiskuan duke hyrë në portin e Tivarit. Është disi e paqartë sasia e cigareve të falsifikuara, apo 'cigaret e lira' (që mendohet se prodhohen në fabrikat e Podgoricës dhe Mojkovacit) që dalin nga Tivari. Sidoqoftë, një person që e njeht mirë mënyrën e funksionimit të portit i tha GI-së se eksporti i cigareve është kaq i madh dhe fitimprurës (dhe i lidhur me persona me influencë), saqë disa magazina në zonën e portit ruhen vetëm për cigaret kontrabandë, dhe ngarkim-shkarkimi i kontenierëve kryhet vetëm nga kompani private.<sup>55</sup>

Një aktivitet i këij niveli mund të jetë i mundur vetëm me bashkëpunimin e zyrtarëve të portit, doganave dhe policisë. Në gusht 2018, në portin e Tivarit u arrestuan 10 punonjës dogane për kontrabandë cigaresh. Edhe disa kompani që kryenin aktivitetin e tyre në zonën e lirë ekonomike në territorin e portit të Tivarit dyshoheshin për bashkëpunim në kontrabandë. Grupet kryesore të përfshira në kontrabandën e cigareve nga Tivari janë klanet Mojkovac dhe Grand, që thuhet se janë të lidhura ngushtë me zyrtarë të lartë të qeverisë dhe forcave të ruajtjes së rendit.

Cigaret që ngarkohen në Tivar kanë si destinacione kryesore Libinë, Egjiptin, Libanin dhe Qipron. Sipas një hetimi të kryer nga Zyra Evropiane Anti-mashttrim, anijet shpesh mbërrijnë në destinacionin e tyre të boshatisura, dhe ka shumë të ngjarë se cigaret devijohen drejt tregut të kontrabandës në vendet e BE-së. Cigaret ose shkarkohen ilegalisht në territorin e BE-së, ose transferohen në anijë të tjera në det të hapur, jashtë kontrollit të autoriteteve doganore apo rojave bregdetare, dhe më pas futen sërish kontrabandë në BE. Që nga viti 2015, tetë anije dhe ngarkesat e tyre me cigare – të ngarkuara në portin e Tivarit – janë bllokuar për kontrabandë në Greqi dhe Spanjë. Cigaret që transportoheshin në gjashtë nga këto anije kishin si destinacion Libinë, njëra ishte nisur për në Qipro, dhe tjetra për në Liban. Në total, rreth 350 milionë cigare u konfiskuan në këto anije, dhe që llogariten me një vlerë prej 70 milionë eurosh në tarifa doganore, akciza dhe TVSH.<sup>56</sup> Por kjo është vetëm maja e ajtbergut.

Llogaritet se 600 kontenierë me cigare dalin kontrabandë nga portin e Tivarit çdo vit. Secili prej këtyre kontenierëve mendohet se kushton një gjysëm milioni euro. Një llogari e thjeshtë tregon për një fitim prej 300 milionë eurosh në vit, plus miliona euro të tjera nga shitja e cigareve ilegalisht në Malin e Zi, si dhe nga trafikimi i cigareve me rrugë tokësore në vende të tjera të Evropës.

Bregdeti malazez duket se është joshës edhe për lloje të tjera krimi. Mendohet se lojtari i famshëm i pokerit nga Malajzia, si dhe pronari i disa kompanive bastesh në internet, Paul (Wei Seng) Phua, po i përdor investimet e tij dhe partnerëve të tjerë në Malin e Zi për të pastruar para.<sup>57</sup> Raportohet se Phua është anëtar i Triadave, një grupi të krimit të organizuar në Hong Kong.



## Vjedhje makinash në Sarajevë

E premte, 26 tetor 2018. Dypolicë u qëlluan me plumba në Sarajevë ndërsa po mundoheshin të kapnin një person që u gjet duke vjedhur një makinë. Një nga policët vdiq në vend, ndërsa tjetri vdiq disa orë më pas, si pasojë e plagëve të marra.

Ndonëse këto dy vrasje e tronditën qytetin, ky incident nuk ishte ndonjë gjë e re. Më 22 maj 2018, dy policë u plagosën pasi u qëlluan me armë nga hajdutë makinash në lagjen Novi Grad të qytetit të Sarajevës.

Në periudhën 2014 - 2017 ka patur nga 15 deri në 20 raste ku hajdutë makinash kanë qëlluar mbi policinë, janë munduar t'i shkelin me makinë, apo të godasin makinën e policisë ndërsa po mundoheshin t'i shpëtonin ndjekjes. Këto incidente kanë bërë që hajdutët e makinave të konsiderohen si kriminelët më të rrezikshëm në këtë qytet.

Në vitin 2017, në Sarajevë vidhej të paktën nga një makinë në ditë. Hajdutët po bëheshin gjithnjë e më të guximshëm, dhe madje vodhën edhe makina që i përkisnin policëve të Sarajevës, Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Sigurisë, si dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Të ardhurat nga vjedhja e makinave gjatë 15 viteve të fundit llogariten të jenë rreth 50 milionë euro, duke e bërë këtë aktivitet të paligjshëm një nga më trafiket më fitimprurëse në këtë vend.<sup>58</sup>

Thuhet se shumë nga hajdutët e makinave janë nga Republika Srpska, veçanërisht nga qytetet **Pale** (rreth 20 minuta larg Sarajevës), Zvornik, Mokro dhe Sokolac. Ata veprojnë zakonisht në grupe me nga tre veta, mbajnë maska të zeza dhe janë të armatosur. Zakonisht këta hajdutë janë të rinj të moshës 25 deri në 27 vjeç. Ata mësohen si të vjedhin nga krerët e grupeve kriminale, që i kanë hyrë vetë kësaj rruge 10 apo 15 vite më parë, dhe që tani merren me aktivitete të tjera – që zakonisht janë të paligjshme. Në fakt, duket se vjedhja e makinave është një mënyrë fitimprurëse për t'i hyrë aktivitetit kriminal. Disa nga grupet kriminale më me emër në rajon – si klani i Zemunit – e kanë nisur karrierën e tyre kriminale si hajdutë makinash.

Të njëjtat grupe akuzohen edhe për përfshirje në trafik droge, zhvatje dhe shantazh (duke përfshirë edhe raste që lidhen me vjedhjet e makinave), si dhe pastrim parash.<sup>59</sup> Në fakt, megjithëse fokusi i këtij kapitulli është vjedhja e makinave, në Sarajevë ka edhe lloje të tjera aktivitetesh kriminale. Sidoqoftë, situata duket të jetë përmirësuar disi, pas arrestimeve të dy krerëve të kimit (dhe grupeve rivale) Zijad Turković dhe Naser Kelmendi në vitin 2013.<sup>60</sup>

Makinat e vjedhura në Sarajevë nxirren zakonisht jashtë kufijve të qytetit. Në disa raste, makinat e vjedhura përdoren për kryerjen e krimeve të tjera dhe më pas shkatërrohen. Në raste të tjera, pronarët e makinave kontaktohen duke iu kërkuar që të paguajnë nëse duan që t'iu kthehen makinat e vjedhura. Pjesa tjetër e makinave shiten jashtë shtetit, apo çmontohen për pjesë që shiten në tregun e zi. Mbase kjo është edhe arsyeja përse ka aq shumë pika për riparimin e makinave përgjatë krahinave kufitare në Bosnjë Hercegovinë – shumë prej të cilave funksionojnë ilegalisht. Duket se një pjesë e mirë e fitimeve që vijnë nga vjedhja e makinave dhe zhvatja pastrohen duke u investuar në aktivitete komerciale që lidhen me makinat; si pika për riparime makinash, lavazhe, kompani taksish, dhe agjenci për makina me qera.

Duket se në Bosnjë, vjedhja e makinave paraqet rrezik të ulët dhe fitime të mëdha për kriminelët. Shumë pak nga këta hajdutë janë kapur nga policia. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e një sistemi administrativ të komplikuar, me nivele të ndryshme qeverisjeje. Jo vetëm që vendi është i ndarë në disa zona, por edhe vetë Sarajeva është e ndarë më dysh: një zonë ku shumica janë boshnjakë me rreth 275,000 banorë<sup>61</sup> është pjesë e Federatës së Bosnjë Hercegovinës, ndërsa Sarajeva lindore<sup>62</sup> me popullsi prej 60,000 banorësh, kryesisht serbë, është pjesë e Republika Srpska.

Ndërkohë që kriminelët lëvizin pa problem nëpër këtë ndarje territoriale mbi linja etnike, midis Republika Srpska dhe Federatës së Bosnjë Hercegovinës, sistemi i drejtësisë pengohet nga shkëmbimi i ngadaltë i informacionit, juridiksioneve të ndryshme, si dhe numrit të vogël të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta policore, si pasojë e sistemit kompleks administrativ të vendit. Për shembull, secili nga 10 kantonet, dhe secila nga tre ndarjet administrative të vendit (Federata e Bosnjë Hercegovinës, Republika Srpska, dhe Brčko) kanë policitë e tyre. Mungesa e bashkëpunimit midis këtyre forcave policore është e natyrës sistematike.



Për shembull, disa oficerë policie në Sarajevë iu ankuan autorëve të këtij raporti se kolegët e tyre në Sarajevën lindore, apo zona të tjera në Republika Srpska, nuk po bëjnë aq sa duhet për të kapur hajdutët e makinave – megjithëse personat e dyshuar për vjedhje, duket se nuk kanë fare turp që të dalin vërdallë me makina të shtrenjta.<sup>63</sup>

Edhe ata pak hajdutë makinash që dalin para gjykatës dhe dënohen, sapo dalin nga burgu i rikthehen të njëjtave krime që kryenin më parë. Vetë fakti që të njëjtët emra dalin herë pas here si persona të dyshuar për vjedhje makinash (si dhe krime të tjera) tregon se kemi të bëjmë me nivele të larta recidivizmi.

Sidoqoftë ka disa shenja se situata mund të ndryshojë për mirë. Në fillim të nëntorit 2018, autoritetet boshnjake nisën një operacion të madh të quajtur Volan (Timoni) kundër hajdutëve të makinave, dhe 27 persona u ngarkuan me akuza. Pritet që kjo çështje të zgjasë me vite. Po kështu, kohët e fundit ka patur disa operacione të suksesshme anti-drogë në Sarajevë. Në tetor 2018, u kap një ngarkesë me 900 kilogramë kanabis. Nga ana tjetër, duket se ka goxha drogë vërdallë. Burime policore thanë për GI se ka një kërkesë në rritje për kokainë dhe droga sintetike në kryeqytetin boshnjak, por çmimet nuk po rriten. Kjo tregon se ka mjaft konkurrencë për tregun e drogës.<sup>64</sup>

## Kryqëzimet e rrugëve kryesore dhe kryeqytetet


*Për krimin e organizuar, ashtu si në rastin e pasurive të paluajjtëshme, vendndodhja është gjëja më e rëndësishme. Përveç zonave kufitare, edhe kryqëzimet e rrugëve kryesore janë pika ku përqendrohen aktivitetet kriminale. Këtu përfshihen qytetet e mëdha (shpeshherë kryeqytetet), zonat ku takohen autostradat, apo nyje të tjera transporti përgjatë korridoreve të trafikimit (shiko Hartën 3). Lista e vendeve të renditura në këtë kapitull nis nga veriu e poshtë.*

**Novi Sad** (me rreth 322,000 banorë<sup>65</sup>) është qyteti i dytë në Serbi, dhe kryeqyteti i krahinës autonome të Vojvodinës. Ndodhet në kryqëzimin e korridoreve të rëndësishme të transportit ndërkombëtar që e lidhin me Evropën qendrore dhe perëndimore, Rumaninë dhe Bullgarinë në lindje, si dhe Beogradin në jug. Ka një port të madh në lumin e Danubit. Për më tepër, Novi Sad ka një zonë të lirë doganore, që bën të mundur zhvillimin e aktiviteteve prodhuese dhe shërbimeve pa taksa dhe tarifa doganore.

Këto karakteristika e bëjnë Novi Sadin një vend të përshtatshëm për trafiqe të ndryshme – veçanërisht trafik droge dhe makinash të vjedhura, që lëvizin nga jugu në veri, por edhe armë e emigrantë. Thuhet se Darko Shariç (nga Pljevlja) e zhvillonte trafikun ndërkombëtar të kokainës nga Novi Sadi.<sup>66</sup> Që nga viti 2012, në këtë qytet ka patur tetë vrasje për motive mafioze, disa raste të tjera të tentativave për vrasje, si dhe incidente të tjera të dhunshme (në shumë prej tyre janë përfshirë qytetarë malazezë). Shumë pak nga këto rate janë zbardhur nga ana e policisë. Vrasjet duket të ketë qenë më shumë larje hesapesh midis grupeve të ndryshme kriminale që mundohen të vënë nën kontroll tregun e drogës në këtë qytet – veçanërisht që nga vdekja, në qershor 2013, e biznesmenit të dyshimtë malazez, dhe presidentit të klubit të futbollit Vojvodina,<sup>67</sup> Ratko Butoroviç (që njihej edhe me nofken Bata Kan Kan). Ai konsiderohej si bos i madh i kimit të organizuar në këtë zonë.

Një zyrtar i lartë policie iu referua këtyre vrasjeve si “seleksionim natyror,” por disa përfaqësues të shoqërisë civile i shprehën shqetësimin e tyre GI-së në lidhje me sulmet gjithnjë e më të guximshme nga ana e krimit, dhe mungesën e reagimit nga ana e shtetit.<sup>68</sup> Fitimet nga aktivitetet kriminale po pastrohen në aktivitete në qytetin e Novi Sadit, që po kalon një periudhë bumi në sektorin e ndërtimit, ndërsa çmimet e pasurive të paluajjtëshme po rriten. Po kështu, edhe kompani të mëdha po blejnë tokë në Vojvodinë.

**Banja Luka** është qyteti i dytë nga madhësia në Bosnjë Hercegovinë, dhe qyteti më i madh në Republika Srpska. Më parë ka qenë një komunitet multi-etnik, por që nga lufta në Bosnjë, shumica e 185,000<sup>69</sup> banorëve të këtij qyteti historik janë serbë. Kjo krahinë thuhet se është një burim trafikimi armësh dhe eksplozivësh (trashëgimi e luftës), që shiten në mënyrë të paligjshme në vendet e Bashkimit Evropian (veçanërisht tek grupet kriminale në Suedi), dhe që janë përdorur edhe në sulme terroriste në Evropën perëndimore.<sup>70</sup>



Harta 3: Nyjet kryesore të trafikut



Trafikimi i drogës është gjithashtu shumë i përhapur në këtë rajon. Kjo lidhet edhe me përhapjen e policisë vendore në aktivitete të paligjshme. Për shembull, në vitin 2013, katër inspektorë policie nga sektori i anti-drogës u arrestuan për trafikim droge. Burime të ndryshme thanë për GI-në se gjatë këtyre viteve të fundit është rritur sasa e kokainës që qarkullon nëpër klubet e natës në Banja Luka (ashtu si dhe në Sarajevë), ndërkohë që çmimet po bien.<sup>71</sup> Një nga teoritë është se trafikantët e narkotikëve po paguhen me këmbim droge. Fitimet nga aktivitetet kriminale po pastrohen në këtë qytet duke blerë pasuri të paluajteshme, makina luksoze, si dhe aktivitete të ligjshme që bëjnë shumë xhiro me para në dorë (agjenci të makinave me qera, kafene, bare, restorante, dhe klube nate).

**Tuzla**, me një popullsi prej 110,000<sup>72</sup> banorësh, është qyteti i tretë në Bosnjë Hercegovinë. Tuzla konsiderohet si kryeqendra ekonomike, kulturore, arsimore, mjekësore, dhe turistike e verilindjes së Bosnjës. Qyteti ndodhet pranë një korridorit të përdorur dendur për trafikimin e drogave, duke përfshirë heroinën dhe kanabisin. Ka patur edhe njoftime për kapje të drogave sintetike. Mendohet se drogat sintetike vijnë nga Holanda, dhe përdoren si pagesë për kalimin e drogave nëpër krahinën e Tuzlës, përgjatë korridorit ballkanik, drejt vendeve të BE-së. Ashtu si dhe në krahinat e tjera të Bosnjës – si Banja Luka dhe Sarajeva – të intervistuarit i thanë GI-së se në këto vitet e fundit ka patur një rritje të sasisë së heroinës dhe kokainës në treg.<sup>73</sup>

Po kështu, ka edhe raportime mbi kontrabandën e cigareve dhe tekstileve. Ashtu si Sarajeva, edhe në Tuzla, vjedhja e makinave është shumë e përhapur (vidhen rreth 100 makina në vit). Kjo shpjegohet pjesërisht nga afërsia gjeografike me Republika Srpska dhe distriktin Brčko: brenda një rrezeje prej 20 kilometrash, ka tre forca policie që funksionojnë vetëm brenda zonës së tyre të juridiksionit. Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit midis policive të ndryshme e bën relativisht të lehtë vjedhjen e makinave dhe kalimin e tyre në zona të tjera (për shembull, në krahinën e Zvornikut në territorin e Republika Srpska). Mendohet se ka lidhje midis hajdutëve të makinave që veprojnë në krahinat e Sarajevës dhe Tuzlës (si grupi Sokolac), si dhe me rrjete kriminale në Serbi.<sup>74</sup>

Kryeqyteti serb **Beogradi** (me popullsi 1.7 milionë banorë<sup>75</sup>) po përjeton një rritje të aktivitetit të grupeve kriminale. Që nga viti 2012, ka patur 145 vrasje në Serbi dhe Malin e Zi, që konsiderohen si "heqje qafe të stilit mafioz". Të paktën 52 nga këto vrasje kanë ndodhur në Beograd,<sup>76</sup> dhe shumë pak prej tyre janë zbardhur nga policia.<sup>77</sup> Në korrik 2018, një avokat që dihej mirë se mbronte kriminelët në gjyq, u vra përballë shtëpisë së tij. Po kështu ka vite që zjen konflikti midis klaneve Bojoviç dhe Saranoviç. Krimi i organizuar në Beograd është i lidhur edhe me huliganët e futbollit, politikanët, dhe të ashtuquajturit "biznesmenë të dyshimtë".

Qyteti **Nish** (me popullsi rreth 260,000 banorë<sup>78</sup>) ndodhet në kryqëzimin e autostradave kryesore që lidhin pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut me Beogradin (nëpërmjet Kosovës apo Serbisë jugore), si dhe rrugëve në aksin lindje-perëndim, që të çojnë deri në Bullgari dhe Turqi. Po kështu është edhe një nyje e rëndësishme hekurudhore, dhe ka një aeroport. Vendndodhja e këtij qyteti e bën një pikë të rëndësishme për aktivitetet e paligjshme. Aktivitetet kriminale në Nish duket se janë shtuar pas vitit 2010, pasi në atë periudhë qyteti nuk kishte shef policie për tre vite me radhë. Thuhet se në këtë qytet ka gjashtë grupe kriminale kryesore, që merren më shumë me trafikimin e drogave, dhe kontrabandën e cigareve.<sup>79</sup> Në vitin 2017, iu vu flaka të makinave, ndërsa tre prej tyre ishin pronë e zyrtarëve të lartë të policisë. Edhe makina e zëvendës-kryetarit të bashkisë u shkatërrua.

**Novi Pazar** (popullsia 105,000<sup>80</sup>) gjendet në skajin jugperëndimor të Serbisë, pranë kufirit me Malin e Zi, dhe është qendra historike e krahinës së Sanxhakut. Kjo zonë ka një përqindje të madhe të popullsisë myslimane (82%), shumica boshnjake. Sanxhaku është një nga krahinat më të varfra të Serbisë, dhe ka një nga ritmet më të larta të shtimit të popullsisë. Moshë mesatare është 31 vjeç, dhe gati gjysma e popullsisë (45%) është nën 29 vjeç.<sup>81</sup> Kjo e bën Sanxhakun një nga krahinat me moshë më të re në Evropë. Atyre që u jepet mundësia për t'u larguar, zgjedhin emigracionin. Gjatë tre viteve të fundit, gati 10% e popullsisë mendohet se ka emigruar në Gjermani. Kjo krahinë vuan nga një nivel papunësie prej 26%.<sup>82</sup> Madje edhe ata që e kanë një punë, nuk janë edhe aq mirë ekonomikisht: rroga mesatare neto në Novi Pazar është 305 euro,<sup>83</sup> një shifër që është 50% më e ulët se rroga mesatare në vend.<sup>84</sup>

Ekonomia vendase duket se varet shumë nga paratë që sjellin emigrantët, ose nga veprimtaritë kriminale. Novi Pazar ndodhet pranë rrugëve që marrin për në veri, nga Mali i Zi dhe veriu i Kosovës. Si rezultat, kjo zonë është një nyje e rëndësishme, si për trafikimin, ashtu edhe për ripaketimin e heroinës që vjen nga Turqia dhe Bullgaria nëpër Kosovë; si dhe kanabisin që vjen nga Shqipëria dhe Kosova drejt Beogradit, dhe më tej drejt veriut për në





vendet e BE-së. Po kështu, mendohet se një pjesë e kokainës që vjen nga Amerika e Jugut nëpërmjet Adriatikut (nga portet e Shqipërisë dhe Malit të Zi) kalon nëpër këtë krahinë. Kjo zonë njihet gjithashtu si pikë për kontrabandën e karburanteve dhe cigareve. Me gjithë këto droga që kalojnë nëpër qytet, një nga personat e intervistuar e quajti Novi Pazarin "Kolumbia e vogël."

Një nga kontrabandistët kryesorë që kontrollonte këtë korridor ishte Naser Kelmendi – një nga kriminelët më famëkeqë në rajon. Kelmendi ka lindur në Kosovë, por kishte nënshtetësi boshnjake dhe malazeze, dhe ishte në kontakt me një rrjet bashkëpunëtorësh në rajonin e Ballkanit. Ai u arrestua në vitin 2017 dhe u dënua më gjashtë vjet burg. Një tjetër trafikant famëkeq nga ky qytet ishte Hikmet Hajroviç, që u arrestua në vitin 2011.

Ndonëse Hajroviç dhe shumica e pjesëtarëve të grupit të tij ishin boshnjakë, klientët e tyre ishin më së shumti serbë. "Grupet kriminale nuk njohin dasi fetare dhe etnike kur vjen puna tek aktiviteti i tyre në këtë zonë," thë një burim nga kjo zonë.<sup>85</sup> Në fakt, sipas një studiuesi grupet kriminale në Novi Pazar janë një pikë lidhëse me rëndësi midis Beogradit dhe Prishtinës. "Mëgjithë tensionet politike ndërmjet Serbisë dhe Kosovë, bashkëpunimi midis kriminelëve që merren me kontrabandë nuk është vënë asnjëherë në rrezik. Krejt e kundërta, biznesi i tyre shkon përherë e më mirë."

**Nikshiç** është një qytet industrial në veriperëndim të Malit të Zi. Është qyteti i dytë në vend, me një popullsi prej 72,000 banorësh.<sup>86</sup> Nikshiç është vendlindja e presidentit malazez, si dhe e biznesmenit të dyshimtë Branislav Miçunoviç. Ndodhet në rrugën midis Podgoricës dhe Trebinjes (në Bosnjë), si dhe në korridorin midis Serbisë dhe Detit Adriatik (veçanërisht pranë Dubrovnikut dhe porteve malazeze të Kotorit dhe Budvës). Kjo e bën Nikshiç një pikë të rëndësishme për trafikimin e drogave dhe cigareve. Nikshiç njihet historikisht si zonë problematike përse i përket kontrabandës. Gjatë luftës në Bosnjë, kur duhani, karburanti, armët, ilaçet, dhe mallra të tjera gjendeshin me vështirësi, këto materiale futeshin kontrabandë në Bosnjë me miratimin e zyrtarëve shtetërorë në Serbi dhe Mal të Zi.

Gjatë viteve të fundit, ky qytet ka vuajtur nga një konflikt i përgjakshëm midis dy familjeve të lidhura me aktivitete kriminale: Ranko Raduloviç dhe familja Vilotijeviç. Raduloviç u arrestua në vitin 2018 për aktivitete kriminale, pasi kishte hartuar edhe një liste me persona që duheshin vrarë, si vëllezërit Vilotijeviç, Dusko Roganoviçin (që u përmend në lidhje me incidentin e vrasjes në Vjenë), si dhe një prokuror të krimeve të rënda. Mendohet se ka lidhje midis grupeve kriminale në Nikshiç dhe klaneve në veprojë në bregdetin malazez. Po kështu, Nikshiç thuhet se është qendra e veprimtarive të klanit Kvartashki (Kvartaški - Kuarc), që sipas mediave, ka vite që është i përfshirë në trafikun e kokainës dhe kanabisit. Disa anëtarë të këtij grupi duket se veprojnë edhe jashtë shtetit, veçanërisht në Spanjë. Një pjesë e fitimeve nga aktivitetet kriminale të këtyre grupeve mendohet se pastrohen nga biznese në qytetin Nikshiç, duke përfshirë lojrat e fatit, baste sportive, firma ndërtimi, si dhe investime në pasuri të paluajtshme në bregdetin Adriatik (veçanërisht në Budva).

**Prishtina**, kryeqyteti i Kosovës (me popullsi prej 200,000 banorësh<sup>87</sup>), konsiderohet një zonë aktive përse i përket aktivitetit kriminal. Grupet kryesore kriminale në këtë qytet zakonisht përbëhen nga ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Një nga aktivitetet kryesore të grupeve kriminale të organizuara në Prishtinë është edhe trafikimi i drogës. Për shembull, në dhjetor 2018, Enis dhe Selim Querka u arrestuan pasi dyshohej se kishin trafikuar 113 kiligramë heroinë nga një pikë e kalimit të kufirit midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.<sup>88</sup> Në një rast tjetër, djali i ish-presidentit Ibrahim Rugova u arrestua për falsifikim të vizave italiane Shengen. Janë hedhur edhe akuza se grupe të ndryshme kanë falsifikuar dokumente për të përfituar në mënyrë të paligjshme nga tokat në pronësi të shtetit.<sup>89</sup> Po kështu, në fshatrat pranë Prishtinës ushtrojnë aktivitetin e tyre disa grupe që merren me dhënien e huave me interesa shumë të larta. Kohët e fundit, ka patur edhe një sërë grabitjesh banke në Prishtinë, dhe zona të tjera të Kosovës.

Qyteti i **Pejës**, në perëndim të Kosovës (me popullsi rreth 96,000 banorë<sup>90</sup>), ndodhet në kryqëzimin e disa korridoreve trafikimi. Kjo është një zonë malore pranë kufirit malazez dhe pranë rrugës që të çon në Prishtinë, jo shumë larg nga veriu i Shqipërisë, Mitrovicës dhe Novi Pazarit. Kjo krahinë ka probleme me nivele të larta papunësie. Në të kaluarën janë shënuar një numër i madh vrasjesh të pazgjidhura në Pejë, që mendohej se kanë ardhur si rezultat i konflikteve midis dy grupeve rivale të formuara nga ish-pjesëtarë të UÇK-së. Këto përplasje kishin motive kriminale (në lidhje me kontrollin e korridoreve të trafikimit në rajon) si dhe politike, pasi disa nga ish-komandantët e UÇK-së tani janë politikanë dhe zyrtarë të lartë të Kosovës. Thuhet se në këtë zonë ushtrojnë ndikimin e tyre disa figura politike



me peshë. Ndonëse numri i vrasjeve ka rënë, thuhet se niveli i aktiviteteve kriminale në këtë zonë problematike vazhdon të jetë i lartë, veçanërisht në trafikimin e drogave, cigareve, si dhe armëve. Korridori deri tek pika e kalimit kufitar Kulla / Kula, si dhe zona rreth fshatit Çakor (shiko kapitullin mbi nyjet kufitare) janë veçanërisht të frekuentuara nga trafikantët.

**Ferizaj** është qyteti i tretë për nga madhësia në Kosovë, më një popullsi me rreth 108,000 banorë.<sup>91</sup> Ndodhet në juglindje të vendit, pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut, përgjatë rrugës që lidh Prishtinën me Shkupin. Konsiderohet si zonë problematike për trafikimin e drogës, veçanërisht kanabis dhe heroinë, dhe ka goxha diasporë në Zvicër. Në maj 2017, policia konfiskoi mbi 800 kilogramë kanabis nga Shqipëria në një fshat pranë Ferizajt. Grupet kriminale që operojnë në këtë qytet thuhet se janë të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore (për prostitucion), dhënie huash me interesa shumë të larta, si dhe zhatje dhe shantazhe në lidhje me pronësinë e tokave.


Kryeqyteti malazez, **Podgorica** (me popullsi prej 185,000 banorësh<sup>92</sup>), është zona ku kryejnë aktivitetin e tyre disa grupe të rrezikshme kriminale. Një nga këto grupe, që drejtohet nga Vaso Uliç, merret me trafikimin e heroinës, kokainës, metamfetaminës dhe kanabisit – veçanërisht për në Australi. Një grup tjetër, që drejtohet nga vëllezërit Lambuliç (Vjekoslav dhe Jugoslav), thuhet se merren me lojëra ilegale të fatit, pastrim parash dhe trafikimin e drogës. Grupi i tretë kriminal njihet si klani Zagorički (që e merr emrin nga një lagje e kryeqytetit). Grupe të tjera kriminale dyshohen se janë të përfshira në trafikimin e drogës në Kroaci, si dhe me kalimin kontrabandë të makinave të vjedhura që vijnë nga Podgorica dhe Shqipëria, por edhe dërgojnë makina të vjedhura në drejtim të kundërt.<sup>93</sup>

Thuhet se ka lidhje të ngushta midis grupeve që zhvillojnë aktivitetet e tyre në Podgoricë, me grupet nga Nikshiç, Rozhaje dhe Bar (që u përmendën më lart). Edhe Darko Shariç – nga Pljevlja (Mali i Zi) – kishte një rrjet të gjerë kontaktesh në Podgoricë.

Gjatë viteve të fundit, konflikti midis bandave të Kotorit – midis klaneve Kavaç dhe Shkaljari – ka prekur edhe kryeqytetin malazez, dhe me sa duket një pjesë e parave nga aktivitetet kriminale është pastruar në Podgoricë. Dyshohet se disa nga grupet që zhvillojnë aktivitetin kriminal në Podgoricë kanë lidhje me forcat e ruajtjes së rendit, si dhe me biznesmenët të fuqishëm dhe politikanë. Një formë e re krimi në Podgoricë është edhe pastrimi i parave (në disa raste) nëpërmjet basteve sportive të palicensuara në internet.

**Shkupi**, kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, (popullsia rreth 500,000 banorë<sup>94</sup>) ndodhet në kryqëzimin e korridoreve të trafikimit nga lindja në perëndim, dhe veri-jug. Megjithëse pjesa më e madhe e banorëve të këtij qyteti janë maqedonas etnikë, thuhet se grupet kriminale kryesore në Shkup janë shqiptare. Aktivitetet kryesore të krimit të organizuar përfshijnë trafikimin e drogës, vjedhjet e makinave, trafikimin e emigrantëve, si dhe biznese legjitime - që përdoren për të kryer transportimin e mallrave për trafikim, si dhe krijojnë mundësi për pastrimin e parave të pista. Tre grupet kryesore kriminale që veprojnë në këtë krahinë (nga fshatrat Araçinovo, Kondovo dhe Gërçec) duket se gëzojnë edhe mbështetje politike.<sup>95</sup>

**Velesh**, në qendër të Maqedonisë së Veriut, është një nyje ku kryqëzohen korridoret e trafikut të drogës në Ballkan. Ndodhet përgjatë një korridori të rëndësishëm transporti veri-jug, nga Greqia në Shkup dhe Prishtinë, si dhe autostradës që të çon në Bullgari – me fjalë të tjera, Veleshi ndodhet në kryqëzimin e dy korridoreve evropiane: korridori 8 dhe korridori 10. Ky qytet me 54,000 banorë<sup>96</sup> shihet si qendër e shkëmbimit të heroinës për kanabis midis grupeve kriminale nga Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Greqia. Ajo që tërheq vëmendjen është fakti se sasia e drogës e konfiskuar në këtë zonë është shumë e vogël, dhe po kaq i ulët është edhe niveli zyrtar i akteve kriminale. Kjo tregon se ka bashkëpunim, apo tolerancë ndaj krimit, nga ana e policisë dhe politikës. Krahina e Vardarit, ku ndodhet Veleshi, është një nga zonat më pak të banuara në Maqedoninë e Veriut. Veleshi ishte dikur një qytet industrial, kishte një kombinat metalurgjik, uzinë porcelani, dhe industri tekstile, por në periudhën post-komuniste ky qytet ra në një gjendje të keqe ekonomike. Niveli i papunësisë është më shumë 30 për qind më i lartë se mesatarja kombëtare,<sup>97</sup> dhe po kështu kjo zonë vuan nga një numër i madh vetëvrasjesh dhe depresioni. Kjo situatë shpjegon arsyen përse në vitet '90 Veleshi u bë vendlindja e të ashtuquajturit grupi mafioz i Frankfurtit – një nga rrjetet më të mëdha të trafikimit të drogës në Gjermani, që ishte aktiv edhe në tregun e heroinës në Vjenë. Llogaritet se në kulmin e vet qindra të rinj nga Veleshi (që shpesh përdornin pasaporta bullgare) shpërndanin drogë në rrugët e Austrisë dhe Gjermanisë për llogari të grupit. Një pjesë e fitimeve nga këto aktivitete të paligjshme duket



se janë pastruar në qytet duke u investuar në disko, kafene, restorante, turizëm, hotele, dhe pika bastesh sportive. Grupi i Frankfurtit u shkatërrua si rezultat i një sërë operacionesh të përbashkëta midis forcave policore në Austri, Gjermani dhe Maqedoninë e Veriut.<sup>98</sup>

**Shtip** është një qytet më rreth 48,000 banorë<sup>99</sup> në pjesën lindore të Maqedonisë së Veriut, përgjatë një koridori transporti që kalon nga Veleshi në Koçani, dhe deri në Bullgari. Ashtu si Veleshi, kjo krahinë është në gjendje të keqe ekonomike, me nivele të larta papunësie,<sup>100</sup> depresioni, vetëvrasjesh, dhe largimi në emigracion. Shtipi ndodhet pranë një koridori ku zhvillohen aktivitete kriminale të shumëllojshme, shumica e të cilave kontrollohen nga maqedonas etnikë. Thuhet se aktivitetet e paligjshme përfshijnë trafikimin e drogës, kontrabandën e cigareve, si dhe vendosjen e gjobave dhe zvatjen e bizneseve duke përdorur kompanitë e policive private të angazhuara “në mbrojtjen e klientëve.”

**Koçani** (me 37,000 banorë<sup>101</sup>) është një qytezë në pjesën lindore të Maqedonisë së Veriut, pranë kufirit me Bullgarinë. Ashtu si Veleshi dhe Shtipi, Koçani vuan nga nivele të larta emigracioni (veçanërisht drejt Italisë dhe Gjermanisë) dhe papunësie, por përfiton nga pozicioni gjeografik që ka, pranë një prej koridoreve kryesore të heroinës. Thuhet gjithashtu se Koçani është një zonë problematike për kontrabandën e cigareve dhe kanabisit. Mendohet se grupe kriminale nga Koçani janë të lidhura ngushtë me disa grupe kriminale bullgare. Raportohet se disa vite më parë grupet kriminale në këtë zonë ushtronin veprimtaritë e tyre pa asnjë lloj pengese, aq sa krerët e krimit kishin krijuar një ‘agjenci sigurimi’ që vendoste një ‘tarifë sigurimi’ për të gjitha dyqanet në qytet, që shkonte nga 30 deri në 50 euro në muaj. Atyre që refuzonin të paguanin u digjeshin makinat apo u shkatërrroheshin dyqanet.<sup>102</sup> Problemet nga ky aktivitet kriminal u reduktuan falë një operacioni të madh policor me emrin Detonator, në prill 2012.

**Kurbini** dhe **Lezha** janë zona problematike të krimit të organizuar në Shqipëri (e gjithë prefektura ka rreth 125,000 banorë<sup>103</sup>). Zona e Kurbinit (që shtrihet në një sipërfaqe 235 kilometra katrorë) ndodhet përgjatë autostradës që lidh Tiranën me Lezhën, dhe një nga fshatrat e kësaj zone, Fushëkuqe, ndodhet në bregdetin e Adriatikut. Kjo e bën këtë krahinë një vend ideal për trafikimin e drogës drejt Italisë. Kurbini është një krahinë shumë e varfër. Disa nga grupet kriminale nga kjo zonë – që zakonisht përbëhen nga persona që kanë lidhje fafeshnore me njëri-tjetrin – janë të përfshira në trafikimin e drogës, ndërsa disa të tjera kanë nam të keq për vjedhje, grabitje dhe pastrim parash (veçanërisht në fushën e pasurive të paluajtëshme). Thuhet gjithashtu se në këtë zonë ka edhe kultivim kanabisi.

Në vitin 2014, në Fushëkuqe u zbulua një laborator droge. Gjatë këtij operacioni, policia konfiskoi 7 kilogramë kokainë, 18 kilogramë heroinë, dhe 100 kilogramë kanabis, si dhe një numër armësh zjarri. Grupi kriminal që kishte laboratorin me sa duket vazhdon akoma aktivitetin, dhe ka lidhje me grupe kriminale në Kosovë. Një nga qytetet më problematike në krahinën e Kurbinit është **Laçi**. Kriminelë nga ky qytet kanë marrë namin si persona të egër dhe të dhunshëm, dhe duket se grupet e tjera të krimit në Shqipëri nuk u zënë besë kriminelëve nga Laçi.

Zona e Lezhës (pak më në veri) ka dalje në Adriatik, duke përfshirë edhe portin e Shëngjinit. Grupet kriminale nga Lezha kanë qenë aktive në trafikimin e qenieve njerëzore, trafikimin e drogës dhe shitjen e armëve. Disa prej tyre janë aktive edhe jashtë vendit, veçanërisht në Itali dhe Hollandë. Thuhet gjithashtu se këto grupe i pastrojnë paratë në këtë zonë, veçanërisht me investime në pasuri të paluajtëshme, turizëm, bare, restorante dhe pika karburanti. Kjo zonë njihet gjithashtu edhe për familje të përfshira në aktivitete kriminale dhe të lidhura ngushtë me politikën. Kështu, thuhet se disa deputetë nga kjo zonë janë të implikuar me krimin e organizuar, dhe madje njëri prej tyre u përjashtua nga Kuvendi për këtë arsye. Në mars 2018, kryetari i bashkisë së Lezhës dhe 11 zyrtarë të tjerë u arrestuan me akuzën e shitjes së paligjshme të tokave në bregdet, me qëllim përfitimin e shumave të mëdha në para.

**Tirana** është një nga kryeqytetet më dinamike në Ballkan. Popullsia e Tiranës (rreth 895,000 banorë në vitin 2018<sup>104</sup>) është katërfishuar gjatë 20 viteve të fundit, ndërkohë që moshë mesatare e popullatës është mjaft e re, 27 vjeç.<sup>105</sup> Në të kaluarën, kryeqyteti ka qenë qendra e veprimtarisë së disa prej grupeve kriminale më të rrezikshme në Shqipëri. Kërcënimi që vjen nga këto grupe ka rënë disi, por megjithatë ka akoma disa grupe kriminale që vazhdojnë të jenë aktive në këtë qytet. Ato funksionojnë më shumë si mbështetje për aktivitete kriminale jashtë vendit, kryesisht në Hollandë, Belgjikë, Spanjë, Zvicër, Gjermani, Itali, Kosovë, dhe në Mbretërinë e Bashkuar, por kanë edhe lidhje në Turqi dhe Amerikë latine. Aktivitetet kryesore të këtyre grupeve janë trafikimi i drogës, shantazhi, lojëra fati të palicësuara, pastrim parash, gjopa biznesi, dhe vrasje me pagesë. Tirana gjithashtu konsiderohet si një pikë takimi dhe kontakti,



ku grupet kriminale nga zona të tjera të vendit takohen për të krijuar lidhje me njëri – tjetrin, apo me zyrtarë nga qeveria dhe forcat e ruajtjes së rendit. Marrëdhëniet midis grupeve kriminale nuk kanë qenë gjithmonë miqësore. Gjatë viteve të fundit, janë regjistruar një numër atentatesh, kërcënime për bomba dhe shpërthime eksplozivi që lidhen me konflikte të grupeve kriminale. Kohët e fundit, ka patur edhe një sërë grabitjesh të bujshme, duke përfshirë edhe grabitjen e një sasive parash që do të transportohej në Vjenë nga aeroporti i Rinasit.<sup>106</sup>

**Elbasani** (prefektura ka një popullsi me rreth 274,000 banorë, sipas të dhënave të vitit 2018<sup>107</sup>) ndodhet në qendër të Shqipërisë, në kryqëzimin e korridoreve të trafikimit veri-jug dhe lindje-perëndim (nga portet e Durrësit dhe Vlorës për në Ohër). Grupet kriminale në Elbasan janë përfshirë në trafikun e kanabisit, heroinës, dhe kohët e fundit edhe me trafikun e kokainës. Në vitin 2015, në një fshat të bashkisë Elbasan u zbulua një laborator droge që përdorej për përpunimin e kokainës.<sup>108</sup> Policia sekuestroi 115 kilogramë kokainë, 359,000 euro, armë, si dhe u arrestuan 11 persona – përfshi edhe dy kolumbianë. Thuhet se qyteti është baza e dy prej grupeve kriminale më të fuqishme në Shqipëri, dhe që të dyja bandat janë të përfshira në trafikun e kokainës drejt Evropës perëndimore dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Qyteti jugor i **Fierit** (në vitin 2019 prefektura kishte 294,000 banorë<sup>109</sup>) ndodhet në krah të autostradës kryesore që lidh Shqipërinë e mesme me jugun e vendit. Thuhet se grupet kriminale nga kjo krahinë janë të lidhura ngushtë me rrjete kriminale jashtë shtetit (veçanërisht në Evropën perëndimore dhe Amerikën latine), si dhe me politikanë në Shqipëri. Për shembull, Arjan Shanaj nga Fieri u arrestua në Greqi në pranverën e vitit 2017, pasi u kap me kokainë që vinte nga një organizatë kriminale nga Kolumbia. Disa nga grupet kriminale karakterizohen edhe nga lidhje të forta familjare dhe shoqërore. Një burim që e njeh mirë zonën shpjegon: “Këto grupe janë shumë të dhunshëm, kanë një organizim të sofistikuar, dhe kanë lidhje të ngushta me politikën, dhe të gjithë këto faktorë bëjnë që organizatat kriminale në Fier të jenë të paprekshme.”<sup>110</sup> Aktivitetet kryesore të paligjshme të grupeve kriminale në këtë zonë përfshijnë trafikimin dhe përpunimin e drogës (thuhet se në këtë qytet ka disa laboratorë heroine), shantazh (duke përfshirë edhe foto apo video kompromentuese të politikanëve me prostituta apo duke marrë drogë), dhe pastrim parash (veçanërisht me pika karburanti, kazino, bare, restorante dhe hotele) në Fier dhe në bregdet. Zona e Fierit pritet që të përfitojë ekonomikisht nga përfundimi i gajzjellësit Trans Adriatik (nga Turqia në Itali). Një seksion i tubacionit të gazit natyror, një impiant kompresorësh, dhe një stacion matës do të ndërtohen pranë Fierit, dhe parashikohet se do të vihen në punë në vitin 2020.<sup>111</sup> Po kështu janë planifikuar edhe projekte zhvillimi të infrastrukturës.


## Trekëndëshi i krizave: Serbia e jugut, Kosova dhe Maqedonia e Veriut

Trekëndëshi i rajonit ku takohen Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia – që banohet kryesisht nga shqiptarë etnikë – vuan nga prapambetja ekonomike, paqëndrueshmëria, kufij porozë, dhe qeverisje të dobët, duke e bërë pre të lehtë për krimin e organizuar.

Qytetet kryesore të këtij rajoni janë Kumanova dhe Tetova, që llogaritet të kenë respektivisht popullsi prej 109,000<sup>112</sup> dhe 92,000 banorësh,<sup>113</sup> (shiko Hartën 4.) Kumanova ndodhet në kryqëzimin e autostradave nga Selaniku për në Beograd (apo verilindje të Kosovës), dhe nga Shkupi në Kyustendil (Bullgari). Aty pranë kalon edhe hekurudha që lidh Athinën me Vjenën. Rrugët nga Tetova (dhe fshatrat shqiptare në veri të Shkupit) të çojnë drejt veriut në Kosovë, duke kaluar nga Ferizaj për në Prishtinë.

Ky rajon ka në përgjithësi një terren malor, dhe për pasojë edhe kontrolli i kufijve – përveç pikave zyrtare të kalimit të kufirit – është goxha i vështirë.

Tetova, Kumanova dhe Lipkovo fqinje (me popullsi prej 30,000 banorësh<sup>114</sup>) kanë nivelin më të lartë të papunësisë në vend (58%)<sup>115</sup> dhe janë zona të varfra. Të rinjtë e kësaj zone mundohen të emigrojnë (veçanërisht që nga momenti kur BE liberalizoi vizat për Maqedoninë e Veriut në vitin 2010), ose rrezikojnë të bëhen pre e lehtë e rekrutimeve në grupe kriminale apo të armatosura. Si rezultat i kësaj, Lipkovo ka marrë nofkën ‘krahina e krizave.’




Gjatë periudhës së Jugosllavisë, nuk kishte kufij shtetërorë midis bashkësive të shqiptarëve etnikë që jetonin në Maqedoninë e Veriut, luginën e Preshevës në jug të Serbisë, dhe jugut të Kosovës. Megjithëse rajoni tani ndahet në tre shtete, familjet e kanë për zakon të kalojnë nga shteti në shtet për të takuar të afërmit e tyre. Këto lidhje farefisnore, dhe prirjet për të kaluar shpesh kufirin, nganjëherë e bëjnë më të lehtë përfshirjen në kontrabandë.

Thuhet se gjatë viteve 90 në këtë rajon ka patur aktivitet të dendur kontrabande (veçanërisht karburant) drejt Serbisë dhe Malit të Zi, gjatë periudhës së embargos. Në ditët e sotme, mallrat kryesore kontrabandë nëpër këtë rajon besohet se janë bagëti, mallra ushqimore, flori, cigare, dhe droga. Trafiku i drogës duket se përqendrohet kryesisht tek kanabisi nga Shqipëria, që kalon nëpër Kosovë apo Maqedoninë e Veriut, dhe më pas drejt luginës së Preshevës, për në Serbi, Bullgari dhe Greqi; heroinë nga Turqia nëpërmjet Bullgarisë; dhe kokainë nga Serbia.

Mendohet se në këtë zonë përpunohet dhe paketohet edhe heroina. Një nga destinacionet kryesore duket se është Zvicra. Për shembull, në dhjetor 2017, 110 kilogramë heroinë u konfiskuan në një autobus që nisej nga Lugina e Preshevës për në Zvicër. Në tetor 2018, policia shqiptare bastisi një laborator heroine në zonën malore të Hasit (pranë Kukësit), dhe gjeti morfinë dhe materiale për përpunimin e drogës, që vinin nga Turqia nëpërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

**Harta 4:** Trekëndëshi i krizave



Po kështu, ka të dhëna që sugjerojnë se në këtë rajon prodhohen edhe droga sintetike. Në dhjetor 2017, u zbulua një laborator i fshehtë në një fshat pranë Tetovës, dhe u konfiskuan 300 kilogramë pilula amfetamine – sasia më e madhe e drogave sintetike të kapura ndonjëherë në Evropën juglindore. Milan Zarubica – që u quajt nga ministria e punëve të brendshme të Serbisë si “prodhuesi më i madh i drogave sintetike” në rajon – u arrestua në Serbi, pas një operacioni të përbashkët me policinë e Maqedonisë së Veriut.

Ky rajon është gjithashtu një zonë problematike për trafikimin e qenieve njerëzore. Që nga viti 2014, kufiri verior i Maqedonisë së Veriut – veçanërisht fshatrat Vaksince dhe Lojane – janë kthyer në një korridor famëkeq për trafikimin e emigrantëve. Emigrantët tregojnë se janë shfrytëzuar dhe keqtrajtuar nga banorët vendas kur shkronin të luteshin për ushqim dhe strehim. Ka edhe pretendime se emigrantëve u janë shitur pasaporta të Maqedonisë së Veriut (megjithëse nuk është e qartë se kush ia ka shitur).<sup>116</sup>

Gjatë 20 viteve të fundit, ky rajon është bërë dëshmitar i një sërë konfliktesh serioze. Në vitin 1999, gjatë krizës në Kosovë, një numër i madh shqiptarësh të Kosovës kaluan si refugjatë në Maqedoninë e Veriut. Tensionet ndëretnike erdhën duke u shtuar, në një kohë kur shqiptarët bënë thirrje për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të pakicave etnike. Një krizë tjetër nisi edhe në krahun serb të kufirit, kur ish-luftëtarë të UÇK-së themluan Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit (UÇPMB), që bënte thirrje për shkëputjen nga Serbia të këtyre tre bashkive me popullsi shqiptare, dhe bashkimin e tyre me Kosovën.

Për rreth dy vjet pati edhe përplasje të armatosura sporadike, veçanërisht rreth zonës së Bujanovcit. Në vitin 2001, dhuna nisi edhe në Maqedoninë e Veriut, midis grupeve të armatosura shqiptare (që e quanin veten Ushtria Çlirimtare Kombëtare – NLA) dhe policisë e ushtrisë së Maqedonisë së Veriut. Përplasjet e para u regjistruan në zonën rreth Tetovës, në mars 2001. Në maj 2001, NLA nisi një ofensivë në fshatrat në veri të Kumanovës, por që u thye nga një operacion i madh i forcave ushtarake të Maqedonisë së Veriut. Konflikti përfundoi pas arritjes së një kompromisi politik me Marrëveshjen e Ohrit, në gusht 2001.

Në maj 2015, pati përsëri shpërthime dhune në Kumanovë, por kësaj here një grup me persona të armatosur nga Kosova luftuan për dy ditë me rradhë me policinë – duke lënë pas shumë të vrarë dhe të plagosur, si dhe një sërë pikëpyetjesh që kanë mbetur pa përgjigje. Tetë policë nga Maqedonia e Veriut dhe 14 persona të armatosur u vranë, ndërsa 37 policë u plagosën. Po kështu, u arrestuan 30 persona (shumica e tyre nga Kosova) dhe u akuzuan për terrorizëm nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut. Ndonëse disa e morën këtë incident si një shpërthim të ri të tensioneve ndëretnike, pati të tjerë që tërhoqën vëmendjen drejt fakteve se shumë pak nga personat e armatosur ishin nga ai rajon; se shumica kishin një të kaluar kriminale; se nuk pati viktima në mes të civilëve; dhe se forcat e ruajtjes së rendit mund të kenë patur dijeni mbi planifikimin e këtij sulmi (të paktën për fazën fillestare të incidentit).<sup>117</sup>


Si pasojë e këtyre incidenteve të dhunshme, rajoni i Kumanovës ka patur probleme në thithjen e investimeve, dhe thuhet se merr shumë pak mbështetje edhe nga shteti.

Kontrolli i kufirit në këtë rajon është i dobët, madje edhe pikat zyrtare të kalimit kufitar nuk janë të sigurta, si pasojë e zyrtarëve të korrumpuar që kanë lidhje me partitë politike (shiko më lart përshkrimin e pikës së kalimit kufitar Jazhinca/Gilboçicë). Një studiues i situatës në terren tha për GI se punonjësit e ndershëm në pikat kufitare kanë frikë se mund të ndëshkohen – madje edhe të hiqen nga puna – në vend që të shpërblehen për marrje iniciative në punën e tyre. Po kështu, thuhet se edhe bashkëpunimi midis forcave policore të këtyre tre shteteve është i dobët.<sup>118</sup>

Në ato zona ku kontrabandistët vlerësojnë se ka rrezik të zbulohen, ata thjesht kalojnë kufirin nga mali. Për shembull, disa burime thanë për GI se kontrabanda zhvillohet rëndom duke kaluar kufirin jeshil midis Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, pranë pikës së kalimit kufitar Tabanovce / Preshevë, që ndodhet pranë fshatit Lojane.<sup>119</sup>

Thuhet se në ditët e sotme ka një numër grupesh kriminale (rreth tetë grupe kryesore) që kryejnë aktivitet kriminal në rajonin e Tetovës. Këto grupe janë të ndërlidhura fort me komunitetet e zonës, dhe shumë nga pjesëtarët e tyre kanë hapur bare dhe restorante, dhe disa prej tyre kanë lidhje edhe me rrjete kriminale jashtë shtetit. Një nga këto grupe duket se ka lidhje të forta me një grup shqiptarësh të Maqedonisë së Veriut që ushtron aktivitetin në Sllovaki, që ka lidhje të ngushta me rrjete të tjera kriminale. Një nga krerët kryesorë të trafikut të drogës në Maqedoninë e Veriut, Bajrush Sejdiu, është nga Kumanova.

Po planifikohen të hapen dy pika të reja të kalimit kufitar në këtë rajon: njëra ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës (Belanovce – Stançiq) dhe tjetra ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (Lojane – Miratovac). Sidoqoftë, hapja e këtyre pikave të kalimit të kufirit është vonuar shumë. Një ekspert tha për GI: "Duket se transformimi i këtyre korridoreve në pika zyrtare të kalimit kufitar do të rrisë nivelin e kontrollit dhe sigurisë në këtë zonë, dhe persona me



pushtet [që janë] të lidhur me ata që kryejnë kontrabandë nëpërmjet kalimit nga pika ilegale të kufirit duan që ta evitojnë këtë proces.<sup>120</sup>

Në këtë lloj atmosfere, paqëndrueshmëria, prapambetja, madje edhe krizat do të vazhdojnë të jenë diçka normale për këtë zonë.

## Profili i një zone problematike: veriu i Kosovës

Më 16 janar 2018, politikani i njohur serb Oliver Ivanović u vra nga persona që e qëlluan me armë zjarri nga një makinë në lëvizje, ndërsa Ivanović ishte përballë zyrave të partisë së tij në Mitrovicë, në veri të Kosovës.<sup>121</sup> Ky incident mendohej se do të përkeqësonte akoma më shumë tensionet etnike – pikërisht në ditën kur Beogradi dhe Prishtina duhej të rifillonin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Por në fakt, vrasja e Ivanovićit nxorri më shumë në pah marrëdhëniet dhe aktivitetet e dyshimta të biznesit në veri të Kosovës, se sa tensionet etnike ndërmjet serbëve dhe kosovarëve.

Zona në veri të Kosovës është një krahinë me sipërfaqe rreth 1,200 kilometra katrore (që përfshin bashkitë e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut). Popullsia e kësaj zone llogaritet të jetë rreth 80,000 banorë, dhe 70,000 prej tyre janë serbë të Kosovës.<sup>122</sup> Në krahasim më pjesën tjetër të vendit, kjo zonë nuk është shumë e populluar. Qyteti më i madh në veriun e Kosovës është Mitrovica e Veriut, që në vitin 2013 u nda si bashki më vete, duke u shpëputur nga Mitrovica e Jugut në krahun tjetër të lumit Ibër. Pjesa më e madhe e 30,000 banorëve të Mitrovicës së Veriut janë serbë.<sup>123</sup>

Veriu i Kosovës ka qenë një zonë gri që nga fundi i luftës së Kosovës në vitin 1999, pasi autoritetet kosovare dhe komuniteti ndërkombëtar kanë ushtruar shumë pak autoritet mbi këtë territor që nga ajo kohë. Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia, dhe kjo i tensionoi akoma më shumë marrëdhëniet ndërmjet Prishtinës e Beogradit. Pas shpalljes së pavarësisë, Bashkimi Evropian krijoi misionin EULEX, për të ndihmuar Kosovën në ngritjen e institucioneve të drejtësisë dhe shtetit. Pas negociatash të gjata, me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara dhe BE-së, u nënshkrua në vitin 2013 Marrëveshja e Brukselit, që u konsiderua si hap i madh përpara në procesin e hapjes së dialogut ndërmjet dy vendeve ish-armike.

Sidoqoftë, procesi i zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit ka ecur ngadalë, veçanërisht në lidhje me krijimin e shoqatës apo bashkimit të njërive administrative me shumicë serbe. Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të jenë të tensionuara, megjithë përpjekjet e BE-së për të arritur një marrëveshje midis palëve nëpërmjet çeljes së dialogut.

Fillimisht u mendua se vrasja e Oliver Ivanovićit mund të kishte lidhje me çështje politike, por tani duket se ai incident kishte të bënte me luftën për ushtrimin e influencës dhe kontrollin e fondeve publike në veri të Kosovës.

## Zonë gri shumë fitimprurëse

Ndërkohë që ka disa zëra që e nuk e pranojnë pavarësinë e Kosovës, statusi i veriut të Kosovës është akoma më i paqartë. Qeveria e Kosovës ushtron shumë pak kontroll mbi veriun e vendit, por nga ana tjetër, edhe vetë institucionet e veriut kanë shumë pak pushtet, si pasojë e ritmit të ngadalë dhe kufizimeve të vetëadministrimit. Kjo ka të mirat dhe të këqijat e veta.

Llogaritet se qeveria serbe harxhon rreth 500 milionë euro në vit<sup>124</sup> në ndihmë ekonomike për bashkëkombasit e saj në veri të Kosovës. Kjo shumë është afërsisht sa një e pesta e të gjithë buxhetit vjetor të qeverisë së Kosovës. Po kështu, gjatë periudhës 2005 - 2011, disa kompani përfituan nga vendimi i qeverisë së Serbisë për të hequr taksën e TVSH-së për mallrat që shiteshin për veriun e Kosovës. Praktikisht kjo e kthente rajonin në një zonë me taksë zero, dhe për pasojë çmimet e karburantit, makinave dhe mallrave të konsumit ishin më të lira se në pjesët e tjera të Kosovës – madje edhe më të lira se në Serbi. Beogradi vendosi në shtator 2011 që ta anulonte këtë vendim për të ndaluar abuzimet.



Përveç fondeve që vijnë nga Serbia, që prej zgjedhjeve lokale të vitit 2013, katër bashkitë e veriut të Kosovës thithin financime edhe nga fondet e qeverisë së Kosovës, në zbatim të kushteve të Marrëveshjes së Brukselit.

Për më tepër, plus ndihmës ekonomike nga Serbia dhe buxheti i Kosovës, ka edhe një Fond Zhvillimi për Veriun. Ky fond mbledh të ardhurat nga tarifatat doganore për mallrat e konsumit që importohen për veriun e Kosovës. Këto para duhet të investohen për zhvillimin e rajonit, por në fakt nuk ka të dhëna se si shpenzohet ky fond. Po kështu, edhe donatorët ndërkombëtarë, veçanërisht BE, kanë dhuruar nëpër vite dhjetëra miliona euro në kuadër të projekteve të zhvillimit për veriun e Kosovës. Ia vlen të përmendet edhe njëherë fakti se rajoni ka vetëm 80,000 banorë.

Në këtë rajon ka shumë pak ndërmarrje industriale - dhe shumica e aktiviteteve tregtare janë biznese të vogla - dhe për pasojë, kushdo që kontrollon se si shpenzohen fondet në një ekonomi që mbështetet fort tek asistencat ekonomike mund të ushtrojë goxha influencë. Edhe bizneset varen nga mbështetja politike për të mbijetuar. Në fakt, për shumicën e banorëve të veriut është më fitimprurëse që të aplikojnë për fonde publike, sesa t'i hyjnë biznesit. Kjo situatë nxit korrupsionin nëpërmjet klientelizmit dhe krijon një ekonomi politike të varësisë nga fondet publike. Për më tepër, edhe pushteti i ligjit është i dobët (veçanërisht përsa i përket sistemit të drejtësisë), dhe ka shumë pak dhënie llogarie mbi mënyrën se si shpenzohen fondet publike. Këto faktorë krijojnë një atmosferë shumë të përshtatshme për lulëzimin e krimit dhe korrupsionit.

“Kontrabanda është kaq e përhapur saqë konsiderohet si një aktivitet i zakonshëm ekonomik, ndërsa shpërthimet e eksplozivit janë bërë tashmë “diçka normale.”

Simptomat janë shumë të qarta. Kontrabanda është kaq e përhapur saqë konsiderohet si një aktivitet i zakonshëm ekonomik, ndërsa shpërthimet e eksplozivit janë bërë tashmë “diçka normale.” Të dhënat e mbledhura pas një kërkesë për informacion të drejtuar nga GI ndaj Drejtorisë Rajonale të Veriut të Policisë së Kosovës, për periudhën që nga krijimi i saj në vitin 2013 deri në fund të vitit 2017, flasin qartë mbi numrin alarmant të krimeve të dhunshme në veriun e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe katërvjeçare, 14 makinave private u është vënë flaka, dhe ka patur 23 raste të hedhjes së eksplozivëve në shtëpi private dhe biznese të zonës. Edhe pjesëtarë të Forcave të Sigurisë të Kosovës nga bashkësitë serbe janë bërë objekt sulmesh. Informacioni që dha policia tregon se nga 40 raste të akteve të dhunshme kriminale gjatë kësaj periudhe, nga hetimet policore është arritur të kapen autorët e vetëm pesë krimeve.<sup>125</sup> Por edhe shifra e raportuar nga policia është vetëm një pjesë e vogël e aktiviteteve kriminale që ndodhin në këtë komunitet të vogël, pasi shumë nga banorët e kësaj zone refuzojnë të njoftojnë policinë për probleme dhe incidente.

Stautusi i zonës gri të veriut të Kosovës duket se e ka kthyer këtë rajon në një zonë të sigurtë për kriminelë nga vende të tjera të Ballkanit perëndimor.<sup>126</sup> Po kështu, ky status bën të mundur lulëzimin e aktiviteteve të paligjshme. Nga kjo zonë kalon një rrugë që lidh veriun e Kosovës dhe Serbinë (veçanërisht Novi Pazarin) në veri, me Prishtinën dhe pjesën tjetër të Kosovës në jug. Në pikat kufitare, si Jarinje dhe Brnjak, nga ana kosovare kemi policinë dhe doganën e Kosovës, si dhe personelin e EULEX-it, ndërsa nga krahu tjetër kemi policinë serbe. Thuhet gjithashtu se ka disa “pika alternative kalimi” (zakonisht rrugë të pashtuara), që përdoren për hyrje dhe dalje të paligjshme nga Kosova, si dhe për kontrabandë.

Karburanti është malli që kalon më shpesh kontrabandë (nga veriu në jug). Më pas vijnë materialet e ndërtimit, ilaçet, makinat, cigaret, ushqime, pije, dhe mallra të tjera. Llogaritet se nga këto aktivitete të paligjshme buxheti i Kosovës humb çdo javë rreth 750,000 euro nga tarfia doganore të pambledhura: nga këto 400,000 euro janë tarifa karburantesh, nga materialet e ndërtimit humbin 200,000 euro, dhe 150,000 euro për mallrat e tjera. Një pjesë e mirë e këtyre mallrave nuk qëndrojnë në pjesën veriore me popullsi serbe, por transportohen për në jug në zona të Kosovës me popullsi shqiptare. Kjo tregon edhe njëherë se kur vjen puna tek rrjetet e kontrabandës, kriminelët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin pavarësisht dasive etnike, apo ndarjeve gjeografike e administrative.





Nga ana tjetër, bashkëpunimi midis forcave të ruajtjes së rendit është i kufizuar si pasojë e mosmarrëveshjeve në lidhje me juridiksionet, si dhe mungesë besimi ndaj palës tjetër. Kjo mungesë bashkëpunimi e bën akoma më të vështirë punën për të vlerësuar me saktësi gjendjen e vërtetë në terren, ndërkohë që kjo situatë e bën akoma më të lehtë punën e grupeve kriminale.

“Kjo tregon edhe njëherë se kur vjen puna tek rrjetet e kontrabandës, kriminelët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin pavarësisht dasive etnike, apo ndarjeve gjeografike e administrative.”

Përveç kalimit kontrabandë të mallrave me akcizë, armëve dhe drogës (kanabis nga Shqipëria, dhe heroinë që vjen nga korridoret ballkanike), nëpër këtë rajon zhvillohet edhe trafikimi i qenieve njerëzore (që vijnë nga jugu dhe kalojnë nëpër veriun e Kosovës). Që nga viti 2015, ky korridor mendohet se është përdorur edhe për kalimin e emigrantëve.

## Kush e kontrollon veriun e Kosovës?

Me tërë këto para që hyjnë në veriun e Kosovës, dhe me gjithë këto mundësi për t'u marrë me aktivitete të paligjshme pa u rrezikuar nga policia, kuptohet qartë se mund të ketë përfitime të mëdha për këdo që ka nën kontroll këtë rajon. Po, cilët janë këta?

Bazuar në intervista dhe të dhëna nga burime të ndryshme, veriu i Kosovës duket se është feudi i disa individëve që nuk guxon njeri t'ua përmendë emrin, por që njihen nga të gjithë.<sup>127</sup> Ashtu si dhe në zona të tjera të Ballkanit, duket se edhe këtu janë krijuar lidhje të ngushta midis elitave të biznesit, politikës dhe krimit. Emrat që përmenden në këtë rast janë Zvonko Veselinoviç dhe Milan Radojiçiq.

Veselinoviç dhe Radojiçiq kanë vite që janë ortakë biznesi, kanë njohje të hershme shoqërore me njëri-tjetrin, dhe sipas raporteve zyrtare e artikujve investigativë në media janë edhe bashkëpunëtorë në aktivitete kriminale. Në vitin 2011, kur filloi e ashtuquajtura kriza e barrikadave në veri të Kosovës – pasi komuniteti ndërkombëtar dhe institucionet e Kosovës morën nën kontroll pikat e kalimit kufitar me Serbinë – Veselinoviç dhe Radojiçiq konsideroheshin si udhëheqësit e rezistencës, dhe mbrojtësit e interesave të serbëve të Kosovës. Ndërsa luanin rolin e nacionalistëve, duket se ajo që i interesonte në të vërtetë atyre ishte fakti se kontrolli më i rreptë në dogana do të dëmtojte interesat e biznesit të tyre dhe kriminelëve të tjerë. Kjo deklaratë është konfirmuar nga intervista me oficerë policie të Kosovës, diplomatë perëndimorë, dhe zyrtarë të doganave, që pohojnë njëzëri se Veselinoviç ishte kreu i një rrjeti kriminal që kërcënohej nga kontrolli më i rreptë në dogana, dhe se ai ishte organizatori kryesor, dhe përgjegjës për ngritjen e dhjetëra barrikadave në rrugët e qytetit.<sup>128</sup>

Tani, Veselinoviç duket se i ka transferuar aktivitetet e veta jashtë veriut të Kosovës, dhe është angazhuar në një sërë projektesh infrastrukturore në Serbi – duke përfshirë dhe ndërtimin e një autostrade. Disa pretendojnë se të njëjtët kamionë që u përdorën për të bllokuar urat e Mitrovicës, u përdorën për të ndërtuar Autostradën Patriotike. Ky biznesmem i dyshimtë serb ka patur edhe më parë lidhje të ngushta me biznesmenë shqiptarë në Kosovë: në të kaluarën ai dyshohej për pjesëmarrje në kontrabandë karburanti.<sup>129</sup> Ashtu si thotë edhe një analist: “Nuk është aspak çudi që nacionalistë të flaktë serbë dhe ‘mbrojtës’ të Kosovës punojnë krah për krah për të ndërtuar autostradën Prishtinë-Tiranë ndërkohë që ngrejnë dhe barrikada. Në të dyja rastet ata bëjnë para që, si rregull, është gjithmonë prapa të ashtuquajturit patriotizëm.”<sup>130</sup> Në fillim të këtij viti, një gjykatë në Piro, në Serbinë jugore, e dënoi Veselinoviçin me dy vjet burg për abuzim me detyrën gjatë ndërtimit të Korridorit 10, si dhe nën akuzën e përvetësimit të rreth 200,000 eurove.

Një nga ortakët e Veselinoviç është Milan Radojiçiq, që deri tani vonë ishte një person gati i panjohur, që kishte në pronësi një restorant në Mitrovicën e Veriut. Gjërat ndryshuan pas vrasjes së Ivanoviçit. Para se të vritej, Ivanoviç dha



një intervistë për Rrjetin e Gazetarëve Investigativë të Ballkanit (BIRN) dhe tha se Radojiçiç ishte “sundimtari i zi i veriut të Kosovës” dhe “një figurë kryesore në një sistem pushteti të frikshëm në veri të Kosovës.”<sup>131</sup> Po kështu Ivanoviç tha se pushteti në veriun e Kosovës nuk i përkiste zyrtarëve të zgjedhur dhe institucioneve vendore, dhe se Radojiçiç kishte akumuluar shumë pushtet dhe ndikim në proceset vendim-marrëse.

Në qershor 2018, kur interesi nga ana e publikut mbi këtë çështje kishte arritur kulmin, Radojiçiç u zgjodh zëvendës-kryetar i Srpska Lista (Lista serbe), që mund të konsiderohet si partia motër në Kosovë e Partisë Progresive në Serbi. Srpska Lista ka pushtet mbi katër bashkitë e veriut të Kosovës, dhe është një aleate në koalicionin qeveritar të Kosovës. Megjithë tensionet etnike, thuhet se Radojiçiç gëzon – të paktën deri tani vonë – lidhje të ngushta me elitat politike si në Serbi ashtu dhe në Kosovë. E megjithatë ai arrin të manipulojë dhe të përftojë me sukses nga statusi i kontestuar i Kosovës. Në momentin kur dukej se po i shtrëngohej laku, ai refuzoi të njihje legjitimitetin e forcave të rendit të Kosovës, dhe refuzoi të dorëzohej në polici duke luajtur kartën e serbit të Kosovës. Nga ana tjetër, ai refuzoi të njihje edhe juridiksionin e gjykatave serbe, dhe t’u përgjigjej disa pyetjeve të vështira, me justifikimin se ai nuk mbante ndonjë post në Serbi. Radojiçiç jeton në Serbi që nga fundit i vitit 2018.

“Banorët e kësaj zone janë veçanërisht të shqetësuar në lidhje me rritjen e nivelit të dhunës gjatë këtyre viteve të fundit, sidomos që nga viti 2013; ndihen të pafuqishëm; dhe janë të shqetësuar për mosndëshkimin e kriminelëve.”

Vrasja e Oliver Ivanoviçit mbetet një incident shumë i rëndë për serbët e Kosovës, edhe ngaqë hetimi i policisë nuk ka bërë ndonjë përparim në gjetjen e autorëve. Kjo del qartë nga shumë deklarata personale, por konfirmohet edhe nga rezultatet e një sondazhi publik të zhvilluar kohët e fundit në katër bashkitë serbe, nga një organizata e shoqërisë civile të kësaj zone, Aktiv. Numri i qytetarëve që mendojnë se krimi është problemi më i madh në veriun e Kosovës u dyfishua në vitin 2018, në krahasim me vitin 2016, dhe shumë nga personat e intervistuar për sondazhin thanë në mënyrë specifike se ndiheshin më pak të sigurtë si pasojë e vrasjes së Ivanoviçit.<sup>132</sup> Banorët e kësaj zone janë veçanërisht të shqetësuar në lidhje me rritjen e nivelit të dhunës gjatë këtyre viteve të fundit, sidomos që nga viti 2013; ndihen të pafuqishëm; dhe janë të shqetësuar për mosndëshkimin e kriminelëve.<sup>133</sup>


Ky incident tregoi se pavarësisht nga retorika nacionaliste në tryezën e bisedimeve, serbët dhe shqiptarët e Kosovës vazhdojnë të lidhin ujdin nën rrogos. Të dyja kampet përfitojnë nga një shkallë paqëndrueshmërie në veri të Kosovës, pasi kjo i lejon që të kryejnë aktivitetet e tyre në një zonë gri, ndërsa luajnë rolin e nacionalistëve.

## Pazaret e dhunës

Në shumë nga këto zona problematike, si dhe në pjesë të tjera të Ballkanit, dhuna është në shitje – ose për të evituar dhunën, ose për ta ushtruar. Shitësit e dhunës janë grupe të rinjsh që janë të gatshëm të ushtrorjnë dhunë, si dhe grupe personash që mund të mobilizohen në mbështetje të partive politike. Ashtu siç u shpjegua më lart, këtu përfshihen grupet kriminale, vrasës me pagesë, punonjës të kompanive të policive private, rrugaçë, protestues politikë, paraushtarakë, dhe huliganë futbolli.

## Grupet kriminale

Faktorët kryesorë në tregun e dhunës në Ballkan janë grupet e organizuara kriminale. Këto grupe zakonisht emërtohen sipas mbiemrit të familjës apo ndonjë krahinë e caktuar. Shumica e tyre formohen nga anëtarë të farefisit, si dhe persona nga një zonë e caktuar. Megjithëse shumica e anëtarëve të këtyre bandave i përkasin të njëjtit grup etnik,



kombësia nuk e pengon fare bashkëpunimin midis grupeve kriminale me etni të ndryshme. Shumica e grupeve kriminale e ushtrojnë aktivitetin e tyre përreth një zone të caktuar, megjithëse ka edhe grupe kriminale më të mëdha dhe më mirë të organizuar – si grupi i Darko Shariç, apo grupi i Naser Kelmendit – që kishin aktivitet si në Bosnjë Hercegovinë ashtu edhe në Kosovë. Pjesa më e madhe e grupeve të studiuara për këtë raport merret me një sërë aktivitetesh kriminale. Disa nga këto grupe kanë lidhje apo aktivitete edhe jashtë vendit të tyre, në bashkëpunim me grupe të diasporës apo edhe me grupe kriminale të një kombësie tjetër.

## Vrasës me pagesë

Ballkani ka marrë një reputacion të keq si vend origjine për vrasës me pagesë. Si pasojë e trashëgimisë së luftës, dhe vështirësive ekonomike, në disa rajone të caktuara, ka një numër të madh të rinjsh – veçanërisht nga Bosnja, Kroacia dhe Serbia – që mund të gjejnë lehtë armë dhe eksplozivë. Të rinj nga ky rajon kanë kryer vrasje me pagesë si në Ballkan ashtu edhe në Evropën qendrore. Për shembull, vrasës me pagesë janë përdorur nga të dy krahët në konfliktin e klanit të Kotorit. Ia vlen të përmendet fakti se një numër i madh vrasësish me pagesë duket se vijnë nga Banja Luka, si dhe nga krahinat kufitare midis Bosnjë Hercegovinës, dhe Serbisë. Qytetet e Burrelit dhe **Fushë-Krujës** shpesh përmenden si vende nga vijnë vrasës me pagesë për sulme dhe atentate që kryhen në Shqipëri. Këto qyteza kanë histori të dhunshme, pasi kanë përjetuar trazirat e vitit 1997, si dhe nga problemet që kanë këto zona me gjakmarrjen dhe vrasjet për hakmarrje. Gjatë intervistave me GI-në, disa burime thanë se të rinj nga Burreli kanë prirje të sillen dhunshëm.

## Kompani private të mbrojtjes fizike dhe sigurisë

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, u evidentuan disa raste ku kompani të policive private ishin përfshirë në shantazhe dhe vënie gjobash ndaj bizneseve. Ato ndiqnin modelin tipik të këtij lloji shantazhi, duke ofruar mbrojtje ndaj rreziqeve që në shumë raste vinin po prej tyre: edhe dhelpra edhe pulat në një kotec. Një nga shembujt e shumtë të këtij lloji është rasti i një kompanie të policisë private në Tuzla, që ushtron dhunë për llogari të një grupi kriminal në atë zonë, si dhe zhvat para me shantazh nga po ato klube nate që paguhen për t'i mbrojtur. Kjo kompani tani ka kaluar në mbrojtjen e një zinxhiri dyqanesh me emër. Po në atë zonë, një grup rival ka krijuar kompaninë e vet të policisë private. Këto ushtri të vogla rrallë bezdisen nga policia, pasi në radhët e tyre ka shumë policë të dypunësuar, apo ish-policë.

## Rrugaçët

Si pasojë e niveleve të larta të papunësisë dhe me pak shpresa për të ardhmen, të rinjtë në shumë krahina të varfra në vendet e Ballkanit perëndimor janë pre e lehtë e grupeve kriminale. Të rinjtë që përzihen me këto grupe tërhiqen nga paratë, adrenalina, dhe ndonjëherë edhe droga. Disa prej tyre bëhen edhe huliganë futbolli (shiko më poshtë). Disa të tjerë, si për ironi, në përpjekje për të shpëtuar nga dhuna në vendin e tyre, përfundojnë në kthetrat e grupeve kriminale jashtë shtetit.

Në Shqipëri, disa qytete duket se janë veçanërisht problematike në lidhje me të rinjtë që bëhen pre e grupeve kriminale – si në vendin e tyre, ashtu edhe jashtë shtetit. Për këta të rinj, reputacioni si persona të dhunshëm u jep një avantazh në rrugët e Belgjikës, Hollandës, apo Britanisë. Një analist që ka ndjekur grupin kriminal Hellbanianz në Britani thotë se: "Kanë një lloj krekosje që mund të krahasohet me kriminelët irlandezë gjatë dhe pas trazirave të Irlandës së Veriut."<sup>134</sup> Mungesa e perspektivës në vendin e tyre, lidhjet me emigracionin jashtë vendit, si dhe shansi që iu dha nga kriza e emigrantëve në vitin 2015, krijuan një valë emigracioni me të rinj që largoheshin nga qytete si Laçi dhe Kukësi. Shumë të rinj i tërheq bota e krimit edhe si një mënyrë për të paguar borxhet që akumulohen gjatë kalimit për në Bashkimin Evropian, apo edhe si shenjë solidariteti ndaj atyre që i ndihmuan për t'u larguar nga Shqipëria. Disa madje i tërheq mënyra e jetës së një gangsteri. Këta të rinj, që zakonisht vijnë nga familje të varfra, janë të domosdoshëm për aktivitetet e grupeve kriminale për shitjen e drogave, vjedhjen e makinave, mbledhjen e borxheve, apo për ushtrim dhune. Disa prej tyre – nëse ia arrijnë të mbijetojnë – mund të ngjiten në rangje më të



larta në grupin kriminal ku bëjnë pjesë. Sidoqoftë, shumica e tyre vështirë se mund të marrë vesh ndonjëherë se cilët janë krerët e vërtetë të organizatës së tyre.

Këta kriminelë zakonisht mësojnë që të gënjejnë dhe sajojnë justifikime në moment, të anashkalojnë ligjet, dhe të gjejnë mundësi për të bërë para. Një shembull tronditës është shkatërrimi i shtëpive private dhe bizneseve në lagjen Savamala të Beogradit, natën e zgjedhjeve, më 24 prill 2016. Sipas dëshmitarëve, burra të armatosur me shkopa bejsbolli dhe fytyra të mbuluara me maska zbritën nga makina pa targa, i futën të gjithë personat që ishin rreth e rrotull në një magazinë, i morën celularët dhe kartat e identitetit, dhe më pas shkatërruan godinat aty pranë me buldozerë.<sup>135</sup> Kjo bëri të mundur fillimin e punimeve për ndërtimin e një projekti shumë të debatuar, që financohej nga Emiratet e Bashkuara Arabe – projekti i zhvillimit Beogradi Buzë-lumi (një projekt që qeveria serbe e kishte shumë për zemër).<sup>136</sup> Hetimet nga ana e policisë dhe sistemit të drejtësisë nuk kanë ecur shumë përpara.

Është shqetësues fakti se rrugaçë të tillë po përdoren në të gjithë rajonin për të trembur apo sulmuar gazetarë – duke përfshirë edhe ata që po raportojnë mbi disa nga rastet e përmendura në këtë raport. Madje në disa raste, autorët e sulmeve ndaj gazetarëve janë zyrtarë shtetërorë. Për shembull, vetëm për vitin 2018, shoqata e gazetarëve të Bosnjës, BH Novinari, raportoi 41 sulme kundër gazetarëve, duke përfshirë pesë kërcënime me vdekje, shtatë raste të dhunës fizike, dhe tetë kërcënime direkte nga politikanë. Në periudhën ndërmjet janarit dhe mes-gushtit 2018, Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë (NUNS) regjistroi 50 raste dhune, kërcënime apo kanosje, duke përfshirë katër raste të dhunës fizike, dhe 18 raste kur gazetarët u kërcënuan nga zyrtarë shtetërorë.<sup>137</sup>


## Protestues politikë

Në Ballkan, protestat politike nganjëherë organizohen nga partitë politike. Një nga format e mobilizimit të simpatizantëve (që ndonjëherë bëhen edhe të dhunshëm) është mbledhja në mitingje dhe protesta e punonjësve të sektorit publik që janë besnikë ngaj qeverisë, ose që thjesht marrin rrogë prej saj. Këto protesta shpesh organizohen dhe koordinohen nëpërmjet rrjeteve sociale dhe aplikacioneve në celularë. Një zyrtar i administratës shtetërore tregon për Gl: “Na vjen një sms me vendin dhe kohën kur duhet të dalim. Transporti zakonisht është organizuar që më parë. Gati të gjithë dalim në miting pasi kemi frikë se na heqin nga puna.”<sup>138</sup> Në raste të tjera, veçanërisht afër datës së zgjedhjeve, banditë dhe rrugaçë paguhen që të frikësojnë apo rrahin protestuesit, si dhe të detyrojnë me forcë apo të “organizojnë” votuesit. Disa nga këta horra janë përdorur edhe për të sulmuar parlamentin, siç ndodhi në Shkup, në prill 2017!<sup>139</sup>

## Huliganë futbollit

Gjatë punës për analizimin e krimit të organizuar në Ballkan, u pa se roli i huliganëve të futbollit nuk mund të injorohet. Në disa nga zonat problematike të identifikuar nga ky raport (veçanërisht në Serbi), pjesëtarët e klubeve të tifozëve akuzohen edhe për përfshirje në pazare droge. Për shembull, anëtarët e klubit të tifozëve të Vojvodinës, skuadrës së Novi Sadit, që njihen me nofkën Firma, thuhet se rekrutojnë minorenë për të shitur drogë, ngaqë ata nuk mund të futen në burg.

Thuhet se në dhjetor 2017, një nga krerët e një bande kriminale në Budva pagoi disa shtetas kroatë (dhe u shpërndau celularë të koduar) për të sulmuar krerët e klubit të tifozëve të Partizanit të Beogradit gjatë një ndeshje derbi me ekipin Crvena Zvezda. Plani ishte që të vihej nën kontroll grupi më i fortë i huliganëve të Partizanit, që ishin të përfshirë në shpërndarjen e drogës dhe vënien e gjobave në Beograd. Ky incident duket se buron nga konflikti midis njërit prej krerëve të tifozëve të Partizanit, Aleksandar Stankoviç, dhe njërit prej krerëve të një grupi kriminal në Budva, në lidhje me një borxh të papaguar nga shitja e drogës. Po kështu, ka të dhëna se në disa raste huliganët e futbollit i shërbejnë edhe interesave të politikanëve (për shembull, për të siguruar mbrojtje për aktivitete e mitingje, për të prishur protestat e partive kundërshtarë, si dhe për të bërë punët e tyre të pista). Po kështu, huliganët kanë lidhje edhe me oficerë të lartë policie, që sigurojnë mbrojtjen e tyre kur huliganët kanë probleme me ligjin.<sup>140</sup> Gjatë pesë viteve të fundit, janë vrarë në atentate të stilit mafioz disa pjesëtarë të organizatave të tifozëve të Partizanit dhe Crvena Zvezdës. Siqoftë, e gjithë kjo ka të bëjë me botën e krimit dhe jo me futbollin.<sup>141</sup>



## Grupet paraushtarake

Grupet paraushtarake janë pjesa më ekstreme e tregut të dhunës në këtë rajon. Ka kohë që në vendet e Ballkanit grupe kriminelësh dhe njësi të armatosura paraushtarake kanë krijuar lidhje me njëri-tjetrin. Gjatë luftrave ballkanike në vitet '90, një sërë figurash nga bota e krimit i erdhën në ndihmë mbrojtjes së Sarajevës, ndërsa grupe paraushtarake si UÇK dhe Garda Vullnetare Serbe (që njiheshin edhe me emrin Tigrat e Arkanit) kishin në mes tyre edhe elementë kriminalë të përfshirë në aktivitete të paligjshme. Sipas Srecko Latal, një analisti politik nga Bosnjë Hercegovina, "disa nga këta kriminelë me emër vazhduan të mbanin lidhje me politikanët në pushtet, dhe me kalimin e viteve, me zhvillimin e këtyre marrëdhënieve, nganjëherë ishte e vështirë të kuptoje se kush ishte më shumë autoritet."<sup>142</sup>

Ashtu siç u përmend edhe në kapitullin e rajonit të "trekëndëshit të krizave," ka patur lidhje të forta midis kriminelëve dhe grupeve të armatosura në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, sidomos në incidentin më të fundit në Kumanovë, në maj 2015. Gjatë viteve të fundit, ka patur njoftime mbi formimin e një grupimi paraushtarak në Bosnjë që quhet Srbska Čast (Nderi Serb), që përbëhet kryesisht nga ish-luftëtarë serbë dhe persona nga bota e krimit me precedentë penalë (siç ishte ish-kreu i këtij grupi në Bosnjë Hercegovinë, Igor Bilbija, që konsiderohet si 'kriminel karriere').<sup>143</sup> Thuhet se krahu i Bosnjës të këtij grupi është bërë pjesë e Narodni Sindikat (Organizata Kombëtare), që drejtohet nga kriminel i njohur Sasha Milakoviç. Këto grupe – ashtu si dhe grupe të tjerë, si Veteranët e Republika Srpska dhe grupi i motoçiklistëve Ujqit e Natës – thuhet se përdoren nga autoritetet e Republika Srpska si protestues, prishës mitingjesh, apo edhe si persona të armatosur përkrah policisë.<sup>144</sup>

## Ekosistemi i krimit

Zonat problematike të identifikuar nga ky raport duhet të analizohen në kontekstin më të gjerë të një ekosistemi kriminal që ka depërtuar në vendet e Ballkanit perëndimor. Shumë persona të intervistuar për këtë raport flasin për ekzistencën e një 'kulture krimi' në vendet e tyre.

Në majë të piramidës, shpesh kemi marrëdhënie të ngrohta midis elitave politike, ekonomike dhe kriminale.<sup>145</sup> Në ndryshim nga disa vende të tjera, ku grupet kriminale veprojnë si parazitë, duke përfituar nga ato që i jep shteti, në shumë vende të Ballkanit perëndimor lidhja ndërmjet strukturave të shtetit dhe grupeve kriminale i ngjan më shumë një partneriteti. Edhe Komisioni Evropian, që zakonisht përdor gjuhë diplomatike në deklaratat e veta, tha tani së fundmi se vendet e Ballkanit perëndimor "tregojnë shenja të qarta se shteti është kapur (nga krimi), duke përfshirë edhe lidhje me krimin e organizuar, korrupsion në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe ndërthurje të theksuar të interesave publike dhe private."<sup>146</sup>

Krimi dhe korrupsioni në nivele të larta është zakonisht i padukshëm, por kohët e fundit ka filluar të bjerë në sy të publikut. Në Malin e Zi, Partia Demokratike e Socialistëve, që ka shumë vite në pushtet, u trondit kohët e fundit (që nga viti 2016) nga një skandal pas publikimit të një video që tregon biznesmenin malazet Dushko Knezheviç (Duško Knežević), duke i dhënë një zarf plot me para një zyrtari të qeverisë për të financuar fushatën elektorale.<sup>147</sup> Ky skandal ka rindezur akuzat për korrupsion ndaj rrethit të personave të afërt me presidentin Djukanoviç.<sup>148</sup> Ka edhe akuza rreth lidhjeve të mafias me të paktën një ministër të qeverisë Serbe.<sup>149</sup>

Në Shqipëri, opozita e kryesuar nga Partia Demokratike ka bojkotuar parlamentin pas akuzave për korrupsion dhe lidhje midis partisë në pushtet dhe grupeve kriminale. Akuza të ngjashme janë hedhur edhe kundër PD-së kur ishte në pushtet. Në Maqedoninë e Veriut, një përfaqësues i shoqërisë civile tha se "qëllimi i strukturave shtetërore, që kontrollohen nga partitë politike, nuk është lufta ndaj krimit të organizuar, por vënia e tij nën kontrollin e tyre." Në intervistën e fundit që dha para se të vritej, Oliver Ivanoviç e përshkroi në këtë mënyrë lidhjen midis figurave të dyshimita dhe qeverisjes vendore në veri të Kosovës: "Qendra e pushtetit nuk është bashkia – pasi bashkia i përket dikujt tjetër, qendrës informale të pushtetit."<sup>150</sup> Kjo situatë nuk haset vetëm në veri të Kosovës: ka patur kritika e akuza edhe kundër ish-komandantëve të UÇK-së për përfshirjen e tyre me krimin e organizuar, por më pas po këta individë i kanë hyrë politikës.<sup>151</sup> Nga ana tjetër, nuk ka patur thuajse asnjë reagim nga sistemi i drejtësisë.



Kjo marrëdhënie simbiotike midis elitave politike dhe grupeve kriminale krijon këtë sistem: Elitat politike sigurojnë mbrojtje për grupet kriminale (ku mund të jenë përzier edhe miq e të afërm të tyre), ndërsa nga krahu tjetër, grupet kriminale ndihmojnë elitat politike që të pasurohen, dhe i ndihmojnë që të vijnë dhe të qëndrojnë në pushtet. Në momentin kur sigurohet pushteti, krijohet edhe mundësia për të shtuar nivelin e patronazhit, si dhe për të fshehur e legjitimuar aktivitete të tjera.

Meqë politika ka në dorë shpërndarjen e fondeve publike, edhe konkurrenca për të fituar pushtetin është e madhe.


Pushteti në Ballkan bazohet mbi politikën e klientelizmit, me fjalë të tjera, politikanët shpërndajnë favore apo të mira materiale në shkëmbim të mbështetjes politike. Dhe kjo është një rrugë me dy drejtime. Grupet kriminale japin para dhe vënë dhunën në dispozicion të politikës për fushata elektorale (për shembull, duke blerë vota apo duke nxitur banorët e zonës që të votojnë për një individ apo parti të caktuar), dhe në këmbim, pasi fitojnë zgjedhjet, individit apo partia siguron mbrojtje politike për aktivitetet kriminale, si dhe japin vende pune, apo favore për votuesit e tyre. Në një mënyrë perverse, kjo marrëdhënie krijon një kontratë sociale – për sa kohë që je i lidhur me partinë në pushtet. Kjo do të thotë se në këtë sistem rrjetet informale luajnë një rol të dorës së parë: familja dhe miqtë, kombësia e njëjtë, individë nga e njëjta krahinë apo bashkësi, veteranë lufte, si dhe kriminelë.

“Në ndryshim nga disa vende të tjera, ku grupet kriminale veprojnë si parazitë, duke përfituar nga ato që i jep shteti, në shumë vende të Ballkanit perëndimor lidhja ndërmjet strukturave të shtetit dhe grupeve kriminale i ngjan më shumë një partneriteti.”

Në ato vende ku administrata publike është një nga sektorët më të mëdhenj punëdhënës, ai që ka në dorë vendet e punës mund të ushtrojë goxha influencë. Kryetari i partisë në pushtet bëhet kështu kreu i një shteti klientelist. Fondet publike përdoren për të paguar rroga për të afërm dhe miq, për të blerë besnikërinë e individëve të ndryshëm, si dhe për të shpërblyer krahina të veçanta apo aleatë politikë. Proceset e tenderave publike manipulohen, lëshohen dokumente zyrtare për të fshehur aktivitete të paligjshme (si lëshimi i lejeve apo licensave speciale), madje mund të sabotohen edhe institucionet publike, për të dobësuar dhe kufizuar mbikqyrjen e autoriteteve, dhe për të shtuar mundësitë për fitime personale. Pozicione kyçe në administratën publike (duke përfshirë edhe doganat dhe policinë kufitare) u jepen simpatizantëve partiakë, apo përdoren si monedhë shkëmbimi për të siguruar mbështetjen e partive të vogla, apo grupeve të ndryshme.

Po kështu, organet e ruajtjes së rendit mund të përdoren për interesat partiake të atyre që janë në pushtet. Kjo ndodh shumë herë më rrallë se në vitet '90, por ka akoma raste të tilla. Për shembull, ish-shëf i shërbimeve sekrete të Maqedonisë së Veriut, **Sasho (Sašo) Mijalkov**, akuzohet se ka organizuar në mënyrë të paligjshme survejimin dhe inçizimin e bisedave të mijëra personave, duke përfshirë ministra, gjykatës, gazetarë dhe politikanë të opozitës, nga shërbimi informativ kombëtar – një skandal që e zhyti Maqedoninë e Veriut në një krizë të tejzgjatur politike në vitin 2015.<sup>152</sup> Në mars 2019, Mijalkov u dënua nga gjykata, së bashku me kryetarin e Partisë Demokratike të Shqiptarëve, për presion ndaj anëtarëve të Komisionit Zgjedhor.<sup>153</sup> Në të kaluarën janë dokumentuar lidhje të qarta midis forcave të rendit dhe shërbimeve informative me grupet kriminale në Serbi.<sup>154</sup>

Klientelizmi politik shtrihet edhe në fushën e biznesit. Në ekosistemin e krimit, elitat politike e përdorin pushtetin e tyre të pakontrolluar për të pasuruar veten, familjen dhe miqtë. Krimi ekonomik dhe korrupsioni në nivele të larta është e vështirë të zbulohet dhe vërtetohet, por ai shfaqet në procedurat e tenderave, përfitimeve nga informacione të brendshme zyrtare, vendimeve për lejet e ndërtimit, si dhe pastrimit të parave. Politikanët krijojnë mundësi përfitimi dhe mbrojtje për miqtë (apo familjen) e tyre, dhe më pas marrin një përqindje të fitimit. Biznesmenë të dyshimtë mund të blejnë mbrojtje dhe influencë duke siguruar mbështetje për partinë në fuqi, për shembull nëpërmjet financimit të fushatave elektorale.



Ka patur raste kur individë të përfshirë në krimin e organizuar kanë mbështetur elitat politike, dhe më pas kanë krijuar lidhje të ngushta me biznesmenë të lidhur me këto elita. Në këtë lloj ambienti, është e vështirë të bëhet dallimi midis aktivitete të paligjshme dhe bizneseve legjitime, dhe kjo krijon një situatë shumë të favorshme për ata sipërmarrës që kanë miqësi me zyrtarë të lartë, dhe që shpesh konsiderohen si “biznesmenë të dyshimtë.”<sup>155</sup>

Një elitë politike që ka kapur fort të gjitha fjetet e pushtetit, me lidhje të forta me grupet kriminale, dhe mbështetje nga sipërmarrës të fuqishëm, mund të jetë shumë e vështirë ta largosh nga pushteti.<sup>156</sup> Një një sistem të tillë, ata që ndodhen në majë të piramidës së pushtetit kanë prirje të shtrembërojnë apo thyejnë ligjet pa u hyrë gjemb në këmbë, ndërsa ata që janë në nivelet e ulëta mendojnë se ky sistem është çimentuar aq fort saqë nuk mund të ndryshohet më. Në momentin kur shtien në dorë pushtetin mbi një sistem të tillë, është vështirë që të heqësh dorë më pas. Problemi është se jo vetëm që ke shumë për të humbur nga dorëzimi i pushtetit, por edhe nga vetë mënyra e funksionimit të sistemit, e ke edhe të qartë se po kalove në opozitë mbetesh jashtë loje. Meqë vendet e rajonit kanë eksperiencë apo kulturë shumë të kufizuar demokratike mbi trajtimin e ndershëm të opozitës; kanë institucione të dobëta të kërkesës së llogarisë; si dhe shumë pak respekt për idenë e “të mirës së përgjithshme,”<sup>157</sup> politika në Ballkan kthehet në një betejë për jetë a vdekje. Kjo duket qartë edhe nga beteja e egër dhe e tejzgjatur politike midis Bashkimit Social Demokrat të Maqedonisë (SDSM) dhe partisë VMRO-DPMNE (Organizata Revolucionare Kombëtare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas) në Maqedoninë e Veriut në vitin 2017. E njëjta gjë mund të shihet edhe në Shqipëri, nga përplasjet midis Partisë Demokratike dhe qeverisë. Në përgjithësi, ata që janë në pushtet përfitojnë nga manipulimi i sistemit, ndërsa ata që janë në opozitë duan të hedhin poshtë qeverinë, por nuk kanë besim tek parlamenti – deri sa të vijë radha e tyre për të marrë frerët në duar.

“Në një ekosistem krimi, institucionet mbajnë krahun e atyre që janë në pushtet, dhe nuk mbrojnë domosdoshmërisht shtetin e së drejtës.”

Nuk është se situata të tilla ndeshen vetëm në Ballkan. Sidoqoftë, ka edhe faktorë të tjerë që e dobësojnë rolin e qeverive në rajon. Kështu, statusi i pazgjdhur i Kosovës dhe mosrespektimi i ligjit në bashkitë e veriut krijojnë një zonë ligjore gri që bën të mundur ekzistencën e një zone kriminale gri. Edhe fjalët që hidhen në ajër për “ndryshime kufijsh” lënë të hapur mundësinë e këtyre ndryshimeve në të ardhmen, dhe kjo sjell një mungesë interesi për të investuar seriozisht në kontrollin e kufirit. Po kështu, disa vende refuzojnë ta njohin Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur, dhe kjo krijon probleme për bashkëpunim dypalësh të forcave të rendit, dhe shkëmbimin e ndihmës reciproke nga sistemet e drejtësisë. Deri tani vonë, problemi me emrin e Maqedonisë së Veriut po pengonte normalizimin e marrëdhënieve me Greqinë.

Marrëveshja komplekse për ndarjen e pushtetit në Bosnjë Hercegovinë ka krijuar një bllokim të situatës, dhe lë hapësira për abuzime në disa nivele të qeverisjes. Një përfaqësues i shoqërisë civile në rajon i tha GI-së se “asnjë nga grupet kriminale vendase [në Tuzla] nuk janë aq të rrezikshme dhe të mirorganizuar sa politikanët që kanë vjedhur nëpër vite në mënyrë sistematike.”<sup>158</sup> Kjo arrihet nëpërmjet manipulimit të tenderave, ndikimit në procesin e marrjes në punë në administratën shtetërore, si dhe mbajtjen nën kontroll të policisë, prokurorisë dhe gjykatave.

Vitet e fundit, janë hapur një sërë çështjesh gjyqësore kundër zyrtarëve shtetërorë në Bosnjë Hercegovinë. Kështu për shembull, një zyrtar u arrestua për lëshimin e faturave false për aktivitete që nuk ishin kryer kurrë. Në një rast tjetër, një ish-ministër u arrestua për dhënien e fondeve publike për individë në krahinën e Tuzlës, por kishte vendosur si kusht që 50 për qind e shumës t’i kthehej atij në formë ryshfeti. Janë hapur disa çështje kundër ish-kryeministrit të Maqedonisë së Veriut Nikola Gruevski për mashtrim elektoral, shfrytëzim posti, korrupsion dhe finacime të paligjshme të partisë nëpërmjet pastrimit të parave.<sup>159</sup> Ndërkohë, Gruevski ka fituar azil politik në Hungari.

Në Shqipëri, ka patur akuza për blerje votash – veçanërisht me paratë që vijnë nga shitja e kanabisit.<sup>160</sup> Po kështu, disa individë me të kaluar kriminale janë emëruar si deputetë në parlament. Ndaj nuk është fare e çuditshme që dy ish-deputetë janë arrestuar për flasifikimin e dokumenteve të pronësisë mbi mijëra metra katrorë tokë në pronësi



të shtetit. Po kështu, një ministër i brendshëm u detyrua të jepte dorëheqjen në vitin 2018 pas akuzave për lidhje me një grup kriminal. Këto zhvillime kanë ardhur në një kohë kur qeveria është nën presion për të zbatuar Ligjin e Garantimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushetrojnë Funksiione Publike, që u miratua në vitin 2015 me kërkesën e faktorit ndërkombëtar.

Në një ekosistem krimi, institucionet mbajnë krahun e atyre që janë në pushtet, dhe nuk mbrojnë domosdoshmërisht shtetin e së drejtës. Në fakt, në një atmosferë të tillë sistemi i drejtësisë penale shpesh përdoret kundër atyre që kërkojnë të prishin statukuonë.

Zonat problematike të krimit lulëzojnë aty ku veprimi i ligjit është më i dobët. Banja Luka është një shembull i mirë në këtë rast. Së fundmi, ky qytet ka dalë në lajme si rezultat i vdekjes të një djali 21 vjeçar, David Dragičević. A u zhdruk rreth orëve të 18 marsit 2018, ndërsa trupi i tij i mavijosur u gjet gjashtë ditë më pas, më 24 mars, në cekëtinat e lumit Crkvena, jo shumë larg nga qendra e qytetit. Pasaktësitë dhe mospërputhjet në deklaratat e lëshuara nga policia mbi shkakun e vdekjes shkaktuan protesta publike dhe një lëvizje qytetare që mori emrin "Drejtësi për Davidin."<sup>161</sup>


Kjo nuk është hera e parë që policia në Banja Luka të jetë bërë objekt kritikash: ka patur edhe akuza ndaj policisë së qytetit për përzjerje në trafikun e drogës. Në vitin 2013, katër inspektorë policie nga drejtoria e anti-drogës u arrestuan për trafikim droge. Në vitin 2015, pesë anëtarë të një njësie të ndërhyrjes së shpejtë të policisë në Republika Srpska i zunë priturë një makine të blinduar që transportonte para nga Banja Luka për në Zagreb, dhe vodhën rreth 300,000 euro. U raportua se personat që ngritën priturë kishin armë të rënda automatike dhe një lëshues predhash anti-tank.

Tre nga anëtarët e grupit e pranuan fajin dhe dëshmuan kundër pjesëtarëve të tjerë të bandës (duke përfshirë edhe një bashkëpunëtor të tyre që punonte për kompaninë e sigurisë), dhe si rezultat katër pjesëtarë të grupit u dënuan dy herë nga gjykata e rrethit në Banja Luka. Mëgjithë pranimin e fajit dhe dënimet e lëshuara nga gjykata, këto vendime u hodhën poshtë nga Gjykata e Lartë e Republika Srpska. Në nëntor 2018 filloi çështja e tretë gjyqësore.

Por Banja Luka nuk është i vetmi vend ku ndodhin të tilla gjëra. Gjatë hartimit të këtij raporti, pjesëtarët e rrjetit të Observatorit të Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore regjistruan një numër të madh rastesh kur doganierë dhe policë kufiri bënin një sy qorr; një hapësirë disaorëshe që quhet edhe 'happy hours' në pikat e kalimit të kufirit (kur shoferët e dinë se për një pagesë të vogël nën dorë mund të kalojnë nëpër doganë pa u kontrolluar); zhvatje dhe gjoba nga ana e policisë, si dhe bashkëpunim midis policisë dhe grupeve kriminale. Për shembull, zyrtarë nga rajoni i policisë në Trebinje (pranë kufirit ndërmjet Bosnjës dhe Malit të Zi) janë dënuar nga gjykata për pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal. Në Serbi, të dhënat zyrtare tregojnë se të paktën 14 punonjës dogane dhe 11 policë të kufirit u arrestuan në vitet 2017 dhe 2018 për marrje ryshfeteshe. Në vitin 2016, kreu i drejtorisë anti-drogë të policisë boshnjake – Bojan Cvijan – u dënua me 20 vite burg për vrasje, grabitje dhe bashkëpunim në krim.<sup>162</sup> Lista është shumë më e gjatë se kaq, por duket se policët nuk përballen plotësisht me pasojat e aktivitetit të tyre kriminal.<sup>163</sup>

Akoma më shqetësuese janë raportimet dhe akuzat se pjesëtarë të forcave të rendit dhe shërbimeve informative me lidhje të forta politike punojnë për grupet kriminale duke i dhënë atyre informata dhe mbrojtje. Në shumë raste, zyrtarë të lartë të kufirit, doganave dhe policisë së rendit emërohen nga parti politike, duke krijuar një piramidë mbrojtjeje, ku oficerë të forcave të rendit bëjnë çfarë duan krerët e tyre politikë, duke krijuar kështu kushtet e duhura për trafikim, si dhe duke mbushur xhepat e politikanëve të korruptuar. Ky fenomen është raportuar nga disa zona problematike në Maqedoninë e Veriut, por kjo nuk ndodh vetëm në këtë vend.

Herë pas here, autorët e këtij raporti dëgjuan për raste të marrjes së ryshfeteve nga policia, apo për pjesëmarrjen e tyre në afera korruptive. Për shembull, tani së fundmi në krahinën e Tuzlës një komandant policie u akuzua nga gjykata për dekonspirimin e informacioneve sekrete ndaj grupeve kriminale, si dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare; një ish-kryeinspektor u akuzua se merrte ryshfeti për të mos ushtruar kontrolle dhe inspektime; madje edhe një ish-ministër i brendshëm doli para gjykatës për marrje ryshfeteshe për të mos vepruar në kohë, duke lënë kështu që të skadonin statutet e kufizimit për apelet e disa kriminelëve të caktuar.<sup>164</sup> Kështu, dy ish-ministra të brendshëm të Bosnjës janë tashmë kriminelë të dënuar nga gjykata, ndërsa një i tretë dyshohet për pjesëmarrje në veprimtari kriminale.





Ndërkohë që disa zyrtarë publikë po vjedhin para, shumë institucione publike nuk kanë fonde të mjaftueshme. Raportet e vlerësimit të situatës kanë vënë në pah mungesën e infrastrukturës dhe pajisjeve në pikat e kalimit kufitar (si kamera), masa sigurie të pamjaftueshme në zonën e kontenerëve nëpër porte, si dhe mungesë personeli dhe rroga të ulëta në sektorët e doganës dhe policisë kufitare. Po kështu edhe drejtoritë e anti-korrupsionit kanë mungesë fondesh dhe personeli, ose nuk lejohen të bëjnë punën e tyre.

Në këtë situatë, edhe policët dhe doganierët e aftë, me dëshirë të mirë për punë, nuk mund t'i ndalojnë aktivitetet kriminale. Nganjëherë, ashtu si ndodh në Kosovë apo Bosnjë Hercegovinë, ka probleme edhe me juridiksionin. Një krim që ndodh në një zonë të vendit (në veri të Kosovës apo në Republika Srpska) nuk ndiqet dot nga autoritetet në një zonë tjetër. Po kështu, kjo situatë komplikohet akoma më tepër nga tensionet politike dhe mungesa e besimit midis forcave të ndryshme policore. Për shembull, nuk ka marrëveshje ekstradimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe po kështu ka shumë pak bashkëpunim midis policive të Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht pas përpjekjeve të Serbisë për të penguar anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL.

Megjithëse legjislati i miratuar në shumicën e vendeve të rajonit është shumë i mirë, ndjekja penale është mbase pika më e dobët në zinxhirin e drejtësisë penale në Ballkan. Analistët Florian Bieber dhe Marko Kmeziç thonë se: "Gjykatat në Ballkan janë të pavarura dhe autonome vetëm në letër, ndërsa në realitet puna e gjykatave kufizohet nga ndikimet politike, mungesa e efikasitetit, nepotizmi, dhe korrupsioni."<sup>165</sup>

“ Në vendet e Ballkanit perëndimor, sillen përpara gjykatës shumë pak raste serioze të krimit të organizuar, por edhe ato pak raste që arrijnë në gjyaktë, rrallë rezultojnë në dënime.”

Gjatë studimit të shtetit të së drejtës në Maqedoninë e Veriut për vitin 2017 hartuesit e raportit vunë re "kontrollimin dhe shpërdorimin e sistemit të drejtësisë nga një numër i vogël gjykatësish në pozicione pushteti, për t'i shërbyer interesave politike."<sup>166</sup> Këta gjykatës "ushtronin presion mbi kolegët e tyre në shkallë më të ulëta hierarkie, nëpërmjet kontrollit të sistemit të emërimeve, vlerësimeve, ngritjeve në detyrë, masave disiplinore, dhe heqjeve nga puna, që përdoren për të shpërblyer ata që binden dhe për të ndëshkuar ata që rezistojnë." Një vërejtje, që mund të aplikohet edhe për vende të tjera të rajonit, thotë se "kjo situatë përshkruhet si 'kapje shteti,' por mbase duhet konsideruar më shumë si kapje e gjyqësorit dhe sistemit të ndjekjes penale nga pushteti ekzekutiv."<sup>167</sup>

Në vendet e Ballkanit perëndimor, sillen përpara gjykatës shumë pak raste serioze të krimit të organizuar, por edhe ato pak raste që arrijnë në gjyaktë, rrallë rezultojnë në dënime. Për shembull, një gazetar investigativ i tha GI-së se askush nuk ka dalë para gjykatës në lidhje me 74 aktet e fundit kriminale në veri të Kosovës. Askush. Por, situata nuk është edhe shumë më e mirë në pjesën tjetër të Kosovës, edhe sot e 10 vjet pas fillimit të punës së Misionit të Bashkimit Evropian për Shtetin e së Drejtës në Kosovë (EULEX).

Në shumë raste çështjet hidhen poshtë; zyrtarët e lartë apo kriminelë me emër që dalin para gjykatës shpallen të pafajshëm; ka qaq shumë vonesa sa që skadon afati i lejueshëm; ose dënimet shkurtohen ndjeshëm si pasojë e ndërhyrjeve të politikës. Në shumë raste jepen dënime të lehta për krime të rënda, dhe kjo sjell nivele të larta recidivizmi. Në të vërtetë, gjatë punës për hartimin e këtij raporti dilnin herë pas here po të njëjtët emra të dënuar disa herë nga gjykatat për krime të ndodhura në vite.

Shpeshherë, kriminelët – edhe kur kapen – janë në gjendje që të ruajnë fitimet e mbledhura nga aktivitetet e paligjshme. Hetime financiare, bllokime dhe konfiskime pasurish nuk aplikohen në masën e duhur në vendet e Ballkanit perëndimor – dhe Komisioni Evropian ka kërkuar nga të gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor që të bëjnë më shumë në këtë drejtim.<sup>168</sup> Për më tepër, duket se ka mungesë eksperience dhe njohurish, apo edhe mungesë dëshire, për të luftuar evazionin fiskal, prokurimet e dyshimta në shtet, dhe procedurat e privatizimit, vënien në mënyrë të pashpjegueshme të pasurisë, pastrimin e parave, si dhe financimin e partive politike.



Nga ana tjetër, sistemi i drejtësisë reagon shumë shpejt kundër gazetarëve që denoncojnë korrupsionin, ose që flasin kundër qeverisë. Në fakt, disa nga mediat në rajon që kritikojnë punën e qeverive vihen nën hetime financiare dhe hidhen rregullisht në gjyq – shpeshherë nga zyrtarë të lartë të pushtetit vendor dhe qeverisë qendrore.

Oficerë policie dhe prokurorë të intervistuar për këtë raport – në disa nga zonat problematike – thanë se janë në gjendje të zbardhin raste të zakonshme vrasjesh, por kur vjen puna tek vrasjet me motive politike, hetimet nuk japin rezultat. Disa nga të intervistuarit ishin të acaruar nga ndërhyrjet në punët e policisë, dhe përmendën raste kur eprorë të tyre i thonin “atë mos e prek, është peshk i madh.” Një ish-oficer i lartë policie nga Shkupi shpjegoi: “Maqedonia [e Veriut] ka kapacitete për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin... por arritim gjithmonë në një pikë ku politikanë të fuqishëm na kërkoni që të ndalonim hetimet apo procesin e arrestimit.”<sup>169</sup> Në fakt, duket se sa më serioz të jetë krimi i kryer, aq më pak ka të ngjarë që autorët të dalin para drejtësisë. Mungesa e pavarësisë dhe politizimi i sistemit të drejtësisë e pengon seriozisht vendosjen e shtetit të së drejtës.

Në disa raste, kërret e krimit gati trajtohen si Lord Voldemort nga librat *Harry Potter*: zotër të errësirës që nuk duhet t’u përmendet emri. Disa nga kriminelët më famëkeqë quhen në mënyrë figurative si “biznesmenë që përherë arrijnë t’i shmangen drejtësisë.” Raportet e progresit të Komisionit Evropian përdorin gjuhë goxha diplomatike, por mesazhi që japin është i qartë: në thuajse të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor, ka ndërhyrje ndaj gjykatave në raste të profilit të lartë, në çështje më ndjeshmëri politike dhe nivele të larta korrupsioni, në çështje të krimit të organizuar, si dhe raste për shfrytëzim posti, dhe se ka ardhur koha të shtohet numri i dënimeve për të treguar se jemi në rrugën e duhur.

Mbase nuk është edhe surprizë fakti, se si rezultat i presionit nga komuniteti ndërkombëtar janë shënuar gjatë viteve të fundit edhe rastet kur “peshq të mëdhenj” janë vënë para drejtësisë në Ballkan.

Si përfundim, kjo analizë nga poshtë-lart e zonave problematike duhet të shkojë krah për krah me një shqyrtim nga lart-poshtë të sistemit që e lejon ekzistencën e tyre. Çdo zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme duhet të marrë në konsideratë si problemet në nivelet më të larta të shtetit, ashtu edhe veçoritë vendore që shkaktojnë këto probleme në terren.


## Krimi ballkanik jashtë rajonit

Krismat oshëtijnë në një rrugicë të ngushtë në zemër të Vjenës. Dy djem dergjen të gjakosur në trotuarin përballë një prej restoranteve më me emër në këtë qytet, Figlmüller. Banorë të qytetit që po blejnë dhurata krishtlindjesh largohen në panik, ndërsa helikopterë policie qëndrojnë pezull në ajër mbi kokat e tyre. Dëshmitarët kanë parë një burrë të ikë me vrap nga skena e krimit. Disa prej tyre mendonin se e kishin dëgjuar të fliste në një gjuhë ballkanike.

Prapaskenat e këtij incidenti janë tregues të disa aspekteve të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor që u përmendën më lart në këtë raport: përhapja përtej Ballkanit e konflikteve midis bandave rivale për kontrollin e trafikut të kokainës, e hakmarrjeve, e lidhjeve midis krimit të organizuar dhe huliganëve të futbollit. E gjitha kjo shoqërohet me incidente gjithnjë e më të guximshme dhe të dhunshme, me sulme me armë zjarri dhe shpërthime bombash.

Më 21 dhjetor 2018, dy të rinj nga Mali i Zi dhe Serbia, u përballën me një person të armatosur në hyrje të një prej restoranteve më të famshme të Vjenës për shnizel. Vladimir Roganoviç (32 vjeç) u vra në vend, ndërsa 23 vjeçari Stefan Vilotijević u plagos rëndë. Megjithëse policia u vu në kërkim të autorit të sulmit, hetimet e tyre vazhdonin akoma edhe në momentin kur po shkruhej ky raport, dhe personi që qëlloi me armë nuk është gjetur ende.

Roganoviç ishte nga qyteti i Herceg Novit në Malin e Zi. Ai kishte pak kohë që kishte liruar nga një burg pranë Podgoricës, dhe ishte larguar nga Mali i Zi vetëm tre ditë përpara sulmit në Vjenë. Më parë ai kishte qenë duke vuajtur dënimin në një burg në Beograd, por kërkoi të transferohej në Mali të Zi për siguri personale (do të shpjegohet më poshtë). Roganoviç mendohej se ishte anëtar i klanit të Kavaçit nga Kotori, që ishte përfshirë në një konflikt



të përgjakshëm me klanin rival Shkaljari për kontrollin e trafikut të kokainës nëpër portet e Malit të Zi. Kushëri i Vladimirit, Dushko, humbi të dyja këmbët në prill 2017 pasi makina me të cilën po udhëtonte në Herceg Novi u hodh në erë nga një ngarkesë eksplozivi. Është interesant fakti se vjeherri i Dushkos është shefi i policisë për rendin publik në Nikshiç. Babai i Dushkos, Niko Roganoviç (66 vjeç), u vra nga dy persona të panjohur, në një atentat të stilit mafioz në korrik 2017, pasi kishte shpëtuar tre muaj më parë nga shpërthimi i një makine bombë.

Por nuk mbaron me kaq. Kushërinjtë Roganoviç u përmendën për herë të parë në publik në vitin 2009 pas vrasjes së Marko P. Vesniç, një nga krerët e grupit të tifozëve Delije të klubit të futbollit Crvena Zvezda. (Vesniç mendohej se ishte pjesë e një grupi kriminal që merrej me shpërndarjen e drogës). Sipas akuzës në gjykatë, kushërinjtë Roganoviç vranë Vesniç dhe plagosën një person tjetër – Ivan Markoviç – pranë parkut Omladinski në qytezën Igalo (një qytezë pranë Herceg Novit). Ata u dënuan me nga 12 vjet burgim, por të dy u liruan pasi vuajtën më pak se gjashtë vite burg.

Stefan Vilotijeviç nga Nikshiç mendohet se ka lidhje të ngushta me klanin Kavaç (ashtu si dhe Roganoviçi), dhe rrjedh nga një familje e njohur për dhënien e parave hua me interesa shumë të larta, si dhe trafikimin e cigareve dhe drogës. Kjo familje është përfshirë prej shumë vitesh në një konflikt të përgjakshëm me familjen Raduloviç (po nga Nikshiç), që janë të lidhur më klanin Shkaljari.

Klanet Kavaç dhe Shkaljari hynë në konflikt me njëri-tjetrin pasi një sasi e madhe kokaine u zhduk në Valencia në vitin 2014, dhe që atëherë këto dy grupe kanë luftuar për mbizotërimin në treg, dhe i janë futur një cikli të pafund sulmesh për hakmarrje.

Sipas një gazetari nga Mali i Zi, në të kaluarën klanet Kavaç dhe Shkaljari kanë marrë vrasës me pagesë nga Bosnjë Hercegovina për të kryer vrasje. Ka të ngjarë se e njëjta metodë është përdorur edhe për sulmin e Vjenës. Apo mbase ishte hakmarrje për vrasjen e Marko Vesniç, nga grupi i tifozëve të Crvena Zvezdës? Nuk është akoma e qartë. Por ky incident tregon edhe njëherë lidhjet e ngushta midis krimit të organizuar, huliganëve të futbollit, përdorimin e shpeshtë të vrasjeve me pagesë (nëpërmjet atentateve me armë zjarri apo makinave bombë), si dhe përhapjen e hakmarrjeve dhe luftës midis bandave në Evropën perëndimore.

Sipas një gazetari që punon në Ballkan, sulmi i fundit në Vjenë – në mes të ditës dhe në qendër të qytetit – tregon se mafia ndihet e sigurtë në forcën e saj, dhe nuk ngurron të veprojë në mënyrë të dhunshme edhe jashtë Ballkanit, dhe po vepron duke mos patur frikë nga ndëshkimi.<sup>170</sup> Një shembull tjetër është edhe kërcënimi që vjen nga mafia shqiptare dhe trafiku i drogës në Britani. Po kështu, edhe shumica e anëtarëve të bandës Panterat Rozë, që vjedhin gurë të çmuar dhe bizhuteri, janë nga Ballkani; dhe grupe po nga Ballkani janë përfshirë në trafikimin e emigrantëve në vendet e Bashkimit Evropian. Ia vlen të përmendet edhe ndikimi i trafikut të armëve nga rajoni, si dhe roli aktiv që luajnë kriminelët nga Serbia dhe Mali i Zi në trafikimin e drogës në vende nga më të ndryshmet, që nga Amerika latine, Evropa perëndimore, dhe Afrika e Jugut.<sup>171</sup> Kjo është mbase një temë për një tjetër raport në të ardhmen.

## Zonat problematike të krimit në të ardhmen

Është e vështirë të parashikosh se cilat do të jenë zonat problematike të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor në të ardhmen, por ka disa pika që duhen patur parasysh.

Një prej çështjet që duhet parë me kujdes janë investimet e mëdha në projekte infrastrukture. Autostrada të mëdha po ndërtohen nga Tivari në Beograd, si dhe nga portet e Shqipërisë për në Kosovë (ajo që quhet autostrada Shqipëri-Kosovë, autostrada Durrës-Kukës, apo "Autostrada Patriotike"). Autostrada Adriatik-Jon planifikohet të shkojë nga jugu i Greqisë deri lart në veri, në kufirin kroat me Slloveninë. Këto projekte mund të kenë një impakt të madh pozitiv në rajon: duke shtuar lidhjet dhe nxitur tregtinë, si dhe duke tërhequr një numër më të madh turistësh. Por këto rrugë mund të kenë ndikimin e vet edhe në korridoret e trafikimit, duke rritur efikasitetin e trafikantëve, ose të policisë. Në të njëjtën kohë, vetë këto projekte krijojnë hapësira për aktivitete kriminale – nëpërmjet tenderave të ndërtimit dhe korrupsionit të niveleve të larta.



Një pikë tjetër që duhet parë me kujdes është edhe shtimi i mundshëm i numrit të kompanive ajrore me kosto të ulët që kryejnë fluturime në rajon. Edhe në këtë rast, kjo është një gjë e mirë për rajonin në përgjithësi, por mund edhe të krijojë hapësira të reja për krimin e organizuar.

Edhe situata në Bosnjë Hercegovinë dhe në veri të Kosovës duhet shqyrtuar me kujdes – jo vetëm përsa i përket pasojave politike, por edhe rolit të luajtur nga elementët kriminalë që përfitojnë nga paqëndrueshmëria në rajon.

Çuditërisht, edhe stabiliteti politik mund të krijojë hapësira të reja për krimin. Me përmirësimin e marrëdhënieve midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë mund të hapen pika të reja të kalimit të kufirit midis dy vendeve. Një pikë e tillë mund të hapet në rajonin e Prespës, një krahinë pranë kufijve me Shqipërinë dhe Greqinë. A mund të kthehet Prespa në një zonë problematike për krimin? Po pikat e reja të kalimit kufitar që planifikohen të hapen në kufirin midis Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë: do të sjellin më shumë probleme apo mundësira për trafikantët?


“Këto projekte mund të kenë një impakt të madh pozitiv në rajon: duke shtuar lidhjet dhe nxitur tregtinë, si dhe duke tërhequr një numër më të madh turistësh. Por këto rrugë mund të kenë ndikimin e vet edhe në korridoret e trafikimit, duke rritur efikasitetin e trafikantëve, ose të policisë.”

Çfarë ndikimi do të ketë Rruga e Mëndafshit në Ballkan, investimet e mëdha dhe kreditë që po jep Kina në këtë rajon si pjesë e iniciativës së saj *Një Shteg, Një Rrugë* (One Belt, One Road)? Ka disa plane që parashikojnë ndërtimin e një autostrade të madhe që lidh portin e Pireut me Shkupin, Beogradin dhe Budapestin, si dhe investime në portet shqiptare dhe malazeze.

Disa nga vendet e rajonit po përpiqen të thithin investime të huaja nëpërmjet krijimit të zonave të lira tregtare. Problemi është se këto zona krijojnë edhe hapësira për abuzime, si në rastin e cigareve që kalojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e Bashkimit Evropian nga zona e lirë tregtare në portin e Tivarit. Në shtator 2018, qeveria e Malit të Zi konfirmoi se një zonë e lirë tregtare do të krijohet pranë Podgoricës, në të njëjtin vend ku ndodhet fabrika e cigareve DKP. Në të kaluarën qeveria e Maqedonisë së Veriut ka hedhur edhe idenë e krijimit të “zonave financiare ndërkombëtare,” me fjalë të tjera zona me taksa zero. Kjo mund ta kthejë Maqedoninë e Veriut në një parajsë bankare. Krijimi i këtyre zonave gri mund të jetë një magnet për aktivitetet e paligjshme.

Ka edhe shenja se rajoni mund të bëhet pre e grupeve kriminale që përdorin lojërat e fatit dhe bastet në internet për të pastruar para, dhe se kontrolli qeveritar mbi lojërat në internet mund të shtrembërohet me qëllim që të tolerohen grupe të caktuara.

Një tjetër zonë problematike e të ardhmes mund të jetë interneti. Në vitin 2018, tre persona nga Ballkani (nga Shqipëria, Kosova dhe Serbia) u paditën (së bashku me 33 persona të tjerë anëmbanë botës) për përfshirje në një rrjet ndërkombëtar të vjedhjes së identitetit të quajtur Infracard, që shiste informacione të kartave të kreditit në internetin e zi. Por kjo është vetëm maja e ajsgjergut. Në vitin 2016, qyteti i Veleshit, në Maqedoninë e Veriut (një nga zonat problematike të përmendura nga ky raport) mori famë në periudhën rreth zgjedhjeve në Amerikë, pasi disa të rinj filluan të prodhonin lajme të rreme që u shpërndanë në mënyrë virale në internet. A ka të ngjarë që të rinj nga rajoni, që dinë të përdorin mirë kompjuterin, dhe nuk kanë ndonjë gjë më të mirë për të bërë, të kthehen në ushtarë të grupeve keqbërëse në internet? Mos ka rrezik që rajoni të kthehet në një “zonë të errët për BE-në,” dhe një shteg të hapur për sulme kompjuterike dhe spiunazh në dëm të Bashkimit Evropian? Kjo është diçka për të cilën duhet treguar kujdes.



# Përfundime

Ky raport ka identifikuar zona problematike të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit perëndimor. Nuk është ndonjë çudi që shumë nga këto qendra të aktiviteteve të paligjshme ndodhen përgjatë kufijve, zonave me qeverisje të dobët dhe status të paqartë, rajone në vështirësi ekonomike, si dhe porte apo zona urbane në kryqëzimet e rrugëve kryesore të transportit. Raporti analizon këto zona problematike në kontekstin e një ekosistemi më të gjerë krimi, që karakterizohet nga klientelizmi, patronazhi, dhe në disa raste kapja e shtetit. Kështu, megjithëse zhvillimi ekonomik i zonave të veçanta, apo ndërhyrja e forcave të rendit mund të reduktojë aktivitetet kriminale në disa nga këto zona problematike, pika të tjera të nxeha do të zënë vendin e tyre, përse kohë që nuk përmirësohet qeverisja dhe reputacioni i shtetit.

Ky rajon është viktimë e gjeografisë së tij: është një rajon tranzit për shumicën e trafiqeve të paligjshme që kalojnë nëpër të. Përse kohë që kërkesa dhe oferta për këto mallra dhe shërbime nuk do të reduktohet, Ballkani do të vazhdojë të mbetet një shteg për trafikim. Në fakt, përmirësimet në infrastrukturë mund të krijojnë më shumë hapësira për trafikantët, nëse nuk shoqërohen me përmirësimin e punës së forcave të ruajtjes së rendit, dhe kontrollit të kufijve (me përdorimin më efektiv të teknologjisë, bashkëpunimin midis policive të vendeve në rajon, dhe punës policore bazuar mbi të dhënat nga terreni).

Ndërtimi i mureve dhe mbyllja e kufijve nuk është zgjidhje afatgjatë e problemeve, madje krijojnë më shumë stimuj për aktivitete kriminale. Ashtu si thotë edhe Moisés Naím: “Sa më shumë të fortifikohen, dhe sa më fort të mbrohen zonat e ndritshme, po aq e vyer bëhet edhe thyerja e këtyre fortifikimeve. Sa më të shkëlqyeshme të jenë zonat e ndritshme, aq më tërheqëse dhe fitimprurëse bëhet për forcat që dalin nga vrimat e zeza që të gjejnë mënyra për të futur mallrat dhe shërbimet e veta brenda tyre.”<sup>172</sup>

As injorimi apo minimizimi i problemit nuk është zgjidhje. Në këtë mënyrë vetëm sa i jepet më shumë pushtet elitave të korruptuara, çimentohen praktika të padrejta, stimulohet largimi i trurit, shtohet paqëndrueshmëria, dhe largohen investitorët e huaj. Po kështu, edhe mbështetja për politikanë të dorës së fortë, që kanë lidhje me krimin e organizuar, si strategji për të siguruar stabilitet politik, dëmton procesin e hyrjes në Bashkimin Evropian. Ky do të ishte një diskreditim i vlerave, kredibilitetit, imazhit, dhe jurisprudencës së BE-së. Por megjithatë, vetë klasat politike në pushtet nuk kanë shumë stimuj për të ndryshuar sistemin, madje ata humbasin më tepër po të braktisin praktikatat e tyre klienteliste.<sup>173</sup>

Në mënyrë paradoksale, ata politikanë që luajnë rolin e nacionalistit të flaktë shpesh janë përgjegjës për dobësimin nga brenda të sovranitetit të shtetit, dhe janë të gatshëm të vënë në rrezik interesat kombëtare për përfitime personale – shpesh duke bërë pazare të fshehta me “armikun,” apo edhe me shtete të huaja. Ky raport ka treguar në mënyrë të qartë se etnia apo kombësia nuk përbën ndonjë pengesë për bashkëpunimin midis grupeve të ndryshme kriminale. Disa nga krerët dhe grupet kriminale më të suksesshme kanë krijuar rrjetet e tyre në Ballkan (dhe jashtë rajonit), ndërsa disa grupe kriminale, aq të dhunshme sa kalojnë në vetëshkatërrim, e kanë origjinën nga i njëjti qytet apo edhe nga e njëjta bandë.

Nga ana tjetër, ka shenja se ballkanasit nuk po e durojnë dot më ndikimin negativ të krimit të organizuar në komunitetin dhe vendin e tyre. Protestat e kohëve të fundit në disa vende të Ballkanit tregojnë për pakënaqësinë në rritje ndaj elitave tradicionale dhe politikave të tyre të pandershme. Problemi është se ekonomia politike e krimit është çimentuar ndër vite. Disa rrjete kriminale kanë dekada të tëra aktiviteti dhe kanë krijuar lidhje të shumta, dhe si rezultat ka edhe faktorë të jashtëm që janë të interesuar për të ruajtur dhe zhfrytëzuar statukuonë, ose që duan të krijojnë mundësi të reja për përfitime të paligjshme. Për më tepër, po nuk u forcuan institucionet e shtetit, dhe strukturat e kontrollit dhe kërkesës së llogarisë, për të përmirësuar transparencën, integritetin, dhe dhënien e llogarisë, do të jetë e vështirë që të ndryshohet sistemi.

Ky raport mundohet të pasqyrojë gjeografinë e krimit në rajon: të shqyrtojë me imtësi zonat me interes, të identifikojë pikat e tyre të dobëta, dhe të krijojë një tablo më të plotë për të analizuar zhvillimet e reja në kontekst rajonal.

Por kjo nuk është një tablo e ngurtë, madje është shumë dinamike, pasi reagon dhe ndryshon në varësi të ndryshimeve politike dhe ekonomike, zhvillimeve të reja në tregjet rajonale, si dhe shkëlqimin dhe rënien e individëve dhe grupeve të ndryshme. Zonat problematike do të ndryshojnë në varësi të situatave.



Nga ana tjetër, kjo tablo nuk është plotësisht e qartë. Ka mangësi dhe boshllëqe në informacion: krimi i organizuar duhet studiuar dhe evidentuar në mënyrë më të plotë në nivel lokal, kombëtar, dhe rajonal.

Kjo është arsyeja përse duhet të ketë më shumë raporte të tilla. Kjo është pjesë e një procesi në zhvillim e sipër. Ky raport paraqet situatën e parë nga një fushëpamje e caktuar, por shpresohet që të ndihmojë në njohjen më të mirë të situatës në terren, reduktimin e pikave të dobëta, dhe marrjen e masave të menjëhershme. Duke qenë se krimi i organizuar në Ballkan ndryshon dhe zhvillohet, Iniciativa Globale – nëpërmjet Observatorit të Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore – do të vazhdojë të monitorojë dhe të hedhë dritë mbi situatën, si në zonat problematike, ashtu dhe në të gjithë rajonin në përgjithësi.



## Shënime

- 1 Referencat rreth Kosovës në këtë raport bëhen pa paragjykuar qëndrimet mbi statusin e saj, dhe respektojnë rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.
- 2 INTERPOL, RHIPTO dhe Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Atlasi Botëror i Trafikeve të Paligjshme, 26 shtator 2018, <https://globalinitiative.net/world-atlas-of-illicit-flows/>
- 3 Walter Kemp, *Kaleidoskopi Kriminal: Krimi i Organizuar në Ballkan (Crooked Kaleidoscope: Organized Crime in the Balkans)*, qershor 2017, Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, [https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC\\_Balkans.pdf](https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_Balkans.pdf).
- 4 Ivan Krastev, Evropa po përballet me një krizë të mundshme në Ballkan. Duhet të veprojë sa më shpejt. (Europe is facing a potential crisis in the Balkans. It has to act soon) *Guardian*, 21 shkurt 2018, <https://www.theguardian.com/commentisfree/2018/feb/21/Europe-crisis-balkans-EU-membership-russia-china-turkey>.
- 5 Marko Kmezić dhe Florian Bieber. *Kriza e Demokracisë në vendet e Ballkanit perëndimor. Një Anatomie e Stabilitokracisë dhe Kufizimet e Promovimit të Demokracisë nga BE*. Grupi i Këshillimit të Politikave për Ballkanin në Evropë, Mars 2017, f. 94 (*The Crisis of Democracy in the Western Balkans. An Anatomy of Stabilitocracy dhe the Limits of EU Democracy Promotion*, Balkans in Europe Policy Advisory Group Policy Study).
- 6 Hamdi Firat Buyuk, Eksportet turke drejt vendeve të Ballkanit janë rritur ndjeshëm (Turkish Exports to Balkan Countries Rise Rapidly), *Balkan Insight*, 21 qershor 2018, <https://balkaninsight.com/2018/06/21/turkey-s-export-to-balkan-countries-increases-22-per-cent-06-21-2018/>.
- 7 Valerie Hopkins dhe James Kygn, Mali i Zi ka frikë se autostrada që financohet nga Kina do ta nxjerrë në rrugë të madhe (Montenegro fears China-backed highways will put it on road to ruin), *Financial Times*, 10 prill 2019, <https://www.ft.com/content/d3d56d20-5a8d-11e9-9dde-7aedca0a081a>.
- 8 Marko Kmezić dhe Florian Bieber. *Kriza e Demokracisë në vendet e Ballkanit perëndimor. Një Anatomie e Stabilitokracisë dhe Kufizimet e Promovimit të Demokracisë nga BE*. Grupi i Këshillimit të Politikave për Ballkanin në Evropë, Mars 2017, f. 95 (*The Crisis of Democracy in the Western Balkans. An Anatomy of Stabilitocracy dhe the Limits of EU Democracy Promotion*, Balkans in Europe Policy Advisory Group Policy Study).
- 9 Freedom House, Liria nëpër Botë 2019 (*Freedom in the World 2019*), <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2019/map>.
- 10 Transparency International, *Treguesi i Perceptimit të Korrupsionit (Corruption Perception Index 2018)*, <https://www.transparency.org/cpi2018>.
- 11 Për këtë qëllim u përdorën të dhëna nga Banka Botërore dhe UNDP (për Kosovën). Këto të dhëna shpesh ndryshojnë nga statistikat që jepen nga qeveritë. Banka Botërore, të dhëna për publikun: *papunësia, total (% e fuqisë punëtore totale) (Vlerësimi sipas modelit ILO)*, <https://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS?locations=ME>, UNDP, *Kosovë*, <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/countryinfo.html>.
- 12 Mesatarja e papunisë në BE është 6.5%, EUROSTAT, statistika papunësie, Shkurt 2019, [https://ec.europa.eu/eurostat/statistika-explained/index.php/Unemployment\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistika-explained/index.php/Unemployment_statistics).
- 13 Banka Botërore, Totali i papunësisë rinore, shtator 2018.
- 14 UNDP, Kosovë, <http://www.ks.undp.org/content/Kosovo/en/home/countryinfo.html>; shiko edhe Grupi i Bankës Botërore, *Prijretet e tregut të punës në vendet e Ballkanit perëndimor 2019*, f. 29, <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/labor-trends-in-wb>.
- 15 Grupi i Bankës Botërore. *Prijretet e tregut të punës në vendet e Ballkanit perëndimor 2018*, Mars 2018, 12-14 <http://documents.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-Western-Balkans-Labor-market-trends-2018-final.pdf>, Grupi i Bankës Botërore, Rritje më e madhe por e paqëndrueshme, Raporti periodik i rritjes ekonomike për vendet e Ballkanit perëndimor, Nr. 14, Vjeshtë 2018, <http://pubdocs.worldbank.org/en/194301538650996304/rev2-WBRER14-WQ-web-ENG.pdf>.
- 16 Marko Kmezić dhe Florian Bieber. *Kriza e Demokracisë në vendet e Ballkanit perëndimor. Një Anatomie e Stabilitokracisë dhe Kufizimet e Promovimit të Demokracisë nga BE*. Grupi i Këshillimit të Politikave për Ballkanin në Evropë, Mars 2017, 5.
- 17 Walter Kemp, *Kaleidoskopi Kriminal: Krimi i Organizuar në Ballkan (Crooked Kaleidoscope: Organized Crime in the Balkans)*, qershor 2017, 1 Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, [https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC\\_balkans.pdf](https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf).
- 18 UNODC – Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin dhe Drogën, Paratë e dogës: të ardhurat nga trafiku i opiateve që kalojnë nëpër korridorin ballkanik, 2015, 20 (Drug Money: the illicit proceeds of opiates trafficked on the Balkan route) [https://www.unodc.org/documents/islamicrepublicofiran/publications/sp1/Drug\\_Money\\_-\\_the\\_illicit\\_proceeds\\_of\\_opiates\\_trafficked\\_-\\_Balkan\\_route.pdf](https://www.unodc.org/documents/islamicrepublicofiran/publications/sp1/Drug_Money_-_the_illicit_proceeds_of_opiates_trafficked_-_Balkan_route.pdf).
- 19 Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin dhe Drogën, Paratë e dogës: të ardhurat nga trafiku i opiateve që kalojnë nëpër korridorin ballkanik, 2015, 9, [https://www.unodc.org/documents/islamicrepublicofiran/publications/sp1/Drug\\_Money\\_-\\_the\\_illicit\\_proceeds\\_of\\_opiates\\_trafficked\\_-\\_Balkan\\_route.pdf](https://www.unodc.org/documents/islamicrepublicofiran/publications/sp1/Drug_Money_-_the_illicit_proceeds_of_opiates_trafficked_-_Balkan_route.pdf).
- 20 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raport mbi strategjinë e kontrollit të trafikut ndërkombëtar të drogës. Kontrolli mbi drogat dhe kimikatet (International Narcotics Control Strategy Report. Drug and Chemical Control), Volumi 1, mars 2018, f. 98, <https://www.state.gov/documents/organization/278759.pdf>.
- 21 Sipas të dhënave që Dogana e Kosovës i dha Iniciativës Globale në nëntor 2018, u konfiskuan 4,935,650 cigare kontrabandë gjatë 10 muajve të parë të vitit 2018. Gjatë vitit 2017 u konfiskuan 427,620 cigare kontrabandë.
- 22 Jovana Carapic dhe Remo Grassman, Forcimi i rezistencës në vendet e Ballkanit perëndimor: Ndhimesë për krijimin e një harte, dhe asistencë për kontrollin e armëve personale dhe armëve të lehta, Ministria Federale e Mbrojtjes, Republika e Austrisë, dhjetor 2018, faqe 12-13.
- 23 Të gjitha shifrat mbi popullsinë në Serbi bazohen mbi regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 – me përlogaritje për shifrat aktuale. Zyra e Statistikave të Republikës së Serbisë, Llogaritje të klasifikimit të popullsisë në Republikën e Serbisë sipas gjinisë, moshës, dhe vendit të banimit 2013-2017, 2018, 213, <http://publikacije.stat.gov.rs/G2018/Pdf/G201815012.pdf>.
- 24 Zyra e Statistikave të Republikës së Serbisë, Llogaritje të klasifikimit të popullsisë në Republikën e Serbisë sipas gjinisë, moshës, dhe vendit të banimit 2013-2017, 2018, 164, <http://publikacije.stat.gov.rs/G2018/Pdf/G201815012.pdf>.
- 25 Intervistë me një oficer policie në Vršac, janar 2019.
- 26 Përfundimet u nxorën pasi studiuesi mori në shqyrtim vendime të gjykatës së rrethit Trebinje për periudhën e fundit të vitit 2018.
- 27 Të gjitha të dhënat demografike në Bosnjë Hercegovinë bazohen mbi regjistrimin e popullsisë në vitin 2013. Që nga ajo kohë nuk ka patur rilllogaritje të popullsisë sipas zonave dhe bashkive të vendit. Agjencia e Statistikave të Bosnjë Hercegovinës, Regjistrimi i popullsisë, familjeve dhe shtëpive në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2013: Rezultatet përfundimtare, 2016, <http://popis2013.ba/popis2013/doc/Popis2013prvolzdanje.pdf>.
- 28 Intervistë me zyrtar të policisë së kufirit në rajonin e Trebinjes në dhjetor 2018.
- 29 Agjencia e Statistikave të Bosnjë Hercegovinës, Regjistrimi i popullsisë, familjeve dhe shtëpive në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2013: Rezultatet përfundimtare, 2016, <http://popis2013.ba/popis2013/doc/Popis2013prvolzdanje.pdf>.
- 30 Zyra e Statistikave të Malit të Zi, Regjistrimi i popullsisë, familjeve dhe shtëpive në Malin e Zi 2011, Popullsia sipas moshës, gjinisë dhe vendit të banimit sipas bashkive, si dhe emri më i përdorur në Malin e Zi, 6 Shtator 2011, <https://www.monstat.org/userfiles/file/popis2011/saopstenje/saopstenje%20starost%204%2009%202011%20prevod.pdf>.
- 31 Intervistë me HF, një fshatar nga Balotici, dhjetor 2018.
- 32 Dusica Tamović, Fshatrat kufitare të Malit të Zi i tremben shkëmbimit me Kosovën, *BalkanInsight*, 11 gusht 2016, <https://balkaninsight.com/2016/08/11/montenegro-border-villages-fear-trade-off-with-Kosovo-08-11-2016/>.
- 33 Intervistë me një ish-oficer policie, Tetovë, nëntor 2018.

- 34 Instituti i Statistikave të Shqipërisë, Popullsia, janar 2019, <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>.
